

1 E mërkurë, 11 shkurt 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratat përmbyllëse]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.01

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
7 Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën, ju lutem.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
11 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi.
13 Mirë se vini të gjithë. Konstatoj që të akuzuarit janë të
14 pranishëm të gjithë në sallë.

15 Sot do vazhdojmë me deklaratat përmbyllëse në këtë
16 çështje. Në mëngjes do vazhdojmë me deklaratën përmbyllëse të
17 Mbrojtjes së Hashim Thaçit. Në vijim do të dëgjojmë deklaratën
18 përmbyllëse të Mbrojtjes së Kadri Veselit. Do të ndjekim
19 planin e punës, rendin e ditës të paraparë në agjendë për
20 deklaratat përmbyllëse, që është në vendimin F03639.

21 Thjesht do ju kujtoj që seanca e sotme do të përfundojë
22 në 16.45 minuta, pushimet do të bëhen gjysëm ore në orën
23 10.30, pastaj vazhdojmë në orën 11.00 dhe një orë e gjysëm në
24 drekë në orën 1.00 deri në orën 2.30, pastaj 15 minuta në orën
25 15.30.

1 Dhe, së fundmi, duke ditur që deklaratat përmyllëse po
2 përkthehen, Trupi Gjykues ju kujton palëve dhe pjesëmarrësve
3 të flasin ngadalë që të mundësojnë përkthyesve të përkthejnë
4 gjithçka.

5 Me këtë përfundojnë komentet e Trupit Gjykues.

6 Tani do fillojmë me deklaratat përmyllëse të Mbrojtjes
7 së Hashim Thaçit. Juve keni katër orë e gjysëm që do të thotë
8 se priteni të përfundoni nga ora 15.30 sot.

9 Misetic, mund të vazhdoni.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
11 Mirëmëngjesi të gjithëve kolegëve të Prokurorisë dhe të
12 gjithëve brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

13 Fillimisht desha t'ju them që kemi printuar kopje të
14 prezantimit *PowerPoint* që do të donim t'i shpërndanim Trupit
15 Gjykues, CMU-së dhe një kopje për Prokurorinë dhe një kopje
16 për Mbrojtjen e Viktimave.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Me lejen tuaj. Ndërkohë që po
19 bëhet kjo gjë do shfaqim në ekran një skicë të prezantimit
20 tonë sesi do bëhet. Do bëj fillimisht një hyrje, pastaj do
21 trajtoj çështjen e ndërmarrjes kriminale të përbashkët. Do të
22 trajtoj pretendimet e Prokurorisë se Hashim Thaçi ishte anëtar
23 i ndërmarrjes kriminale të përbashkët. Pastaj do të trajtoj
24 argumente të Prokurorisë lidhur me pozitën komanduese të
25 pretenduar të z. Thaçi. Pastaj do t'i kaloj fjalën znj.

1 Tavakoli e cila do të trajtojë çështjen e Qeverisë së
2 Përkohshme të Kosovës që nuk ka qenë, pra, nuk ka qenë
3 kontribut i rëndësishëm i ndërmarrjes kriminale të përbashkët.
4 Bashkëmbrojtësi, Ambasadori Prosper, do të trajtojë pastaj
5 sulmet e Prokurorisë ndaj dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe pastaj
6 do të trajtoj çështjet ligjore dhe provat dhe përfundimisht
7 dënimin.

8 Më lejon të filloj, të nderuar Gjykatës, duke thënë që
9 Hashim Thaçi është i pafajshëm. Kjo është pikënisja juaj kur
10 të filloni kuvendimet për marrjen e vendimit. Ne e dimë që në
11 këtë pikë, në këtë të procedurë se ai është i pafajshëm pasi
12 ligji ju kërkon juve që ta prezumoni atë të pafajshëm. Më
13 besoni apo jo, kam dëgjuar kryetarë të tribunalëve
14 ndërkombëtarë të japin fjalime ku e keqkuptojnë këtë gjë. Ata
15 thonë, "Konstatimi i pafajësisë nuk do të thotë që ne kemi
16 thënë që ai është i pafajshëm". Kjo mënyrë mendimi keqkupton
17 procesin e tërë të gjykimeve penale ndërkombëtare.

18 Përpara jush keni katër burra, meshkuj për të cilët ligji
19 thotë që duhet t'i prezumoni të pafajshëm. Ky proces është
20 sjellë këtu sepse Zyra e Prokurorit të Specializuar ka ngritur
21 pretendime se ata kanë prova që vërtetojnë përtej dyshimit të
22 arsyeshëm se ata janë fajtorë. Dhe, për rrjedhojë, për më
23 shumë se pesë vite jemi të përfshirë në këtë proces ku duhej
24 të bëhej verifikimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe
25 pretendimet e tyre dhe për të parë nëse ata mund të vërtetojnë

1 këto pretendime.

2 Ky gjykim nuk është një ekzaminim apo shqyrtim verifikimi
3 i jetës së Hashim Thaçit. Ky është verifikim i pretendimit të
4 ZPS-së se Hashim Thaçi nuk duhet të gëzojë më tej prezumimin e
5 pafajësisë. Kur të filloni kuvendimet tuaja, ju duhet të
6 filloni nga qëndrimi se Hashim Thaçi është i pafajshëm dhe
7 pastaj do të vlerësoni nëse provat e paraqitura nga Zyra e
8 Prokurorit të Specializuar ju kanë bindur juve jashtë dyshimit
9 të arsyeshëm se Hashim Thaçi është fajtor.

10 Nëse ZPS-ja nuk ju ka bindur ju, ju do të arrini në
11 përfundimin se ka të paktën një shpjegim të arsyeshëm të
12 provave të ndryshme se Hashim Thaçi nuk është fajtor për
13 akuzat që janë ngritur në aktakuzë dhe pastaj juve duhet të
14 konstatooni se ZPS-ja ka dështuar, nuk ka arritur të provojë
15 akuzat e saj dhe të arrini në një aktgjykim shfajësues ku të
16 akuzuarit lirohen nga akuzat. Hashim Thaçi do të mbetet i
17 pafajshëm si çështje ligjore.

18 Ne parashtrojmë se në kuvendimet tuaja ju do të arrini në
19 përfundimin e pashmangshëm se ZPS-ja nuk arriti të plotësojë
20 kriteret, standardin e barrës së provës që i përket. Tërësia e
21 provave vërteton një konsensus të dëshmitarëve ndërkombëtarë,
22 dëshmitarë brenda UÇK-së dhe prova shkresore që vërtetojnë
23 dyshimet e arsyeshme lidhur me pretendimet e ZPS-së. Dhe për
24 këtë, dokumentacioni ose s'është i qartë, ZPS-ja nuk ka
25 ngritur pretendime se ndonjë dëshmitar në këtë gjykim është

1 ndikuar.

2 Më lejoni të shohim dëshmitarët ndërkombëtarë fillimisht.

3 Ju keni dëgjuar nga dëshmitarë ndërkombëtarë të shumtë se

4 Hashim Thaçi nuk dyshohej për përfshirje në krime lufte

5 ndërkohë që këto ngjarje po ndodhnin apo zhvilloheshin. Këta

6 dëshmitarë ndërkombëtarë ju thanë se ishin në fakt të

7 informuar për ngjarje në terren përmes burimeve diplomatike,

8 shërbimeve të inteligjencës dhe të tjera, si dhe përmes

9 përvojave të tyre personale, përshirë përvojat e tyre me

10 Hashim Thaçin.

11 Ju keni dëgjuar këtë, për shembull, nga ish-asistenti i

12 Sekretarit të Shtetit, James Rubin, i cili ju tha juve se në

13 fund të qershorit 1999, ai konkretisht hetoi pretendimet e

14 bëra në gazetën *The New York Times* në qershor 1999 lidhur me

15 Thaçin, kontrolloi, verifikoi burimet, informacionet e

16 disponueshme që Qeveria e Shtetit e Bashkuara kishte dhe nuk

17 arriti të gjente ndonjë provë që e lidhte z. Thaçi me krime

18 lufte.

19 Pika e dytë, ish-komandanti suprem i NATO-s në Evropë,

20 Gjenerali Wesley Clark, i cili ju tha juve se ai nuk besoi se

21 do të ishte e drejtë që t'i atribuohet sjellja e gabuar e të

22 tjerëve Hashim Thaçit dhe se ai e di se nuk ka prova dhe ai

23 nuk është në dijeni të asnjë prove që ai personalisht ka kryer

24 ndonjë akt të dhunshëm apo që ka punuar ndonjëherë apo

25 bashkëpunuar me persona të tjerë për të kryer aktet e dhunshme

1 të tilla.

2 Zëdhënësi i parë i Përfaqësuesit të Veçantë të Kombeve të
3 Bashkuara të Sekretarit-Gjeneral të Kombeve të Bashkuara z.
4 Jock Covey, i cili ishte dhe ai në terren dhe ju tha juve,
5 bazuar në vëzhgimet që ai ka bërë personalisht si në vijim, z.
6 Thaçi nuk ishte në pozitë qoftë që të organizonte dhunë
7 ndëretnike e cila përfshiu vendin gjatë verës së vitit 1999,
8 apo që ta ndalojë atë në mënyrë të tërësishme, dhe se ai
9 "kishte parë, vëzhguar dhe e di në forma të tjera se z. Thaçi
10 në raste të shumta duke u rrezikuar në shkallë të madhe në
11 mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë të përsëritur denoncoi
12 dhunën dhe bëri thirrje të fuqishme për tolerancë ndëretnike".

13 Ju dëgjuat nga përvoja e diplomatëve të shquar, siç janë
14 Michael Durkee dhe Shaun Byrnes, Christopher Hill të cilët
15 përshkruan rolin e Thaçit në UÇK si një rol që ngjan me atë të
16 ministrit të punëve të jashtme. Ambasadori Hill ju tha juve,
17 iu tregoi juve për përvojën e tij të gjerë në marrëdhëniet me
18 udhëheqës ndërkombëtarë dhe me personalitete dhe udhëheqës
19 ndërkombëtarë për dekada të tëra në shërbimin diplomatik dhe
20 kishte krijuar mendimin, pikëpamjen se z. Thaçi "nuk ishte
21 lloji i personit që mund të kryente dhunë kundër të tjerëve".

22 E dëgjuat nga diplomati i shquar britanik, John Duncan, i
23 cili ju tha juve se z. Thaçi nuk ka mundur në mënyrë të
24 pavarur të ndalojë dhunën në verën e vitit 1999. Dhe dëgjuat
25 nga profesori i respektuar i së drejtës ndërkombëtare Paul

1 Williams, i cili ishte këshilltar i besuar i delegacionit
2 shqiptar në Rambuje dhe i cili ishte dëshmitar i ndërveprimeve
3 të z. Thaçi nga brenda delegacionit dhe arriti në përfundimin
4 se z. Thaçi nuk mund të kishte autoritetin brenda UÇK-së për
5 të marrë vendime vetëm.

6 Dëshmitarë të brendshëm të UÇK-së, ZPS-ja përpiqet të
7 hedhë poshtë dëshminë e këtyre, të mos marrë parasysh dëshminë
8 e këtyre dëshmitarëve ndërkombëtarë pasi njerëzit të cilët
9 ishin thjesht të painformuar lidhur me zhvillimet e brendshme
10 si persona, duke thënë se janë persona që nuk ishin të
11 informuar për zhvillimet brendshme dhe funksionimin e
12 brendshëm të UÇK-së. Për arsye që do t'i diskutoj më vonë në
13 këtë parashtrim, pretendimi i ZPS-së se dëshmitarët
14 ndërkombëtar nuk ishin të informuar është karakteristikë e
15 veçantë duke patur parasysh natyrën e centralizuar të
16 komunikatave të UÇK-së, deklaratat politike, intervistat në
17 media në provat e ZPS-së se qëllimi kriminal i përbashkët i
18 pretenduar është komunikuar në nivelet e ulëta të UÇK-së
19 përmes këtyre dokumenteve publike.

20 Diapozitivi 6.

21 Ne e dëgjuam nga ZPS-ja të hënën kur thanë se politika
22 ndaj kundërshtarëve "artikulohej në mënyrë të hapur dhe
23 zbatohej në mënyrë aktive". Të gjitha këto dokumente publike
24 duhet të kenë qenë në dispozicion të Shaun Byrnes dhe të
25 dëshmitarëve të Mbrojtjes, ndërkombëtarë dhe organizatave

1 ndërkombëtare apo nga vende të tyre dhe ata kanë patur
2 mundësi, pra, të krijojnë dhe kanë formuar mendimet dhe
3 pikëpamjet e tyre dhe paskan informuar me pikëpamjet e këtyre
4 dëshmitarëve ndërkombëtarë.

5 Për më tepër, provat e këtyre dëshmitarëve ndërkombëtarë
6 rikonfirmohen në mënyrë të fuqishme nga dëshmia e zyrtarëve të
7 lartë të UÇK-së, persona nga brenda të cilët ju i dëgjuat dhe
8 të cilët shprehën të njëjtën pikëpamje si ajo e dëshmitarëve
9 ndërkombëtarë. Dhe ata ju thanë gjithashtu se Hashim Thaçi nuk
10 kishte të bënte fare me ndonjë politikë të pretenduar për të
11 shënjestruar të ashtuquajturit kundërshtarë për të ndaluar
12 civilë, për të keqtrajtuar civilë. Ju dëgjuat nga komandanti
13 Rrustem Mustafa (Remi). Dëgjuat nga zëvendëskomandanti i UÇK-
14 së, Sokol Bashota. Edhe më e rëndësishme, dëgjuat këtë gjë nga
15 shefi i Shtabit të Përgjithshëm vetë, Bislim Zyrapit.

16 Diapozitivi 7.

17 Dhe në këtë diapozitiv do të shohin dëshminë e Bislim
18 Zyrarit i cili ju konfirmoi juve se nuk ishte në dijeni të një
19 politike të Shtabit të Përgjithshëm për të shënjestruar
20 bashkëpunëtorët apo të ndonjë përfshirjeje të Hashim Thaçit në
21 ndonjë politikë të tillë. Do të diskutoj dëshminë ku pyetja
22 është edhe tani po lexojmë këtë:

23 "PY. A ishit ju në dijeni të ndonjë marrëveshjeje të
24 thënë me gojë apo të pathënë brenda Shtabit të Përgjithshëm të
25 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në të cilën Hashim Thaçi

1 ishte i përfshirë për të shkelur të drejtat e njeriut qoftë të
2 bashkëpunëtorëve apo personave që perceptoheshin, mendoheshin
3 që ishin kundërshtarë të UÇK-së?"

4 Përgjigje:

5 "Jo, nuk qenë.

6 "PY. A keni qenë ndonjëherë në dijeni të ndonjë
7 marrëveshjeje, të thënë apo të pathënë, për të frikësuar në
8 mënyrë të paligjshme personat që mendohej se ishin
9 kundërshtarë të UÇK-së apo bashkëpunëtorë apo për të kryer
10 dhunë kundër atyre apo për t'i hequr ata në mënyrë që UÇK-ja
11 të kapte pushtetin në Kosovë?"

12 Përgjigje:

13 "Jo, nuk qenë."

14 Diapozitivi 8.

15 Tani do të diskutoj dëshminë e z. Bislim Zyrapit dhe
16 mënyrën se si ZPS-ja ka trajtuar dëshminë e tij pas pak dhe më
17 në hollësi, për momentin ju tërheq vëmendjen në pohimin e ZPS-
18 së, pra, parashtrimi i ZPS-së që bëri të hënë ku ata
19 përshkruan Zyrapin si "i vetmi gjeneral i shtabit, anëtar i
20 Shtabit të Përgjithshëm i vetëm i cili nuk ishte pjesë e këtij
21 grupi të personave të besuar. Ai ishte i vetmi person nga
22 jashtë".

23 Diapozitivi 9.

24 Kjo është në përputhje me paragrafin 1431, 1432 të dosjes
25 përfundimtare të ZPS-së në të cilën ZPS-ja parashtron se

1 dëshmia e kaluar dhe e tanishme e Zyrapit është "në pjesë të
2 gjerë përputhëse", por përpiqet të largojë, të tërheqë provat
3 shfajësuese, pra, Prokuroria përpiqet të largojë provat
4 shfajësuese në favor të z. Thaçi mbi bazën se ai, siç
5 pretendon Prokuroria "nuk ishte pjesë e rrethit të brendshëm
6 të Shtabit të Përgjithshëm pjesë e të cilit ishin të
7 akuzuarit" dhe ai "nuk kishte besimin e plotë të gjithë
8 pjesëtarëve të UÇK-së, përfshirë disa anëtarë të Shtabit të
9 Përgjithshëm" dhe që për rrjedhojë, "këta faktorë kanë ndikuar
10 në shkallën në të cilën anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm do
11 të diskutojnë apo nivelin në të cilin anëtarët e NKP-së do të
12 diskutojnë hapur politikën ndaj kundërshtarëve me të".

13 ZPS-ja pohon më tej, në paragrafin 1433, se Zyrapin "ka
14 dhënë dëshmi në pjesë të gjerë përputhëse në kohë, në gjykata
15 të ndryshme dhe i ka qëndruar atyre deklaratave".

16 Kjo është në përputhje me mënyrën se si ZPS-ja ka ngritur
17 akuzat dhe paraqitur provat në këtë çështje, pra,
18 përkatësisht, në asnjë moment ZPS-ja nuk e ka identifikuar
19 Zyrapin apo emëruar atë si anëtar i dyshuar i NKP-së së
20 pretenduar.

21 Si përmbledhje, qëndrimi i ZPS-së është që Bislim Zyrapin
22 është përgjithësisht dëshmitar i besueshëm. Ai nuk është
23 identifikuar si pjesë e ndonjë NKP-je dhe për atë ZPS-ja nuk
24 pretendoi që ai të jetë pjesë e ndonjë NKP-je. Provat e ZPS-së
25 janë se ata që ishin anëtarë të NKP-së i kanë mbajtur

1 diskutimet e tyre lidhur me qëllimin kriminal të tyre jashtë
2 pranisë së tij. Qëndrimi i tyre lidhur me Zyrapi ka ndikime
3 domethënëse të rëndësishme në besueshmërinë e tërësishme të
4 provave të ZPS-së. Pse?

5 Diapozitivi 10.

6 Për pjesën më të madhe të periudhës së aktakuzës Zyrapi
7 ka qenë ose shefi i operacioneve, shefi i operativës i UÇK-së
8 ose shefi i gjithë Shtabit të Përgjithshëm. Ai, për rrjedhojë,
9 ka qenë mu në qendër të operacioneve të UÇK-së. Ai ka shkuar
10 në zona dhe ka qenë me Hashim Thaçin kur Hashim Thaçi ka qenë
11 në zona, përfshirë afër Rahovecit në korrik të 1998-s, në
12 zonën e Shalës, së Llapit në gusht të 1998-s dhe në zonën e
13 Dukagjinit në fillim të shtatorit 1998.

14 Dosja përfundimtare e ZPS-së argumenton se të gjitha këto
15 vizita në terren nga z. Thaçi dhe të tjerë kishin për qëllim
16 që të transmetonin dhe të zbatonin qëllimin kriminal të
17 përbashkët.

18 Diapozitivi 11.

19 Dhe dje, dëgjuat z. Halling që citoi P00607, një
20 intervistë të dhënë në gazetë nga z. Zyrapi, të cilën
21 Prokuroria e pranoi si provë jogojore dhe e cila nuk i është
22 treguar kurrë z. Zyrapi nga ZPS-ja për të komentuar në të.
23 ZPS-ja citon artikullin e gazetës për të mbështetur
24 pretendimin se Zyrapi ka kërkuar pëlqimin e z. Thaçi dhe
25 Veseli me qëllim që të vendoste personat që do të mbikëqyrnin

1 në fjalën që ka përdorur ZPS-ja, po citojmë "operacionet e
2 torturës".

3 Diapozitivi 12.

4 Ne jemi natyrisht të dëmtuar nga dështimi i ZPS-së për të
5 paraqitur këtë, mosparaqitja nga ana e ZPS-së e këtij
6 argumenti Zyrapit apo dikujt tjetër. Por si pajtohet qëndrimi
7 i ZPS-së, si arrin ZPS-ja që të gjejë një përputhje të
8 qëndrimit të saj me faktin se Zyrapit nuk ishte anëtar, pjesë e
9 emëruar apo e cituar e ndonjë NKP-je dhe nuk ishte i besuar i
10 anëtarëve të NKP-së edhe si pajtohet kjo me faktin, përputhet
11 kjo me faktin se z. Zyrapit udhëtoi me z. Thaçi në secilën prej
12 këtyre vizitave dhe jo vetëm që ishte i pranishëm por edhe
13 mori pjesë në diskutime? Si e pajton Prokuroria apo gjen
14 përputhje me qëndrimin e saj se z. Zyrapit i cili vendosi
15 persona të caktuar që do të menaxhonin operacionet e torturës
16 me argumentin se z. Thaçi nuk ishte pjesë e NKP-së dhe nuk
17 ishte i besuari i anëtarëve të NKP-së?

18 Diapozitivi 13.

19 Si ZPS-ja mund të arrijë të gjejë një përputhje midis
20 pretendimit të saj se z. Thaçi zbatoi qëllimin e përbashkët
21 kriminal në këto takime në terren me z. Bislim Zyrapit të
22 pranishëm në të gjitha prej tyre me qëndrimin se z. Bislim
23 Zyrapit nuk ishte anëtar i emëruar, i cituar i NKP-së dhe se
24 anëtarët e ashtuquajturës NKP u përpoqën të fshihnin qëllimin
25 e përbashkët kriminal nga ai? ZPS-ja nuk e thotë këtë gjë. Dhe

ky është problemi i përgjithshëm i përbashkët që gjendet në të gjithë dosjen përfundimtare të ZPS-së dhe deklaratën e saj përmyllëse. Ata thjesht shpërfillin të gjitha provat që janë paraqitur në proces që diskreditojnë provat dhe pretendimet e tyre. Video e Qirezit është vetëm një prej këtyre shembujve. Kur rishqyrtohen dhe analizon parashtrimet përfundimtare të ZPS-së është sikur të shihet, të lexohet një film, një kronikë apo analizë e një filmi të shkruar nga dikush i cili nuk e ka parë filmin.

Diapozitivi 14.

Zyrapi dëshmoi se gjatë këtyre vizitave në zona, ai kishte dëgjuar ankesa lidhur me trajtimin e personave brenda zonave dhe që kjo ishte një arsye për të cilën ai lëshoi urdhra në nëntor të 1998-s si shef i Shtabit të Përgjithshëm në përpjekje për të ndaluar keqtrajtimin e çdo personi të mundshëm. Dëshmia e tij mbështetet dhe konfirmohet nga urdhrat me shkrim të asokohe, të cilat ju i keni në prova si provë materiale 1D00029.

Dosja përfundimtare e ZPS-së nuk e kundërshton dëshminë e Zyrapit lidhur me këtë pikë apo se urdhri i tij 1D00029 ishte bërë me qëllime të mira dhe në mënyrë të singertë. Në fakt, ky urdhër konfirmon qëndrimin për të cilin ka dakordësi nga Mbrojtja dhe ZPS-ja se Bislim Zyrapit nuk ishte anëtar i NKP-së.

Diapozitivi 15.

1 Megjenëse po flasim për urdhrin, ju dëgjuat z. Tieger të
2 hënën të sugjerojë se urdhri i datës 28 nëntor 1998 u kuptua
3 se nuk zbatohej ndaj bashkëpunëtorëve sepse ata nuk
4 konsideroheshin të ishin civilë. Megjithatë kjo nuk është ajo
5 që tha ZPS-ja në dosjen e saj përfundimtare.

6 Siç e shihni në këtë diapozitiv, paragrafi 871 i dosjes
7 përfundimtare të ZPS-së, ZPS-ja i referohet urdhrave të
8 Shtabit të Përgjithshëm për të ndaluar bashkëpunëtorët dhe
9 nëse shihni dokumentet e cituara në poshtëshënimin, 1D29 është
10 njëri prej tyre.

11 Diapozitivi 16.

12 Zyrapë gjithashtu konfirmoi në të dyja intervistat me
13 ZPS-në dhe dëshminë e tij nën gjyq se urdhri zbatohej edhe
14 ndaj bashkëpunëtorëve.

15 Diapozitivi 17.

16 Por edhe kur shohim urdhrin asnjë nuk sugjeron apo nuk lë
17 të mendohet aty se ai urdhër përjashtonte bashkëpunëtorët. Ju
18 tërheq vëmendjen në paragrafët 1, 3 dhe 4 të urdhrin.

19 Paragrafi 1 thotë:

20 "... të zhduket fenomeni negativ dhe abuzimi ndaj
21 personave ..."

22 I njëjti paragraf, e njëjta gjë në paragrafin 4, që i
23 referohet:

24 "Arrestimit, ndalimit dhe burgosjes së personave ..."

25 Fjalët aty nuk përmendin "civilë". Kur urdhri do donte

1 t'ju referohej civilëve në mënyrë konkrete e ka bërë këtë dhe
2 mund të shohim paragrafin 3 për këtë qëllim.

3 Diapozitivi 18.

4 Pra, se si mundet ZPS-ja të gjejë përputhje mes qëndrimit
5 të saj se z. Zyrapi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, nxirrte
6 urdhra që pretendohet të kishin qëllime të kundërta me
7 qëllimin kriminal të përbashkët të pretenduar të anëtarëve të
8 tjerë të Shtabit të Përgjithshëm? Për çfarë arsye anëtarët e
9 NKP-së do të mund ta lejonin atë që ndalonte apo të pengonte
10 objektivat e tyre kriminale? ZPS-ja këtë gjë nuk e thotë.

11 Ne themi se 1D29, e lëshuar nga dikush mu në qendër të
12 operacioneve të UÇK-së, vërteton interpretimin e arsyeshëm të
13 provave se nuk ka ekzistuar NKP që përfshinte Shtabin e
14 Përgjithshëm siç e pretendon ZPS-ja.

15 Diapozitivi 19.

16 Një problem tjetër që paraqet Zyrapi për shqetësimet e
17 ZPS-së se pretendimi i ZPS-së në dosjen e tyre përfundimtare
18 se disa drejtori në Shtabin e Përgjithshëm janë përdorur dhe
19 kanë shërbyer për zbatimin e qëllimit kriminal të përbashkët,
20 përfshirë drejtorinë për administratë civile, drejtorinë e
21 policisë ushtarake, drejtorinë e personelit.

22 Megjithatë, të gjitha këto drejtori ishin vartëse të
23 Bislit Zyrapi në cilësinë e tij si shef i Shtabit të
24 Përgjithshëm. Ju e shihni këtu në këtë Diapozitiv organigramën
25 e Shtabit të Përgjithshëm të cilën ZPS-ja ua tregoi juve të

1 hënën. Ju shihni këtu këto drejtori. ZPS-ja pretendon se këto
2 drejtori kanë qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë vartëse të
3 Zyrapit. Ju shihni këtu se nuk pretendohet se ato kanë qenë
4 vartëse, drejtori nën autoritetin e z. Hashim Thaçi.

5 Ju duhet gjithashtu të kini parasysh se të mbani parasysh
6 të konstatoi se ZPS-ja konfirmoi se përveç të akuzuarve ata
7 në kutitë e zeza janë anëtarë të pretenduar të NKP-së dhe ata
8 që nuk janë në kutitë e zeza nuk pretendohen të jenë anëtarë
9 të NKP-së. Zyrapit është njëri prej atyre që nuk pretendohet të
10 ketë qenë anëtar i NKP-së.

11 Diapozitivi 20.

12 ZPS-ja gjithashtu vuri në dukje, theksoi në deklaratën e
13 tyre përmbyllëse se Zyrapit merrte raporte nga zonat lidhur me
14 luftën speciale. Megjithatë, qëndrimi i tyre është po ashtu se
15 z. Zyrapit nuk ishte në NKP.

16 Diapozitivi 21.

17 Tani si mund të gjej përputhje ZPS-ja midis qëndrimit të
18 saj se drejtori të shumta në Shtabin e Përgjithshëm zbatonin
19 qëllimin kriminal të përbashkët edhe ndërkohë që personi
20 përgjegjës për udhëheqjen si udhëheqës i këtyre drejtorive nuk
21 pretendohet të ketë bërë një gjë të tillë? Dhe si ai mund të
22 mos ketë qenë në dijeni të këtij qëllimi të përbashkët -- të
23 këtij qëllimi kriminal nëse këto drejtori ishin të varura nga
24 ai?

25 Diapozitivi 22.

1 Çështja tjetër për shqetësimet e ZPS-së është pretendimi
2 i përsëritur në të gjithë dosjen përfundimtare se Shtabi i
3 Përgjithshëm ka marrë vendimet në mënyrë kolektive përmes një
4 procesi vendimmarrje kolektive. Shihni paragrafët 64, 103,
5 113, 471, 480, 481, 504, 512, 515, 612 të dosjes
6 përfundimtare.

7 Në fakt, në paragrafin 64, ZPS-ja parashtroi se
8 mbështetet në deklaratën dhënë TPNJ-së në vitin 2006 nga Sokol
9 Bashota për pretendimin se dhe po citojmë këtu, "ka patur një
10 vendim kolektiv të Shtabit të Përgjithshëm me anë të cilit
11 autorizoheshin masa shtesë ndaj bashkëpunëtorëve". Provat e
12 ZPS-së, qëndrimi i ZPS-së është se Shtabi i Përgjithshëm ka
13 marrë këto vendime në mënyrë kolektive përfshirë për çështjen
14 e kolaboratorëve.

15 Diapozitivi 23.

16 Qëndrimi i ZPS-së gjithashtu apo provat e ZPS-së nuk
17 pretendojnë se Zyrapit si shef i Shtabit të Përgjithshëm ka
18 qenë vetë anëtar i NKP-së. Në dosjen e tyre përfundimtare ZPS-
19 ja ka sqaruar më tej se z. Zyrapit pretendohet "të mos ishte
20 pjesë e rrethit të brendshëm të Shtabit të Përgjithshëm në të
21 cilin të ishin të akuzuarit" dhe se "nuk kishte besimin e
22 plotë të anëtarëve të UÇK-së përfshirë të disa anëtarëve të
23 Shtabit të Përgjithshëm", që, për rrjedhojë, "këta faktorë
24 ndikojnë në shkallën në të cilën anëtarët e NKP-së do të
25 diskutonin në mënyrë të hapur politikën ndaj kundërshtarëve me

1 të". Siç e thamë në herët, kjo u konfirmua dhe në deklaratën
2 përmyllëse.

3 Duke lënë mënjanë për një çast mungesën e besueshmërisë
4 së deklaratës dhënë TPNJ-së nga Bashota në vitin 2006, të
5 cilën do ta trajtojmë më vonë, ZPS-ja, duke pranuar se Zyrapin
6 nuk ishte anëtar i NKP-së, në mënyrë të qartë pranon se
7 vendimmarrja kolektive edhe në rastin e politikës ndaj
8 bashkëpunëtorëve nuk e vënë automatikisht çdo anëtar të
9 Shtabit të Përgjithshëm si pjesë të NKP-së. Ndryshe ZPS-ja do
10 të kishte identifikuar Zyrapin si anëtar të NKP-së,
11 veçanërisht duke qenë se ai ishte shef i Shtabit të
12 Përgjithshëm.

13 Diapozitivi 28.

14 ZPS-ja ju kërkon që t'i nxirrni këto dy deduksione pas
15 një gjyqi në të cilin ZPS-ja ka pasur frikë që t'i tregojë
16 vetëm një dëshmitari të vetëm nëse ishte ky i Prokurorisë apo
17 i Mbrojtjes.

18 Ka pasur frikë ZPS-ja dhe nuk e përdor lehtësisht këtë
19 fjalë, ka patur frikë që argumentet e saj t'ia tregojë
20 dëshmitarëve dhe ky është një pranim se çfarë mendon ajo për
21 argumentet e veta. Sesi nuk ka prova konkrete për t'i
22 konfrontuar dëshmitarët dhe për t'i hedhur poshtë argumentet e
23 tyre.

24 Diapozitivi 29.

25 Deri tani, jurisprudenca e gjykatave ndërkombëtare e

1 tribunalëve ka konkluduar se NATO ka ndërhyrë ushtarakisht në
2 Kosovë në 1999-n në përgjigje të një NKP-je serbe e cila
3 filloi jo më vonë se tetori i 1998-s. ZPS-ja ju kërkon juve që
4 të arrini në përfundimin, vetëm bazuar në deduksione, që UÇK-
5 ja ishte ajo që ishte anëtarja apo administratorja e një
6 ndërmarrje të përbashkët kriminale muaj apo vite më përpara
7 dhe jo më vonë se marsi i 1998.

8 Më vonë, jurisprudenca e TPNJ-së ka konkluduar se ishte
9 udhëheqësi i serbëve presidenti Milan Milutinovic, që nuk
10 kishte përgjegjësi penale për ngjarjet e Kosovës të 1998-s,
11 1999-s për shkak se ai ishte një figurë politike që nuk ka
12 patur kontroll mbi forcat RFI-së dhe në këtë mënyrë nuk ka
13 dhënë kontribut të ndjeshëm ndaj NKP-së. ZPS-ja po ju kërkon
14 juve që të përfundoni që pavarësisht presidenti serb i një
15 shteti të organizuar nuk ka patur përgjegjësi penale për
16 krimet masive të luftës dhe krime kundër njerëzimit për shkak
17 se nuk ka patur kontroll efektiv, vetëm bazuar mbi deduksion,
18 ju duhet të konkludoni që udhëheqësi politik i shqiptarëve të
19 Kosovë dhe i UÇK-së, një grup i armatosur joshtetëror i cili
20 kishte ekzistuar vetëm për disa muaj, ka patur kontroll
21 efektiv dhe ka marrë përgjegjësi penale. Ky rezultat duhet të
22 jetë për version historik dhe një padrejtësi ligjore dhe
23 historike.

24 Diapozitivi 30.

25 Të nderuar Gjykatës, argumentet e ZPS-së nuk përbëjnë

1 interpretimin më të arsyeshëm të vetëm të provave, që është
2 standardi që duhet arritur me qëllim që ju të rishkruani
3 historinë e Kosovës në këtë rast dhe për ta gjetur fajtor
4 Hashim Thaçin. Ka dyshime të bazuara të mjaftueshme për ju që
5 ta shpallni atë jo fajtor për të gjitha pikat e aktakuzës.

6 Tani do t'i kthehem seksionit që ka të bëjë nëse ka patur
7 apo jo një NKP.

8 Diapozitivi 32.

9 Në thelb të argumenteve të ZPS-së është pretendimi
10 qendror që ka ekzistuar një synim i përbashkët kriminal "për
11 të marrë dhe për të kontrolluar të gjithë Kosovën përmes
12 krimeve të luftës dhe krime kundër njerëzimit". Siç e kam
13 thënë, ZPS-ja ju kërkon juve që të konkludoni përtej dyshimit
14 ët arsyeshëm që ka ekzistuar ky synim penal bazuar mbi
15 deduksione të qarta dhe nuk ka patur prova të drejtpërdrejta
16 që ka ekzistuar një plan i tillë. Nuk ka patur prova të
17 takimeve ku është diskutuar ky synim, nuk ka dokumente
18 shkresore që të tregohet që është rënë dakord apo është
19 diskutuar ky synim. Nuk ka dhënë dëshmi asnjë dëshmitar lidhur
20 me ekzistencën e këtij synimi. Në fakt, secili prej
21 dëshmitarëve që ka patur mundësinë që të flasë mbi këtë
22 çështje e ka hedhur poshtë teorinë e ZPS-së. Dhe më keq, ZPS-
23 ja nuk i ka bërë pyetje për këtë asnjë dëshmitari.

24 Pretendimit të hënën i ZPS-së që po shfrytëzonte provat e
25 drejtpërdrejta për të mbështetur argumentet e tyre, në fakt,

1 është keqkuptim i drejtpërdrejtë se çfarë është një provë e
2 drejtpërdrejtë. Prova e drejtpërdrejtë është një provë e cila
3 provon në fakt pa patur nevojë për të pasur deduksione. Çfarë
4 ishin provat e drejtpërdrejta të një synimi të përbashkët
5 kriminal të cilin nuk e njihte Zyrapin, që nuk e ka njohur
6 Zyrapin apo komunitetin ndërkombëtar?

7 ZPS-ja nuk ka dhënë prova që të jenë mbajtur takime të
8 Shtabit të Përgjithshëm ku të jetë diskutuar lidhur me synimin
9 e përbashkët kriminal apo të jetë rënë dakord me këtë, ZPS-ja
10 ka bërë asnjë pretendim në dosjen e saj që Thaçi ka marrë
11 pjesë në takime të Shtabit të Përgjithshëm ku është diskutuar
12 shënjestrimi i kundërshtarëve.

13 Diapozitivi 33.

14 ZPS-ja ngre pretendimin e tërësishëm, në paragrafin 75 të
15 dosjes së saj, që "janë diskutuar rregullisht në mbledhjet dhe
16 takimet e Shtabit të Përgjithshëm lufta speciale dhe
17 kundërshtarët". Por nuk ka patur diskutim në dosjen e ZPS-së
18 lidhur me takime të kësaj natyre. ZPS-ja ia lë Trupit Gjykses
19 që të kontrollojë poshtëshënimet dhe t'i gjejë këto dokumente
20 me qëllim që të kuptojë se për çfarë takimesh e ka fjalën ZPS-
21 ja dhe çfarë është diskutuar në këto takime. Dhe po të
22 kontrollosh këto poshtëshënime, shihet se pse e ka shmangur
23 ZPS-ja diskutimin substantiv apo thelbësor të takimeve të
24 Shtabit të Përgjithshëm.

25 Diapozitivi 34.

1 Për shembull, në poshtëshënimin 283, ZPS-ja arrin të
2 identifikojë vetëm dy takime ku pretendon që të jenë diskutuar
3 kundërshtarët dhe lufta speciale, takimi i 16 gushtit dhe një
4 tjetër të 29 dhjetorit.

5 Diapozitivi 35.

6 Takimi i 16 gushtit ishte takimi në të cilin është bërë
7 një diskutim i posaçëm lidhur me shënjestrimin e UÇK-së nga
8 ana e Tahir Zemajt dhe e FARK-ut me qëllim që ta merrnin në
9 kontrollin e saj. Së pari, ZPS-ja nuk ka treguar, nuk ka
10 vërtetuar që z. Thaçi të ketë marrë pjesë në këtë takim fare.
11 Në fakt, në dosjen përfundimtare ZPS-ja as nuk e ngre
12 pretendimin që z. Thaçi të ketë qenë i pranishëm në këtë takim
13 të 16 gushtit. Dhe dëshmia e Bislim Zyrapit që ndodhet në
14 ekran edhe intervista e tij për ZPS-në dhe dëshmia në sallë,
15 ku ka konfirmuar që ai ka qenë i pranishëm në atë takim po nuk
16 i kujtohet nëse z. Thaçi të ketë marrë pjesë.

17 Diapozitivi tjetër nuk duhet transmetuar publikisht,
18 është diapozitivi 36.

19 Së dyti. Trupi Gjykues ka parë prova që nuk ishte UÇK-ja
20 e cila ka shënjestruar Tahir Zemajn, por Tahir Zemaj dhe Bujar
21 Bukoshi të cilët kanë shënjestruar UÇK-në me qëllim që Bukoshi
22 të merrte kontrollin e UÇK-së. Provat nuk tregojnë që të jetë
23 mbajtur ndonjë diskutim i një politike të gjerësishme që të
24 shënjestrohen kundërshtarët me qëllim që të merrej kontrolli i
25 Kosovës dhe të ushtrohej kontrolli mbi tërë territorin e saj.

Diapozitivi tjetër mund të transmetohet publikisht, është 37.

Takimi i dytë që citon ZPS-ja është takimi i 29 dhjetorit në të cilin z. Thaçi nuk ka marrë pjesë për shkak se nuk ishte fare në vend dhe ZPS-ja nuk ka pretenduar që ai të ketë marrë pjesë në këtë takim.

Për rrjedhojë, në dosjen e saj përfundimtare ZPS-ja nuk ka qenë në gjendje as të identifikojë asnjë takim të vetëm të Shtabit të Përgjithshëm në të cilin të pretendojë që të ketë marrë pjesë z. Thaçi dhe ku të jetë diskutuar tema e kundërshtarëve dhe luftës speciale.

Dhe si një pjesë anësore, të nderuar Gjykatës, po ju kujtoj këtu se ZPS-ja të hënën ka kujtuar se dëshmia e 2006 e TPNJ-së e z. Sokol Bashota, në të cilën aty thuhet që Shtabi i Përgjithshëm nxirrte urdhra kolektivë për të vrarë bashkëpunëtorët nuk ishte hipotetike, pasi Bashota ju tha, siç ju ka thënë Bashota. Do të flas për deklaratën e Bashotës më vonë, por tani, mjafton që të thuhet që Prokuroria nuk ka identifikuar asnjë takim në të cilin të jetë bërë një diskutim i tillë.

Takimet e vetme të cilat ajo citon janë këto dy takime: i 16 gushtit dhe 29 dhjetorit.

Diapozitivi 38.

Të nderuar Gjykatës, duke lënë mënjanë për një çast faktin se ZPS-ja as nuk pretendon që z. Thaçi të ketë qenë i

1 pranishëm në ndonjërin prej këtyre dy takimeve, është e
2 rëndësishme që të kontrastohen pretendimet e ZPS-së që janë
3 diskutuar takimet për kundërshtarët dhe luftën speciale në
4 takimin e 16 dhe 29 dhjetorit me qëndrimin e ZPS-së që Bislim
5 Zyrapi ka qenë një person i jashtëm, nuk ishte anëtar i NKP-
6 së, nuk ka pasur besim në të nga anëtarët e NKP-së dhe se janë
7 diskutuar hapur me të politika e NKP-së kundër kundërshtarëve.

8 Diapozitivi 39.

9 Zyrapi ju tha që ka marrë pjesë në takimin e 16 gushtit -
10 ndodhet në faqen 17389 të transkriptit. Ju e keni në ekran. Në
11 qoftë se z. Zyrapi ishte i pranishëm dhe në qoftë se ju mund
12 të nxirrni deduksionin e arsyeshëm që nuk ka patur diskutim
13 lidhur me marrjen e kontrollit e të tërë Kosovës përmes
14 kryerjes së krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në
15 bazë të faktit që ZPS-ja e pranon që z. Bislim Zyrapi nuk ka
16 qenë anëtar i NKP-së dhe nuk ka marrë pjesë në këto diskutime.

17 Për më tepër, ZPS-ja e ka pyetur Zyrapin lidhur me
18 diskutime në takimin e 16 gushtit lidhur me caktimin e
19 komandantëve dhe me krijimin e brigadave, por nuk i bëri atij
20 asnjë pyetje të vetme lidhur nëse ka patur ndonjë diskutim
21 lidhur me shënjestrimin e kundërshtarëve në këtë takim. ZPS-ja
22 nuk mund të pretendojë që Zyrapi nuk ka qenë i ndershmë lidhur
23 me këtë takim për shkak të "klimës së frikësimit në Kosovë"
24 për shkak në qoftë se nuk e ka pyetur atë lidhur me këtë
25 çështje për këtë takim.

1 Diapozitivi 40.

2 Zyrapi ishte i pranishëm dhe në takimin e 29 dhjetorit.

3 Në fakt, prova P621 tregon që vetë Zyrapi e ka thirrur këtë
4 takim të drejtorive të tij më datën 29 dhjetor. Dhe P1408
5 tregon që vetë Zyrapi e ka kryesuar këtë takim në të cilin ka
6 marrë pjesë B. Luzha, Adem Grabovci, Fatmir Limaj, Ramë Buja
7 dhe Sali Veseli. Kjo provë ndodhet në ekranet tuaj tani. Nuk
8 ka prova që në këtë takim të ketë marrë pjesë ndonjëri prej
9 katër të akuzuarve dhe nuk është hedhur poshtë fakti nga ZPS-
10 ja që Thaçi nuk ka qenë as në vend. ZPS-ja e citon këtë takim
11 dhe në poshtëshënimin 283 për të mbështetur pretendimin që në
12 takimet e Shtabit të Përgjithshëm është diskutuar rregullisht
13 çështja e kundërshtarëve dhe luftës speciale.

14 Diapozitivi 41.

15 Si atëherë është e mundur që një takim në të cilin të
16 kenë marrë pjesë të katër të akuzuarit të cilin ta ketë
17 kryesuar z. Bislim Zyrapi, një person të cilin nuk e besonin
18 anëtarët e NKP-së, që të tregojë që ka ekzistuar një synim i
19 përbashkët kriminal lidhur me këta katër të akuzuarit? ZPS-ja
20 hesht në këtë.

21 ZPS-ja sugjeroi në pyetjet që i bëri z. Zyrapi që mund të
22 jenë mbajtur dy takime më datën 29 dhjetor: një i drejtuar nga
23 Zyrapi që kishte të bënte me drejtoritë që kishte nën kontroll
24 ai dhe një tjetër Shtabit të Përgjithshëm. Por për këtë nuk ka
25 prova. Dhe nuk ka treguar ZPS-ja se kush marrë pjesë në

1 takimin e dytë, këtë takim të dytë të 29 dhjetorit. Për më
2 tepër, ZPS-ja nuk ka provuar as se Zyrapi nuk ka marrë pjesë
3 në këtë takim. ZPS-ja asnjëherë nuk e ka pyetur Zyrapi në që ai
4 vetë nuk ka marrë pjesë në këtë takim të dytë.

5 Dhe për rrjedhojë edhe një herë, ngrihet pikëpyetja se si
6 mund të pretendojë ZPS-ja që në takimin e 29 dhjetorit ishte
7 një takim i cili çonte më tej synimin e përbashkët kriminal
8 duke pasur parasysh që Zyrapi ka gjasa të ketë qenë në këtë
9 takim dhe nuk është informuar lidhur, sipas ZPS-së, me
10 ekzistencën e këtij synimi të përbashkët kriminal.

11 Diapozitivi 42.

12 Kaq pra. Këto janë provat që citon ZPS-ja për të
13 pretenduar që janë diskutuar në takimet e Shtabit të
14 Përgjithshëm kundërshtarët dhe lufta speciale. Nuk ka asnjë
15 pretendim në dosjen e ZPS-së që z. Thaçi të ketë marrë pjesë
16 në njërin prej këtyre takimeve.

17 Diapozitivi 43.

18 Në paragrafin 110, poshtëshënimin 402 i dosjes
19 përfundimtare të ZPS-së, ajo ka paraqitur një listë të
20 takimeve të Shtabit të Përgjithshëm.

21 Diapozitivi 44.

22 Dhe në poshtëshënimin 405, ka paraqitur një listë të
23 takimeve të pretenduara të Qeverisë së Përkohshme.

24 Sa për zyrtarisht, ne hedhim poshtë që këto kanë qenë
25 takime zyrtare të Qeverisë së Përkohshme dhe jo takime ku kanë

1 marrë pjesë disa anëtarë të qeverisë së përbashkët.

2 Përveç këtyre takimeve, janë vetëm dy takime në të cilat
3 ku thuhet që janë diskutuar lufta speciale dhe për të dyja kam
4 folur tashmë.

5 Diapozitivi 45.

6 Z. Thaçi nuk ka qenë në vend për një pjesë të madhe të
7 periudhës që përmban aktakuza dhe nuk ka provë që ai të ketë
8 marrë pjesë në takimet e Shtabit të Përgjithshëm.

9 Diapozitivi 46.

10 ZPS-ja, në paragrafin 113, përpiqet që ta anashkalojë
11 problemin e mungesës së z. Thaçi nga Kosova duke argumentuar
12 që anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm janë konsultuar përmes
13 telefonit apo janë informuar më pas lidhur me rezultatet e
14 takimeve të Shtabit të Përgjithshëm. Por shembulli i vetëm që
15 citojnë është rasti i tetë ushtarëve të ushtrisë jugosllave,
16 të armatës jugosllave.

17 Ne parashtrojmë se çështja e tetë ushtarëve jugosllavë
18 është përjashtim dhe jo rregull. Nuk mund të merret një rast i
19 posaçëm në të cilin ka luajtur rol z. Thaçi mbi bazë të rolit
20 të tij në emër -- sipas fjalëve të ambasadorit Hill dhe Shaun
21 Byrnes, si në rolin e ministrit të jashtëm dhe në këtë kuadër
22 ka marrë pjesë në diskutime lidhur me ushtarët jugosllavë për
23 shkak të pjesëmarrjes në këtë të diplomatëve të lartë amerikan
24 si Ambasadori Hill dhe Walker dhe nga kjo të nxirret
25 konkluzioni se nga ky incident i vetëm që për çdo diskutim të

1 Shtabit të Përgjithshëm është diskutuar më të përmes
2 telefonit. Kërkohen prova, kjo nuk mund të bëhet përmes
3 deduksionit të arsyeshëm.

4 Për më tepër, në mënyrë të tërthortë ZPS-ja e pranon në
5 dosjen e saj që për shkak se dikush ka patur një rol në
6 lirim të tetë ushtarëve jugosllavë nuk do të thotë që kanë
7 qenë anëtarë të NKP-së apo që të kenë përgjegjësinë penale.

8 Kalojmë te tre diapozitivat e tjerë, nuk duhet të
9 transmetohen publikisht.

10 Di48.

11 Bislim Zyrapi ka luajtur rol drejtpërdrejtë në incidentin
12 për lirim të tetë ushtarëve jugosllavë. Ai është pyetur
13 gjerësisht lidhur me këtë nga ZPS-ja. Dhe kjo ndodhet në faqen
14 17520-523 të transkriptit. Ai ka marrë pjesë edhe në çështje
15 që kanë të bëjnë me personat e tjerë të ndaluar. Këto citime
16 paraqiten në ekranin që është para jush tani. Megjithatë, ZPS-
17 ja e pranon që ai nuk ka qenë pjesë e ndonjë synimi të
18 përbashkët kriminal për shkak se ai ka marrë pjesë në
19 diskutimet për lirim të tyre.

20 Diapozitivi 49.

21 I njëjti argument atëherë duhet të zbatohet për Hashim
22 Thaçin. Vetëm për shkak se u konsultua lidhur me lirim të
23 tetë ushtarëve serbë për shkak se ishte një incident
24 ndërkombëtar me pasoja diplomatike nuk do t'i jap atij rol më
25 të madh kriminal lidhur me procesin e parandalimit sesa ai që

1 ka patur Zyrapi.

2 Diapozitivi 50.

3 Për më tepër, fakti që anëtarët e tjerë të Shtabit të
4 Përgjithshëm e kanë injoruar qëndrimin e Thaçit që duhet të
5 liroheshin në të njëjtën kohë ushtarët serbë dhe ata të UÇK-
6 së, tregon në fakt se mendimet e z. Thaçi nuk ishin
7 vendimtare.

8 Ky diapozitiv mund të transmetohet, 51.

9 Për të mbështetur pohimin se Shtabi i Përgjithshëm duhet
10 të informojë lidhur me diskutimet e Shtabit të Përgjithshëm
11 pas kthimit të tyre, ZPS-ja ka shembull në paragrafin 114, 148
12 ku thuhet se Sylejman Selimi në shkurt të 1999-s u propozua
13 nga anëtarët e zonave që të ishte komandant i përgjithshëm dhe
14 se emërimi i tij nuk u miratua deri pas kthimit të
15 delegacionit të Rambujesë.

16 Diapozitivi 52.

17 Ky pretendim hidhet poshtë nga prova 1D250, e cila
18 përcakton që z. Sylejman Selimi e ka deklaruar veten si
19 komandant i tërësishëm i UÇK-së më 22 shkurt 1999, në kohën që
20 delegacioni i UÇK-së ende ndodhej në Rambuje. Këtë e shihni në
21 ekran. Sylejman Selimi u emërua nga komandantët e zonave dhe
22 jo u propozua thjesht nga ata. Këtë e keni dëgjuar edhe nga
23 Bislum Zyrapi.

24 Dhe ndërkohë që po diskutojmë këtë çështje, z. Quick tha
25 të hënën që pavarësisht se vendimi përfundimtar lidhur me

1 Marrëveshjen e Rambujesë u nënshkrua nga anëtarët e tjerë të
2 Shtabit të Përgjithshëm nuk ishte nënshkruar nga Sylejman
3 Selimi. Dhe kjo ndodhet në faqen 28481-28482. Ja vlen të
4 shënohet se ZPS-ja nuk e ka pyetur Sylejman Selimin apo
5 ndokënd tjetër që ai nuk ka qenë dakord me Marrëveshjen e
6 Rambujesë. Edhe në këtë rast, ZPS-ja ka patur frikë se çfarë
7 përgjigje do t'i jepej.

8 Diapozitivi 53.

9 Por siç mund ta shihni nga intervista, një pjesë e
10 intervistës së Sylejman Selimit në ekran, të cilën e ka
11 pranuar si provë materiale ZPS-ja, Selimi ka konfirmuar që
12 Thaçi e ka konsultuar atë dhe Selimi i ka dhënë atij miratimin
13 më pas. Kjo është prova e vetme e pranuar e cila e trajton
14 këtë aspekt.

15 Diapozitivi 54.

16 Në diapozitivin tjetër tregohet një fotografi nga takimi
17 i marsit të 1999-s kur Selimi e dha miratimin e tij ndaj
18 Thaçit. Edhe në këtë rast është prova materiale e vet
19 Prokurorisë.

20 Diapozitivi 55.

21 Dhe si shënim përfundimtar këtu, dje, gjatë diskutimit të
22 takimit të shkurtit që u zhvillua mes komandantëve të zonave
23 dhe disa prej anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm, z. Halling
24 deklaroi që Mbrojtja po përpiqej që këtë takim ta paraqiste si
25 një grusht shteti nga komandantët e zonave. Është në faqen

1 28519 e transkriptit.

2 ZPS-ja asnjëherë nuk e ka hedhur poshtë pranimin nga ana
3 e Remit që ka ekzistuar një grusht shteti apo të Zyrarit që ka
4 thënë të njëjtën gjë, apo Shaun Byrnes, i cili ishte në Kosovë
5 në atë kohë, ka patur takime të gjerësishme me UÇK-në dhe i
6 cili është pyetur gjerësisht lidhur me këtë grusht shteti dhe
7 konfirmoi se ka patur dijeni lidhur me ekzistencën e këtij
8 grusht shteti. Në fakt, nuk ishte Mbrojtja që e ka quajtur atë
9 grusht shteti, por Byrnes e quajti "një grusht shteti i
10 pallatit mbretëror" në një telegram të koduar të cilën
11 Prokuroria e ka pranuar si prova materiale P1080. Për të thënë
12 që nuk ka patur grusht ushtarak apo që nuk ka ekzistuar një
13 deduksion i arsyeshëm që ka patur këtë edhe kjo është një
14 argument jo serioz që ngrihet nga ana e ZPS-së.

15 Do të doja që të kalonim disa minuta për të diskutuar
16 dëshminë e Bislim Zyrarit dhe si mund të ndikojë ai në
17 argumentet që ngre ZPS-ja lidhur me ekzistencën e NPK-së.

18 Pranimin nga ZPS-ja që Zyrari është një dëshmitar i
19 besueshëm dhe që nuk ishte anëtar i një ndërmarrje të
20 përbashkët kriminale, në fakt, hedh poshtë atë argumentin e
21 ZPS-së lidhur me këtë shtëpi magjike.

22 Diapozitivi 56.

23 Shikoni këtu rolin e Shtabit të Përgjithshëm. Shikoni
24 dëshminë e tij në ekran ku pranon që ka qenë kryetar, shef i
25 Shtabit të Përgjithshëm dhe pranimin e tij që nën varësinë e

1 tij ishin edhe drejtoritë. Ai ishte në qendër të çdo gjëje që
2 ndodhte në Shtabin e Përgjithshëm. Në qoftë se në Shtabin e
3 Përgjithshëm ka ekzistuar një NKP, nuk ka patur mundësi që ai
4 të mos ketë patur dijeni lidhur me këto çështje. Dhe urdhri i
5 tij në provën 1D29 përcakton që ka ekziston një deduksion i
6 arsyeshëm që nuk ka patur NKP dhe ai nuk ka marrë pjesë në
7 asnjë NKP.

8 Dy diapozitivat e tjerë nuk duhet të transmetohen
9 publikisht, është 57 tjetra.

10 Dëshmia e Zyrapit është se nuk ka patur NKP në Shtabin e
11 Përgjithshëm dhe këtë e ka thënë të paktën që nga viti 2005,
12 kur i tha TPNJ-së që përpara fundit të nëntorit 1999, Shtabi i
13 Përgjithshëm nuk kishte lëshuar urdhra lidhur me çështjen e
14 parandalimeve dhe parandalimet apo të paraburgosurit ishin
15 çështje me të cilat janë marrë komandantët e zonave. I tha
16 TPNJ-së se kishte dëgjuar ankesa lidhur me këto paraburgime
17 kur ka takuar komandantët lokalë në ato zona dhe se ka lëshuar
18 urdhër në fund të nëntorit 1998, të cilin ju e njihni se është
19 prova materiale 1D29, me qëllim që të merreshin masa
20 disiplinore dhe që ushtarët e dinin se cilat ishin procedurat
21 që duheshin ndjekur në këto raste. E shihni në ekranin tuaj
22 dëshminë e tij të 2005.

23 Kalojmë në diapozitivin 58.

24 Zyrapit i tha TPNJ-së në 2005 që "deri në fund të 1998-s,
25 është fakt i njohur që komandantët e zonave kanë patur shumë

1 më shumë fuqi sesa Shtabi i Përgjithshëm".

2 Diapozitivi tjetër mund të transmetohet publikisht, është
3 59.

4 Përpara jush ai ra dakord që grushti i shtetit nga
5 komandantë të zonave në shkurt të 1999-s ka demonstruar që
6 komandantët e zonave kanë patur pushtet real deri në vitin
7 1999 dhe jo deri nga fundi i 1998.

8 Diapozitivi 60.

9 Për më shumë se 20 vite, Zyrapi ka thënë që nuk ka patur
10 urdhra nga Shtabi i Përgjithshëm që të kishin të bënë me
11 paraburgim përpara urdhrit të tij nga fundi i nëntorit të
12 1998. Zyrapi ka thënë për më shumë se 20 vite që ishin
13 komandantët e zonave të cilët kishin paraburgosur njerëzit dhe
14 jo Shtabi i Përgjithshëm. ZPS-ja nuk mund ta hedhë dëshminë e
15 tij poshtë si dëshmia e një personi i cili e ka ndryshuar atë
16 për shkak të klimës së frikës në Kosovë apo për shkak të
17 marrëdhënieve që tani ka me z. Thaçi. Dëshmia e tij ka qenë e
18 përputhshme për një kohë shumë të gjatë dhe ZPS-ja e ka
19 pranuar në paragrafin 1433 të dosjes së saj ku thotë dhe citoj
20 që Zyrapi "ka dhënë dëshmi të përputhshme për një kohë të
21 gjatë përpara disa gjykatave dhe ju ka qëndruar deklaratave që
22 ka bërë".

23 Diapozitivi 61.

24 Si mundet Zyrapi, që ka lëshuar shumë prej urdhrave, të
25 mos ketë patur dijeni lidhur me ekzistencën e kësaj politike?

1 Në paragrafin 74 të dosjes përfundimtare të ZPS-së dhe është
2 në ekranin tuaj, mund të shihni që ZPS-ja thotë që Zyrapi më
3 datën 28 nëntor 1998 lëshoi një urdhër dhe në të cilin citoj
4 "ka arritur kontrollin e centralizuar lidhur me arrestimet dhe
5 paraburgimet duke dhënë urdhrin që ato urdhra për këtë do të
6 lëshoheshin vetëm nga komandantët e brigadave apo eprorët e
7 lartë, përveç rasteve kritike ushtarake apo kur ka patur 'akte
8 kriminale kundër anëtarëve të UÇK-së, individëve apo
9 autoriteteve civile'".

10 Pra, ZPS-ja thotë që ishte Zyrapi ai i cili kishte rritur
11 kontrollin e centralizuar lidhur me arrestimet dhe
12 paraburgimet dhe që ishte ai personi në të cilin nuk kanë
13 patur besim anëtarët e tjerë të NKP-së që ta përfshinin si
14 anëtar i kësaj politike të përgjithshme dhe është një person
15 për të cilin nuk pretendohet që të ketë qenë anëtar i NKP-së.

16 Diapozitivi 62.

17 Atëherë si e pajton qëndrimin e saj ZPS-ja që shef i
18 shtabit të ketë qenë -- të mos ketë marrë pjesë në këtë synim
19 kriminal por të ketë patur kontroll mbi parandalimet dhe
20 arrestimet?

21 Në poshtëshënimet 88 ato citojnë Zyrapin kur thotë që
22 Shtabi i Përgjithshëm "do të donte t'i tregonte
23 ndërkombëtarëve që ne ishim një ushtri e disiplinuar". Edhe
24 poshtëshënimi i ZPS-ja edhe dëshmia e Zyrapit ndodhen para
25 jush.

1 Zyrapi, ai tha kështu. Shtabi i Përgjithshëm e dinte që
2 kishte nevojë për komunitetin ndërkombëtar. Ai donte të
3 perceptohej se po zbatonte të drejtën, standardet e të drejtës
4 ndërkombëtare. Zyrapi i ka lëshuar këto urdhra pikërisht për
5 këtë arsye mes të tjerave. Dhe kjo vërteton se në këtë mënyrë
6 mund të interpretohet në mënyrë të arsyeshme dëshmia se Shtabi
7 i Përgjithshëm po përpigëj që ta ndalonte keqtrajtimin e
8 personave dhe jo ta nxiste atë.

9 Diapozitivi 63.

10 Në qoftë se të akuzuarit kanë qenë, kanë marrë pjesë në
11 një synim të përbashkët kriminal për të kryer krime lufte dhe
12 krime kundër njerëzimit me qëllim që të merrnin pushtetin në
13 Kosovë, Bislim Zyrapi do të kishte pasur dijeni lidhur me këtë
14 çështje, por ai i ka hedhur poshtë që të ketë ekzistuar një
15 synim i tillë. ZPS-ja ju ka thënë që ai është një dëshmitar i
16 besueshëm. Si mundet një gjykues i fakteve i arsyeshëm të mund
17 të arrijë në një përfundim tjetër të ndryshëm nga dëshmia e z.
18 Zyrapi i cili krijon dyshime të arsyeshme lidhur me argumentet
19 e ZPS-së? Dhe kur shihet dëshmia e Zyrapit në kontekstin e
20 paradës së dëshmitarëve ndërkombëtarë të cilët ju kanë thënë
21 që kanë rënë dakord me Zyrapin, atëherë çfarë tjetër mund të
22 shtohet?

23 Diapozitivi 64.

24 Si është shpërndarë ky synim, ky pretendim i synimit të
25 përbashkët kriminal në nivele më të ulëta? ZPS-ja e ka bërë, e

1 ka treguar këtë në lëndën e përmylljes. Dhe këtë e ka bërë
2 përmes shpërndarjes me deklarata publike, me dokumente
3 rregullatorë dhe trajnimi dhe me takime dhe me raporte për të
4 cilat për gjitha do të flas.

5 Por duhet t'i shihni këto që në këtë tabelë identifikohen
6 argumentet lidhur me synimin e përbashkët kriminal dhe si
7 është transmetuar në nivele më të ulëta, por e pranon ZPS-ja
8 që nuk ka argumente që ky plan të jetë kriminal të jetë
9 transmetuar përmes urdhreve me shkrim.

10 Takimet apo mjeti i parë i pretenduar janë deklaratat
11 publike.

12 Kalojmë në diapozitivin 65.

13 Dhe e para janë komunikatat publike. Por ka një
14 kontradiktë tjetër themelore në argumentet e ZPS-së. Nga njëra
15 anë ZPS-ja thotë se UÇK-ja ka patur një sistem tërësisht
16 funksionues të komandimit nga Shtabi i Përgjithshëm deri tek
17 zonat, ndodhet në paragrafin 105 dhe 109 të dosjes së saj,
18 mundësinë për të komunikuar mes Shtabit të Përgjithshëm dhe
19 zonave që ndodhet në paragrafin 210, 218, 219, mundësinë për
20 të lëshuar urdhra detyruese nga Shtabi i Përgjithshëm për
21 anëtarët e zonave, paragrafi 128, si dhe mundësinë për të
22 ushtruar disiplinë dhe për të dënuar nivelet e ulëta në rast
23 të moszbatimit, paragrafi 141, 285.

24 Kalojmë në diapozitivin tjetër.

25 Po ZPS-ja thotë që pavarësisht këtij sistemi tejet

1 operativ të komandës dhe të kontrollit, një "mënyrë themelore"
2 me të cilat anëtarët e NKP-së e kanë komunikuar politikën e
3 tyre kundër kundërshtarëve është përmes komunikatave,
4 deklaratave politike dhe deklaratave të tjera të bëra nga
5 anëtarët e NKP-së të cilën ushtarët do ta merrnin përmes
6 medias publike.

7 Kalojmë tek diapozitivi 67.

8 ZPS-ja nuk shpjegon se pse anëtarët e NKP-së thjesht nuk
9 kanë lëshuar urdhra të cilët etiketonin të ashtuquajturit
10 oponentë. Ne parashtrojmë se kjo ka ndodhur se çështja e ZPS-
11 së nuk është konsistente dhe, në fakt, nuk ka pasur as komandë
12 dhe kontroll dhe nuk ka pasur prova të besueshme që zonat kanë
13 interpretuar komunikatat si politike për të vendosur për të
14 kryer krime kundër personave të perceptuar që pengonin
15 anëtarët e NKP-së që të kishin kontroll të plotë mbi Kosovën.

16 Kalojmë te diapozitivi 68.

17 Në paragrafin 225 të dosjes përfundimtare, ZPS-ja thotë
18 gjithashtu dhe këtu citoj:

19 "Nën lidërshtipin e Thaçit, drejtoritë politike dhe të
20 informacionit ishin kryesore për formulimin dhe shpërndarjen e
21 politikave të brendshme dhe të jashtme, përfshirë këtu dhe në
22 lidhje me identifikimin dhe trajtimin e oponentëve. Përmes
23 nxjerrjes së deklaratave, deklaratave politike, komunikatave,
24 drejtoria e informacionit e shpërndante informacionin dhe
25 propagandë që e formësonte drejtoria politike."

1 Tani do të trajtoj pretendimet e ZPS-së lidhur me
2 lidërshtipin e pretenduar të z. Thaçi lidhur me drejtorinë
3 politike dhe të informacionit, po këtë do ta bëj më vonë,
4 ndërkohë që tani do të trajtojë një tjetër kontradiktë në
5 çështjen e ZPS-së.

6 Diapozitivi 69.

7 Nga njëra anë, ZPS-ja thotë që nuk duhet të marrësh
8 parasysh provat e dhëna nga shumë zyrtarë të nivelit të lartë
9 ndërkombëtarë, disa prej të cilëve janë thirrur vetë nga ZPS-
10 ja si, për shembull, Shaun Byrnes dhe të tjerë janë thirrur
11 nga Mbrojtja si, për shembull, James Rubin, Christopher Hill,
12 Gjenerali Wesley Clark, James Jock Covey, John Duncan, Paul
13 William dhe Michael Durkee, sepse të gjithë këta ndërkombëtarë
14 nuk kanë pasur informacion të disponueshëm për ta që ju keni
15 pasur të disponueshëm për veten tuaj.

16 Megjithatë dëshpërimisht çështja e ZPS-së kundër z. Thaçi
17 pjesërisht mbështetet në deklarata, në komunikata që kanë qenë
18 të disponueshme në sferën publike. Ndërkohë ndërkombëtarët në
19 atë kohë kanë qenë shumë të mirinformuar për të gjitha këto
20 gjëra dhe ata nuk kanë parë asnjë lloj nxitje për sa i takon
21 krimit apo qëllimit të përbashkët kriminal.

22 Të kalojmë në diapozitivi 70.

23 Çfarë mund të themi lidhur me z. Zyrapin, që ishte person
24 i brendshëm, shef i Shtabit të Përgjithshëm që nuk kishte
25 informacion për qëllimin e përbashkët kriminal dhe prej të

1 cilit, sipas ZPS-së, anëtarët e NKP-së e fshihnin qëllimin e
2 përbashkët penal? Në qoftë se komunikatat dhe deklaratat
3 publike ishte mjet përmes të cilës transmetohej politika
4 kriminale, si e shpjegon ZPS-ja që Zyrapi nuk kishte
5 informacion për asgjë të tillë? Nuk i lexonte gjë Zyrapi
6 komunikatat dhe deklaratat politike? Pse thotë ZPS-ja se
7 anëtarë të tjerë të NKP-së duhet të bënin përpjekje për të
8 fshehur qëllimin kriminal të përbashkët nga z. Zyrapi,
9 ndërkohë që në të njëjtën kohë këta ishin anëtarët e NKP-së
10 sipas ZPS-së që bënin deklarata publike të qëllimit të
11 përbashkët kriminal?

12 Të nderuar Gjykatës, kjo nuk ka pikë vlere dhe nuk ka
13 fare kuptim, e aq më pak, të përbëjë provë përtej dyshimit të
14 arsyeshëm.

15 Si është e mundur të ZPS-ja argumenton si ndërkombëtarët
16 dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm nuk kishin informacion për
17 qëllimin e përbashkët kriminal, por në nivel më të ulët
18 personeli i UÇK-së kishte mundësi që të merrte mesazhe
19 kriminale?

20 Diapozitivi 71

21 Bëjini vetes këtë pyetje: A iu desh 20 vite komunitetit
22 ndërkombëtar që të zbulonte propagandën nxitëse ndaj
23 gjenocideve në Ruandë? A iu desh 20 vite komunitetit
24 ndërkombëtar që të zbulonte propagandën nacionaliste të
25 serbëve në Bosnjë dhe të Milosheviqit? Sigurisht që jo. Sepse

1 retorika në Ruandë, në Serbi dhe Bosnjë ishin të qarta në
2 dritë të diellit dhe ia raportuan në mënyrë të menjëhershme.
3 Dhe komunikatat e UÇK-së nuk kanë qenë nxitëse të krimit sepse
4 në të kundërtën dëshmitarët ndërkombëtarë që kanë dhënë dëshmi
5 në këtë çështje do ta kishin ditur këtë dhe do ta kishin bërë
6 me dije për ju.

7 Çështja e ZPS-së mbështetet në faktin dhe thotë që z.
8 Thaçi ka qenë në Rambuje dhe ndërkohë thotë që fushata e UÇK-
9 së për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit janë
10 shpalosur për 11 muaj. Por pavarësisht kësaj, ju ka thënë
11 profesor Paul Williams këtu përpara të gjithëve që asnjë në
12 Grupin e Kontaktit nuk e ka përmendur asnjëherë Thaçin që atij
13 i nevojitej të bënte një gjë të tillë. Përkundrazi, Williams
14 ka thënë që Thaçi ka qenë pjesë e delegacionit shqiptar dhe
15 gjithashtu ka qenë një prej personave që ka qenë pro fillimit
16 të hetimit të krimeve të luftës nga të gjitha anët, përfshirë
17 dhe UÇK-në.

18 Diapozitivi 72.

19 Të kalojmë tek pika tjetër. ZPS-ja ka dështuar të japë
20 prova që komunikatat kanë çuar në avancimin e politikës së
21 NKP-së. Cila është prova e ZPS-së që çon në këtë lidhje shkak-
22 pasojë midis komunikatave dhe krimeve të akuzuara?

23 Diapozitivi 73.

24 ZPS-ja duhet të provojë që komunikatat kanë qenë një
25 kontribut domethënës për sa i takon krijimit të krimeve të

1 ngritura në aktakuzë dhe, jo thjesht të pretendojë që ka një
2 qëllim të përbashkët siç pretendon ZPS-ja dhe për pasojë duhet
3 që të krijojë një lidhje kohore midis komunikatave dhe krimeve
4 të ngritura.

5 Diapozitivi 74.

6 ZPS-ja së pari mbështetet në provat e dhëna nga komandant
7 Remi për të mbështetur pretendimet që komunikatat ishin
8 kontribut shumë i rëndësishëm për krimet e ngritura në
9 aktakuzë. Së pari, sikurse thuhet në çështjen e ZPS-së, Remi
10 ka komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me Shtabin e
11 Përgjithshëm. Ju këtë mund ta gjeni në paragrafët 354, 356 dhe
12 362 të dosjes së ZPS-së.

13 Në paragrafin 362 thuhet shprehimisht "Mustafa dhe
14 komandanti i zonës së Llapit kanë pasur kontakte të ngushta
15 dhe kanë raportuar për Shtabin e Përgjithshëm, si personalisht
16 edhe përmes telefonave satelitor".

17 Diapozitivi 75.

18 Kjo ngre pyetjen e qartë: Në këtë rast pse anëtarët e
19 NKP-së nuk ia kanë komunikuar planin kriminal Remit
20 personalisht ose përmes telefonit satelitor? Dhe pse duhej që
21 Remi të lexonte lidhur me politikat në komunikata, pse ishte e
22 nevojshme kjo? Pse nuk merrte ai urdhra të drejtpërdrejta nga
23 Shtabi i Përgjithshëm ose pse nuk e pyeste Shtabin e
24 Përgjithshëm në qoftë se ai duhej të krijonte apo të ngrinte
25 qendra ndalimi?

1 Arsyeja që ZPS-ja duhet të thotë Shtabi i Përgjithshëm i
2 ka komunikuar qëllimin e përbashkët kriminal përmes
3 komunikatave ndaj zonave, përshirë këtu edhe zonës së Llapit,
4 përveç "kontaktit të ngushtë personalisht ose përmes
5 telefonave satelitor" është ZPS-ja nuk ka prova për urdhra të
6 drejtpërdrejtë ose komunikime të drejtpërdrejta nga Shtabi i
7 Përgjithshëm që kanë dhënë mesazhe të tilla.

8 Një nënkuptim ose një gjë e arsyeshme në provat e ZPS-së
9 është që Shtabi i Përgjithshëm nuk ka pasur plan kriminal
10 sepse në të kundër në qoftë se do kishte një plan të tillë
11 komunikimi me Remin do ishte bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

12 Kalojmë tek diapozitivi 76.

13 ZPS-ja thotë që Remi ka pretenduar dhe këtu citoj
14 "komunikatat ishin pjesë e arsyetimit tim ushtarak".

15 Diapozitivi 77.

16 Por Remi fliste për Komunikatën 54. Dhe e ka konfirmuar
17 në gjyq këtë dhe kjo jepet në faqen 5948, 5849 dhe 5861.

18 Sipas tij Komunikata 53 dhe 54 janë lëshuar në fund të
19 shtatorit 1998. Por qëndrimi i Prokurorisë është që ndalimet
20 në zonën e Remit kanë filluar rreth datës 2 gusht dhe kanë
21 zgjatur deri nga mesi i shtatorit. Komunikata që Remi përmend
22 se ka parë pas ofensivës së shtatorit është botuar pasi në
23 zonën e vet ka pasur persona të mbajtur të ndaluar për shtatë
24 javë. Komunikata nuk mund të ketë dhënë ndonjë kontribut
25 domethënës për ndalimin për shkak të datës së botimit të saj.

1 Në fakt, personat e fundit të ndaluar në zonën e Remit janë
2 liruar pak kohë pas botimit të komunikatës 54. Kjo jepet në
3 transkript në faqen 230714 dhe 5726, 5727.

4 Diapozitivi 78.

5 Remi ka pranuar që ai kishte krijuar vendet e qëndrimit
6 dhe ndalimit përpara sesa të kishte parë këtë komunikatë të
7 pretenduar.

8 Viojrmë me diapozitivin e radhës.

9 ZPS-ja e keqinterpreton Remin në paragrafin 67 të dosjes
10 së vet ku ajo thotë që Remi ka dhënë dëshmi për pretendimin se
11 "komunikatat janë kuptuar nga komandantët e UÇK-së si
12 komunikuese të politikës së UÇK-së dhe autorizim të masave
13 kundër oponentëve". Remi nuk e ka thënë këtë gjë. Sikurse mund
14 ta shikoni në ekran, Remi tha se ai është vënë në dijeni gjatë
15 gjyqit të vet të një dokumenti që ka qarkulluar dhe që thoshte
16 që ata që punonin kundër UÇK-së duhet të parandaloheshin ta
17 bënin këtë gjë, por se ai nuk i kujtohej që të ketë parë
18 ndonjë gjë konkrete nga Shtabi i Përgjithshëm në lidhje me
19 çështjen ndërkohë që ka qenë komandant zone. Kjo jepet në
20 transkript në faqen 5558.

21 Viojrmë me diapozitivin 80.

22 Më tej ZPS-ja pretendon se qëllimi i përbashkët kriminal
23 është avancuar për shkak të zyrtarëve të UÇK-së që nuk e kanë
24 përkufizuar siç duhet termin "bashkëpunëtor" ose
25 "kolaboracionist" për njësitë vartëse. Por fakti që zyrtarët e

1 UÇK-së në deklaratat propagande dhe retorikën politike kanë
2 përdorur termin bashkëpunëtor në mënyrë të folurit të
3 përditshëm dhe jo përdorimit të një përkufizimi ligjor, kjo
4 nuk ka pikë vlere përveçse në qoftë se ZPS-ja mund të provojë
5 që Shtabi i Përgjithshëm ka synuar t'i drejtohet apo të
6 trajtojë njësitë e varësisë ose përmes formave të urdhrave ose
7 përmes komunikatave.

8 Sikurse e përmenda, nuk ka prova të besueshme që Shtabi i
9 Përgjithshëm synonte që të komunikonte me zonat përmes
10 komunikatave. Për rrjedhojë, përdorimi i termit
11 "bashkëpunëtor" në deklarata propaganduese nuk është provë për
12 kontribut domethënës për kryerjen e krimeve.

13 Tani do të kaloj tek pjesa e dokumenteve rregullatorë dhe
14 trajnuese.

15 Viojmë me diapozitivin 81.

16 ZPS-ja më tej pretendon në paragrafin 71 që dokumentet
17 rregullatorë të tilla si rregullat e përkohshme të organizimit
18 të jetës së brendshme ushtarake janë miratuar nga Shtabi i
19 Përgjithshëm në korrik të 1998 dhe përbënin bazën për kërkesat
20 e policisë ushtarake të UÇK-së që të ishin "të pamëshirshme
21 drejt armiqve dhe të gjithë atyre të cilët pengonin luftën
22 çlirimtare".

23 Në mbështetje të pretendimit të vet ZPS-ja thotë që këto
24 rregullore, të cilat janë pranuar si prova P8, janë miratuar
25 në takimin e Shtabit të Përgjithshëm më 4 korrik 1998 sipas

1 librit të Jakup Krasniqi. Megjithatë, nuk ekzistojnë
2 procesverbale të takimit të Shtabit të Përgjithshëm që
3 miratonin këtë rregullore më 4 korrik të 1998 dhe ZPS-ja nuk e
4 vërteton që P8 ishte në fakt rregullore që ishte miratuar në
5 këtë takim të pretenduar të 4 korrikut të 1998-s. Gjithashtu,
6 nuk ka prova që z. Thaçi ka marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë
7 takim të tillë apo që edhe ka qenë në Kosovë në fillim të
8 korrikut.

9 Nga ana tjetër, Zyrapi, një dëshmitar që ZPS-ja e
10 konsideron të besueshëm, kur ju treguan rregulloret e
11 përkohshme që është prova P8, tha që rregullorja është
12 miratuar në fund të 1998 si pjesë e ristrukturimit dhe janë
13 përkthyer nga dokumente nga ushtritë e perëndimit. Zyrapi
14 shpjegoi se këto ishin rregullore që ishin më tepër të natyrës
15 aspiruese dhe nuk ishin të tilla që të ishin të zbatueshme në
16 terren.

17 Vazhdojmë në diapozitivin 82.

18 P2 përfshin rregullore që përmbajnë betimin që kanë të
19 bëjnë kryesisht me Çelikut. Nuk ka dyshim të arsyeshëm sa i
20 takon faktit që Shtabi i Përgjithshëm do të kishte miratuar
21 rregullore për shpërndarje në të gjithë Kosovën, ndërkohë që
22 kjo nuk qëndron.

23 Diapozitivi 83.

24 ZPS-ja gjithashtu pretendon se pas vizitës së Shtabit të
25 Përgjithshëm në zonën e Llapit, shërbimi i informacionit

1 publik të UÇK-së i drejtuar nga Thaçi ka nxjerrë, ka botuar
2 një broshurë të quajtur lufta speciale. Kjo është diçka që
3 parashtrohet në paragrafin 72.

4 Së pari, më lejoni të them që shërbimi informativ publik
5 i UÇK-së nuk ekziston dhe ZPS-ja nuk jep asnjë lloj shpjegimi
6 se si ishte Thaçi drejtuesi i kësaj njësie që nuk ekzistonte.

7 Së dyti, ZPS-ja keqinterpreton provat. Sepse në broshurë
8 thuhet titulli zona e Llapit, dhe asnjëherë nuk është një
9 dokumentacion i cili është lëshuar prej shërbimit të Shtabit
10 të Përgjithshëm.

11 Po ashtu, provat nuk mbështesin pretendimin e ZPS-së që
12 lufta speciale është trajtuar apo është diskutuar nga Shtabi i
13 Përgjithshëm në vizitën në Llap në tetor të 1998-s. ZPS-ja as
14 nuk tregon dhe as nuk provon që vizita e Shtabit të
15 Përgjithshëm në tetor të 1998 në Llap ka çuar në nxjerrjen ose
16 lëshimin e këtij libri.

17 Në kundërshtim me pretendimin e ZPS-së në poshtëshënimin
18 276, kur i është treguar ky dokument, Rrustem Mustafa tha që
19 nuk i kujtohej, kështu që nuk është e mundur që ai të ketë
20 konfirmuar autenticitetin e tij. Për më hollësi mund t'i
21 referoheni faqes 5651, 5652.

22 Kalojmë tek mjeti i tretë të transmetimit të qëllimit
23 kriminal të përbashkët, që janë takimet dhe raportet.

24 Të hënën, z. Tieger tha:

25 "Sokol Bashota ka thënë në intervistën e tij për TPNJ-në

1 që vendimmarrja kolektive zbatohej për vendime lidhur me
2 bashkëpunëtorët.”

3 Është në faqen e transkriptit 28371.

4 Viojme me diapozitivin 84.

5 Megjithatë, nuk u përmend dëshmia e Bashotës përpara
6 kësaj Gjykate. Bashota përpara jush ka diskutuar disa takime
7 të Shtabit të Përgjithshëm gjatë dëshmisë së vet dhe tha që
8 ndërkohë që takimet e Shtabit të Përgjithshëm janë organizuar
9 dhe janë kryer mbështetur në shumicën e personave të cilët
10 kanë qenë të pranishëm në takim për sa i takon vendimmarrjes,
11 ata kishin një strukturë horizontale, ai gjithashtu tha që jo
12 të gjithë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm kanë marrë pjesë
13 në të gjitha vendimet, që vendimet mund të merreshin edhe në
14 mungesë të personave dhe secili prej anëtarëve kishte detyrat
15 dhe përgjegjësitë e veta.

16 Ajo çfarë është më e rëndësishme është që Bashota u
17 pajtua me propozimin e shprehur që pikat e poshtme nuk ishin
18 vendime kolegjiale: Së pari, lëshimi i komunikatave, së dyti,
19 trajtimi i bashkëpunëtorëve, së treti, nxjerrja e rregulloreve
20 dhe, së katërti, krijimi i qendrave të ndalimit, intervistat e
21 medias të dhënë nga anëtarë të UÇK-së, marrëveshja e Holbrook
22 -Milosevic, Marrëveshja e FARK-ut, kush do të merrte pjesë në
23 konferencën e Rambujesë, caktimi i Adem Demaçit dhe roli i
24 Sokol Dobrunës.

25 Pasi iu treguan urdhra të ndryshme të nënshkruara nga

1 Zyrapi, Bashota konfirmoi se të gjitha këto vendime ishin
2 lëshuar prej tij vetë pa u konsultuar me Shtabin e
3 Përgjithshëm, domethënë, nuk ishin vendime kolektive. Po ashtu
4 Bashota u pajtua me propozimin që kishte vendime të
5 rëndësishme të marra nga UÇK-ja që nuk përfshinin një proces
6 vendimmarrës kolektiv ose kolegjal.

7 Viojrmë me diapozitivin 85.

8 Më tej ZPS-ja thotë që qëllimi i përbashkët kriminal
9 është transmetuar, i është transmetuar nga Shtabi i
10 Përgjithshëm në vizitat që janë organizuar në Shalë dhe Llap
11 në tetor të vitit 1998 dhe në Dukagjin në shtator të 1998. Ne
12 këto pretendime i kemi trajtuar në paragrafët 146 dhe 155 të
13 dosjes sonë. Dhe e kemi përmendur dhe më herët që Bislim
14 Zyrapi ishte i pranishëm dhe ka marrë pjesë në të gjitha prej
15 këtyre vizitave dhe qëndrimi i ZPS-së nuk është -- është që ai
16 nuk është pjesëmarrës në diskutime për sa i takon qëllimit të
17 përbashkët kriminal dhe nuk e di sesi ka dalë në këtë
18 përfundim ZPS-ja.

19 Tani le të kalojmë tek objektivi ushtarak. ZPS-ja
20 pretendon që fakti që shumë zona të UÇK-së kanë krijuar
21 ambiente ndalimi do të thotë që ka pasur një drejtim të
22 arsyeshëm dhe një udhëzim prej Shtabit të Përgjithshëm.
23 Ndërkohë që kjo nuk është e vërtetë.

24 Ky argument nuk qëndron për dy arsye.

25 Diapozitivi 86.

1 Së pari, IRCC-ja ka shpjeguar që ndalimi nga grupet
2 shtetërore ose joshtetërore, të tilla si UÇK-ja, është
3 realitet në çdo konflikt. Është një pjesë që pritet në gjendje
4 lufte. Kjo është norma nuk është përjashtimi. ICRC-ja deklaron
5 që IHL-ja mbështetet në prezumimin që të gjitha palët, pra,
6 edhe një herë - të gjitha palët - bëjnë ndalime. Do të kishte
7 qenë e pazakontë në qoftë se komandantët e zonës nuk do të
8 kishin krijuar ambientet e tyre të ndalimit. Atyre nuk i
9 nevojitej që ta merrnin idenë për ta bërë një gjë të tillë nga
10 Shtabi i Përgjithshëm.

11 Kalojmë më tej në diapozitivin 87.

12 Këto janë udhëzimet e ICRC-së, në to thuhet që mund të
13 kërkohet kohë për aktorët joshtetërorë që të krijojnë sisteme
14 për procesin e rregullt.

15 Arsyeja që pse të gjitha anët ose të gjitha palët e një
16 konflikti të armatosur bëjnë ndalime është sepse kemi të bëjmë
17 me një nënprodukt ushtarak të luftës. Pra, është e rëndësishme
18 që të kapësh njerëzit dhe është e rëndësishme gjithashtu që të
19 parandalosh luftimet e ardhshme.

20 ZPS-ja këtu ka deklaruar që nuk diskutohej që UÇK-ja
21 kishte të drejtën për të ndaluar në mënyrë të ligjshme.

22 Vazhdojmë me diapozitivi 88.

23 Për rrjedhojë, ZPS-ja duhet të demonstrojë që edhe nëse
24 provon se kishte komunikata midis Shtabit të Përgjithshëm dhe
25 zonave lidhur me luftën speciale dhe bashkëpunëtorët, këto

1 diskutime nuk ishin në ndjekje të objektivave ushtarake
2 legjitime por ishin në ndjekje të objektivit politik të
3 anëtarëve të NKP-së për të kapur Kosovën.

4 Mbani mend diçka që në qoftë se do të mbërrini në
5 përfundimin që abuzimet e ndodhura si rezultat i politikës së
6 UÇK-së për të avancuar objektivat ushtarake ose si rezultat i
7 inateve personale nga individë të caktuar të UÇK-së, atëherë
8 ju duhet të kundërshtoni formën e NKP-së së përgjegjësisë
9 sepse ky nuk është kjo ajo çfarë vihet në diskutim. Rasti dhe
10 qëndrimi i tyre, pra, i ZPS-së është që viktimat e pretenduara
11 janë ndaluar, me ta është abuzuar për shkak se kishte një
12 pengesë të objektivit politik të anëtarëve të NKP-së prej
13 këtyre personave dhe që ata nuk ju bënë atyre të mundura
14 ushtrimin e plotë të kontrollit në Kosovë. Kjo nuk është e
15 arsyeshme dhe nuk është një përfundim që është i mbështetur në
16 dosjen e Prokurorisë.

17 Vazhdojmë më tej me diapozitivi 89.

18 Do të flas për LPK-në. LPK-ja dhe historiku i saj. Nuk ka
19 prova që LPK-ja ka pasur si objektiv kontrollin e Kosovës për
20 veten. Atëherë në statutin e vet LPK-ja e bën të qartë që
21 objektivi kryesor i saj ishte çlirimi dhe krijimi i shtetit të
22 pavarur të Kosovës dhe, së dyti, të krijonte një shoqëri të
23 re, të lirë, demokratike në përputhje me vullnetin e njerëzve.

24 Nuk ka asgjëkund asnjë sugjerim në statutin e LPK-së që
25 objektivi i LPK-së ishte që të fitonte më tepër kompetencë dhe

1 pushtet për vete apo për anëtarët e vet.

2 Viojrmë me diapozitivin 90.

3 Në mbështetje të pretendimit të vet që anëtarët e NPK-së
4 kishin objektiv që të merrnin më shumë kompetenca e pushtet
5 për vetveten, ZPS-ja i referohet Deklaratës Politike numër 8
6 në paragrafin 10 të dosjes së saj, ku ZPS-ja një fjali e
7 nxjerr jashtë konteksti, kjo fjalia është: "Kosova ose do jetë
8 e jona ose do të përfundojë në shkumb e hi". Por pjesa tjetër
9 e tekstit vazhdon dhe e bën më të qartë që kur thua që "Kosova
10 do jetë e jona" kjo i referohet popullit të Kosovës dhe jo
11 anëtarëve të pretenduar të NPK-së. Sepse deklarata ka më shumë
12 kontekst më tej, domethënë, "Kosova do jetë e jona në të
13 kundërtën do të bëhet hi. Sepse ne jemi të vendosur se vdekja
14 është më e mirë sesa jeta nën skllavëri". Pra, dhe për këtë
15 arsye është e rëndësishme që të shikohet i gjithë konteksti
16 dhe nuk ka pikë lidhje këtu me anëtarët e NPK-së.

17 Përsëri është e paqartë se si ZPS-së i del llogaria që
18 dëshmitarët ndërkombëtarë dhe Bislir Zyrapi nuk kishin pikë
19 informacioni për planin e përbashkët të NPK-së, por mbështetet
20 në një deklaratë politike për të vërtetuar synimin e
21 pretenduar kriminal. Fakti që ndërkombëtarët dhe Zyrapi nuk e
22 kanë lexuar në të njëjtën mënyrë këtë deklaratë, siç mundohet
23 që ta shesë ZPS-ja, në vetvete është dyshimi i arsyeshëm sa i
24 takon interpretimit të bërë nga ZPS-ja.

25 Diapozitivi 91.

1 Në paragrafin 27, ZPS-ja pretendon që vendosja e
2 vullnetarëve relativisht të lartë të LPK-së në mars të 1998,
3 citoj "rriti autoritetin e Thaçit dhe anëtarë të tjerë të
4 Shtabit të Përgjithshëm të lidhur me LPK-në".

5 Ndërkohë ZPS-ja nuk citon asnjë provë për të vërtetuar që
6 këta ishin persona "relativisht të lartë" në LPK apo se si
7 ZPS-ja arriti në një përkufizim të këtij termi.

8 Edhe kësaj here bëhet fjalë për një tjetër kontradiktë të
9 radhës të çështjes së ZPS-së. Si i bën llogaritë, si i dalin
10 llogaritë ZPS-së që Thaçi nga njëra anë ka pasur më shumë
11 kompetencë për shkak të LPK-së dhe nga ana tjetër ka qenë
12 Thaçi i cili ka sjellë Zyrapi dhe oficerë të tjerë ushtarakë
13 për të profesionalizuar UÇK-në?

14 Zyrapi është futur në Kosovë me Thaçin dhe ka pasur në
15 këtë proces gjyqësor zero prova që ai kishte ndonjë lidhje me
16 Thaçin, përveçse një marrëdhënie të mirë.

17 Diapozitivi 92.

18 Në paragrafët 188 dhe 190 të dosjes së ZPS-së , vetë ZPS-
19 ja thotë dhe këtu citoj:

20 "Roli i të akuzuarit dhe autoriteti mbi çështjet
21 operative ilustron nga vendosja, emërimi dhe caktimi i
22 Zyrapit - që ishte një oficer ushtarak me përvojë - që ka
23 pasur role operacionale në Shtabin e Përgjithshëm dhe
24 Ministrinë e Mbrojtjes gjatë periudhës së aktakuzës."

25 Kjo thuhet shprehimisht në paragrafin 188.

1 Në paragrafin 190 më tej thuhet:

2 "... Thaçi gjithashtu i dha Zyrapit urdhrin që të
3 përgatiste oficerë profesionalë dhe t'i vendoste ata në zonat
4 e luftës."

5 Diapozitivi 93.

6 Si e shpjegon ZPS-ja qëndrimin e vet që ishte z. Thaçi
7 dhe të akuzuarit e tjerë që kishin vendosur një oficer
8 ushtarak me përvojë, dikush që kishte punuar për armatën
9 jugosllave më përpara dhe që nuk ishte pjesë e LPK-së, të
10 drejtonte operacionet e UÇK-së dhe më pas të bëhej shef i
11 shtabit, ndërkohë që pretendon në të njëjtën kohë që të
12 akuzuarit e kanë përjashtuar atë nga qëllimi i përbashkët
13 kriminal në ndjekje të objektivave të LPK-së? Është e
14 arsyeshme që të arrihet në përfundimin që të akuzuarit kanë
15 mbështetur Bislum Zyrapin si drejtues i Shtabit të
16 Përgjithshëm sepse nuk ka pasur qëllim të përbashkët kriminal
17 dhe të arrihet në përfundimin e arsyeshëm që Hashim Thaçi nuk
18 do të kishte inkurajuar vendosjen e oficerëve profesionalë të
19 moslidhur, që nuk ishin të lidhur me LPK-në në qoftë se nuk po
20 përpiqej që të kryente rolin e vet.

21 Po ashtu, Zyrapin e bëri të qartë në dëshminë e vet dhe
22 kjo jepet në faqen 17784, 17786, që çdo ish-oficer ushtarak
23 shqiptar që donte që të jepte kontributin e vet UÇK-së do
24 pranohej në UÇK. Nuk ka asnjë provë që asnjë ushtarak tjetër i
25 nivelit të lartë është përjashtuar. Dhe, për rrjedhojë, ky

1 pretendim që të akuzuarit janë vendosur në vende, në pozicione
2 autoriteti ose që nuk kanë pasur ndikim mbi të nuk është në
3 përputhje me provën e Zyrapit.

4 ZPS-ja në paragrafin 405 thotë që:

5 "Përgjatë gjithë vitit 1999, Shtabi i Përgjithshëm ka
6 treguar mungesë të vazhdueshme besimi për ushtarë
7 profesionistë dhe për ata që konsideroheshin si të lidhur me
8 LDK-në dhe FARK-un."

9 Por Shtabi i Përgjithshëm drejtohej nga Zyrapit, Zyrapit
10 vetë ishte ushtar profesionist. Kështu që nuk e di sesi arrin
11 në këtë përfundim ZPS-ja?

12 Po ashtu, ZPS-ja thotë që ishte Thaçi ai i cili "i dha
13 Zyrapit urdhër që të përgatiste oficerë profesionistë dhe t'i
14 vendosë ata në zona lufte". Mbi çfarë baze tjetër mbështetet
15 ZPS-ja që Thaçi nuk kishte besim tek oficeri profesionist, që
16 ai vetë e kishte caktuar, veçanërisht në atë kohë, pra, në
17 fillim të 1999-s kur Thaçi vetë as nuk ka qenë në Kosovë fare.

18 Viojrmë në diapozitivin 95.

19 ZPS-ja pretendon apo mbështetet më tej në deklaratat
20 publike të caktuara si provë të synimit për të pasur më shumë
21 kompetencë apo fuqi mbi Kosovën. ZPS-ja pretendon në
22 paragrafin 13 të dosjes së saj që lidershipi i UÇK-së po e
23 bënte të qartë kërkesat për t'u njohur si i vetmi autoritet
24 legjitim që përfaqësonte shqiptarët e Kosovës. Më tej ai u
25 mbështetet në Komunikatën 44 që synon, që mendoj që të jetë

1 dërguar nga Prishtina më datë 2 mars të vitit 1998 nga "Shtabi
2 i Përgjithshëm", megjithatë ZPS-ja nuk thotë se kush e ka
3 shkruar këtë deklaratë dhe nuk ka asnjë provë që dëshmon që z.
4 Thaçi ka ndonjë lidhje me këtë deklaratë. Z. Thaçi as nuk ka
5 qenë fare në Kosovë në atë kohë.

6 Diapozitivi 97.

7 ZPS-ja i thotë në paragrafin 16 që:

8 "Të gjitha palët politike duhet të kenë patjetër lidhje
9 me UÇK-në."

10 Ndërkohë që ZPS-ja gjithashtu citon Deklaratën Politike
11 numër 3 të datës 10 qershor 1998 dhe në qoftë se do ta lexoni
12 edhe kjo në vetvete nuk është gjë tjetër veçse keqinterpretim
13 i dokumentit prej ZPS-së. Asgjë këtu nuk mbështet ato çfarë
14 pretendohet prej ZPS-së.

15 Përsëri, këto deklaratat publike janë deklaratat të cilat
16 janë të lëshuara në emër të UÇK-së dhe nuk lidhen në mënyrë të
17 drejtpërdrejtë apo të shprehur me z. Thaçi.

18 I nderuar Gjykatës, mendoj që është momenti i
19 përshtatshëm për të bërë pushim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do të
21 bëjmë pushim tani deri në orën 11.00

22 --- Pauza fillon në orën 10.28

23 --- Seanca rifillon në orën 11.00

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
25 nëse jeni gati mund të vazhdoni.

1 Z. MİSETIC: [Përkthim] Për përkthyesit, jam pak mbrapa
2 kështu që do të heq disa nga diapozitivët, por do ua them se
3 për cilin diapozitiv do të flas.

4 Dhe do të filloj tani te slajdi 101.

5 ZPS-ja pretendon më tej se synimi për të fituar kontroll
6 në të gjithë Kosovën vërtetohet nga puna e disa drejtorive të
7 Shtabit të Përgjithshëm që fillojnë në nëntor 1998, përfshirë
8 drejtorinë e administratës civile, atë të informimit, atë të
9 personelit dhe drejtorinë e policisë ushtarake. Por, këto
10 drejtori i raportonin Zyrapit.

11 Sërish, kjo është organigrama e Shtabit të Përgjithshëm
12 të cilën e krijoi ZPS-ja dhe ua tregoi të hënën. Mund ta
13 shihni këtu se sipas ZPS-së të gjitha këto drejtori i
14 raportonin Zyrapit.

15 Tani të shohim pak drejtorinë e administratës civile.

16 ZPS-ja mbështetet shumë në pretendimin e vet se drejtoria
17 për administratën civile që e drejtonte Ramë Buja ka qenë një
18 mjet përmes të cilit do të realizohej objektivi për të fituar
19 dhe ushtruar kontroll në të gjithë Kosovë. Sikurse e patë në
20 organigramë Ramë Buja ka qenë në vartësi të Zyrapit në nëntor
21 1998, përfshirë edhe drejtorinë e administratës civile.

22 Prokuroria nuk pretendon se drejtoria ka qenë në vartësi të
23 Hashim Thaçit.

24 Tani si ka mundësi që drejtoria për administratën civile
25 dhe ajo për marrëdhëniet publike të kenë zbatuar qëllimin e

1 përbashkët kriminal ndërkohë që kanë qenë në vartësi të
2 Zyrapit i cili nuk ka qenë i përfshirë në NKP sipas ZPS-së?
3 Shohim diapozitivin 103.

4 Po aq e rëndësishme, ZPS-ja pse nuk i bëri asnjë pyetje
5 Zyrapit për punën e administratës civile? Pse u formua, çfarë
6 detyrash kishte dhe a kishte arsye për të besuar ai se ishte
7 një mjet që e përdornin të akuzuarit në këtë çështje për të
8 fituar pushtet në Kosovë?

9 ZPS-ja asnjëherë s'e pyeti Zyrapin, po kjo është e qartë
10 pse, se Zyrapit nuk do ta pranonte kurrë pretendimin e ZPS-së
11 se drejtoria për administratën civile shfrytëzohej për të
12 përdorur qëllimin kriminal të pretenduar.

13 Kalojmë te diapozitivi tjetër.

14 Ne këtë e dimë sepse kemi dëshminë që i ka dhënë Zyrapit
15 TPNJ-së, që është me numër P1356-ET, ku në faqen 5942, Zyrapit
16 i ka thënë TPNJ-së se drejtoria e administratës civile si
17 rregull është pjesë e një "strukture normale të një Shtabi të
18 Përgjithshëm që do të kishte ekzistuar kudo".

19 Nëse ZPS-ja do e kishte pyetur Zyrapin lidhur me këtë
20 çështje, atëherë Trupi Gjykses do ta kishte parë reagimin e
21 Zyrapit ndaj këtij pretendimi që ngriti ZPS-ja të hënën dhe
22 citoj, ku thotë që "Thaçi e shfrytëzoi qeverinë si një maskim
23 për planet e veta që i kishte krijuar tashmë përmes drejtorisë
24 civile". Pra, duke e marrë dëshminë e Zyrapit për TPNJ-së del
25 në deduktimin rrjedhimisht se Zyrapit s'do ta kishte pranuar

1 kurrë që drejtoria e administratës civile përdorej për të
2 realizuar një qëllim të tillë nën drejtimin e tij.

3 Rrjedhimisht, interpretimi më i arsyeshëm i kësaj prove
4 është që drejtoria për administratën civile u krijua sepse
5 oficerë ushtarakë karriere si Bislim Zyrapi besonin se ishte
6 një pjesë normale e krijimit të një Shtabi i Përgjithshëm, dhe
7 jo sepse thurnin ndonjë qëllim të përbashkët kriminal të
8 akuzuarit pas shpinës së Zyrapit.

9 Kalojmë tek diapozitivi 111. Për përkthyesit është faqja
10 53.

11 Më tej, ZPS-ja pretendon që qeveria ishte një strukturë e
12 cila do të përdorej për të marrë kontrollin në Kosovë.

13 Siç e dini, Qeveria e Përkohshme nuk u krijua si një
14 pjesë e ndonjë plani për të marrë kontrollin e Kosovës, por në
15 fakt ishte në kuadër të marrëveshjes në Rambuje me presidentin
16 Rugova të LDK-së, profesor Qosen të LBD-së dhe në fakt synonte
17 që të ishte një qeveri që pasqyronte unitet kombëtar, ku
18 presidenti Rugova do të mbetej president dhe UÇK do të
19 emëronte kryeministrin e qeverisë, ndërsa LDK-ja dhe LBD-ja
20 secili do të merrnin ndonjë post ministrior zëvendës, në rolin
21 e zëvendësit. Të tri partitë do të ndanin barabartë postet
22 ministrore.

23 Fillimisht, të korrigjojmë disa shtrembërime që i ka bërë
24 ZPS-ja dosjes së vet. Në paragrafin 143, shkruajnë:

25 "Përafërsisht në të njëjtën kohë", që i takon vera e

1 1998-s, "Shtabi i Përgjithshëm në mënyrë të vazhdueshme me
2 zjarr ka refuzuar qeverinë e zgjedhur të LDK-së, por ndërmorën
3 hapa që të krijonin një qeveri të re".

4 Së pari, duhet të theksojmë që kjo është e pasaktë
5 faktikisht dhe juridikisht. Nuk ka ekzistuar ndonjë qeveri e
6 zgjedhur prej LDK-së. S'ka pasur zgjedhje, dhe nuk ka pas
7 qeveri të LDK-së. LDK-ja ka qenë një parti politike, dhe në
8 vetvete një grup joshtetëror dhe të ashtuquajturat zgjedhjet
9 që kanë mbajtur në fakt kanë qenë zgjedhje joshtetërore.

10 Madje, Qeveria e Bukoshit as nuk ka qenë në Kosovë, po ka qenë
11 një qeveri e ashtuquajtur në mërgim. LDK-ja nuk kishte më
12 shumë legjitimitet se UÇK-ja dhe grupet e tjera për të
13 pretenduar autoritetin që pretendonin.

14 Së dyti, do vazhdojmë me pretendimin që UÇK-ja "ndërmori
15 hapa për të krijuar një qeveri të re". Për këtë ZPS-ja citon
16 deklaratën politike numër 7. Por është e qartë që deklarata
17 politike 7 trajton çështjen e krijimit të institucioneve të
18 reja në kuadër të negociata që po mbaheshin e do të mbaheshin
19 me Serbinë e ndërmjetësoheshin nga Ambasadori Hill. Deklarata
20 nuk pretendonte se UÇK-ja po krijonte një qeveri të re në
21 vetvete dhe do të përjashtonte LDK-në.

22 Diapozitivi 12.

23 Në paragrafin 160 ZPS-ja shkruan:

24 "... emërimet e qeverisë së përkohshme përfshinin anëtarë
25 të kufizuar të LBD-së në poste ministrore dhe i dhanë vetëm

1 një post zëvendësi LDK-së, dhe ky vend mbeti vend vakant.”

2 Së pari, posti që iu dha LDK-së në Qeverinë e Përkohshme
3 vërtet ishte post zëvendësi, po ama ishte posti i zëvendësit
4 të kryeministrit.

5 Së dyti, kur shkruan ZPS-ja se ka pasur anëtarë të
6 kufizuar në poste ministrore, në fakt, nuk përcaktojnë që LBD-
7 së iu dhanë pesë poste ministrore.

8 Në shpalljen e formimit të Qeverisë së Përkohshme që mund
9 të shihni në provën 1D000070, Qeveria e Përkohshme e bëri të
10 qartë pse nuk u mbushën postet e LDK-së sikurse ishte
11 parashikuar në marrëveshjen e Rambujesë.

12 “Edhe pse u shty disa herë afati, LDK-ja nuk i paraqiti
13 propozimet e veta sikurse ishte parashikuar në marrëveshje.”

14 Rrjedhimisht, nëse LDK-ja nuk pati të njëjtin numër
15 postesh ministrore pranë qeverisë siç pati UÇK-ja dhe LBD-ja
16 kjo ishte pikërisht sepse vetë LDK-ja zgjodhi të mos emëronte
17 askënd për të mbushur vendet vakante.

18 Fakti që LDK-ja nuk mori pjesë në Qeverinë e Përkohshme
19 ishte thjesht vendim i LDK-së për të bojkotuar Qeverinë e
20 Përkohshme sepse ata nuk donin të ndanin më në mënyrë të
21 barabartë pushtetin në qeveri por donin të kishin më shumë
22 përfaqësim sesa UÇK-ja dhe LBD-ja, ndonëse kjo bindte ndesh me
23 marrëveshjen e nënshkruar në Rambuje. Të gjitha këto i kemi
24 shpjeguar në paragrafin 64 të dosjes sonë.

25 ZPS-ja në dosjen e vet përfundimtare tashmë argumenton

1 për herë të parë në këtë gjykim se LDK-ja kishte arsye të
2 forta për të bojkotuar Qeverinë e Përkohshme kinse për shkak
3 të kërcënimeve të UÇK-së. Të gjitha këto janë shtrembërime të
4 ZPS-së. S'ka asnjë dëshmitar apo dokument që vërteton që kjo
5 ka qenë arsyeja pse e bojkotuan. Kjo është një teori e
6 momentit të fundit të ZPS-së që në fakt nuk e ka ngritur
7 asnjëherë deri tani as për Mbrojtjen as për dëshmitarët.

8 Fakti është që Sekretarja e Shtetit Albright dhe
9 kryeministri Blair i bënë thirrje LDK-së të merrte pjesë në
10 Qeverinë e Përkohshme, por LDK-ja vijoi të refuzonte. Nuk ka
11 asnjë provë që tregon se LDK-ja i tha ndonjë institucioni asaj
12 kohe, përfshi Shtetet e Bashkuara apo Mbretërinë e Bashkuar,
13 se nuk donin të bëheshin pjesë për shkak të kërcënimeve të
14 pretenduara të UÇK-së.

15 Kalojmë në diapozitivin 113.

16 Por, thelbi është se z. Thaçi është përpjekur ta
17 përfshijë në mënyrë të njëmendë LDK-në në pranverën dhe verën
18 e 1999-s. Thaçi në mënyrë të vazhdueshme i bëri thirrje LDK-së
19 ta respektonte marrëveshjen që ishte nënshkruar në Rambuje, të
20 bëhej pjesë e Qeverisë së Përkohshme dhe të merrte edhe postin
21 e zëvendëskryeministrit. Këtë mund ta lexoni në paragrafin 25
22 të dosjes përfundimtare të Thaçit.

23 Më tej, z. Thaçi në mënyrë publike konfirmoi se objektiva
24 e Qeverisë së Përkohshme nuk ishte "të fitonte, të ushtronte
25 kontroll në Kosovë për anëtarët e pretenduar të NKP-së, por që

1 Qeveria e Përkohshme të qeveritë deri në momentin që do të
2 mbaheshin zgjedhjet e para të lira demokratike". Kjo është
3 intervistë e z. Thaçi, është tashmë pjesë së provave
4 gjyqësore, mund të gjendet me numrin 813.24. Mund ta shihni
5 dhe në ekran një fragment.

6 Në fakt, pranohet gjerësisht se gjatë dhe pas Rambujesë
7 z. Thaçi ishte një person që donte të kishte marrëdhënie të
8 mira me Sekretaren Albright veçanërisht dhe me Shtetet e
9 Bashkuara në përgjithësi. Ideja se ai do të bënte diçka të
10 ndryshme dhe ta përdorte Qeverinë e Përkohshme deri në
11 momentin e zgjedhjeve demokratike, nuk përputhej aspak me
12 ambicien e tij që të ishte mik i Shteteve të Bashkuara, dhe
13 kjo dukej sepse ai ka marrë pjesë në zgjedhjes e mëpasshme
14 demokratike në Kosovë dhe i pranoi zgjedhjet kur humbi, pranoi
15 humbjen e zgjedhjeve.

16 Shohim diapozitivin 114.

17 Të shohim provat që ka ZPS-ja për të pretenduar -- për
18 pretendimet e veta se z. Hashim Thaçi ka qenë anëtar i NKP-së
19 së pretenduar. Fillimisht të shohim pikën nëse ka vërtetuar
20 ZPS-ja se Hashim Thaçi ka dhënë kontribut të madh në NKP-së e
21 pretenduar, të supozuar.

22 Fillimisht ZPS-ja pretendon se Hashim Thaçi ka kontribuar
23 shumë në NKP duke formuluar, zbatuar plane, politika,
24 rregulla, rregullore, strukturat dhe mënyrat e raportimit.
25 ZPS-ja argumenton se Thaçi ka qenë figura kryesore e LDK-së

1 UÇK-së dhe e Qeverisë së Përkohshme dhe si i tillë Thaçi ka
2 qenë drejtpërdrejtë i përfshirë në hartimin, miratimin,
3 shpërndarjen, zbatimin e planeve, politikave, praktikave për
4 realizimin e qëllimit të përbashkët.

5 Ta zbërthejmë këtë pretendim.

6 Diapozitivi 115.

7 Tani a ka qenë Thaçi figura kryesore. ZPS-ja nuk ka
8 vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se Thaçi në fakt ka
9 qenë "drejtues" i drejtorisë politike apo të informimit
10 përpara nëntorit 1998, ku u bë edhe kreu i drejtorisë politike
11 vetëm kreu i drejtorisë politike. Ka prova që z. Thaçi ka qenë
12 i përfshirë në marrëdhëniet me publikun dhe me media përpara
13 nëntorit 1998, por ZPS-ja nuk na jep asnjë provë të besueshme
14 që ai ka qenë "drejtuesi" apo "kreu" i ndonjë drejtorie të
15 caktuar në UÇK qoftë kjo politike apo informimit, dhe nuk ka
16 asnjë provë që z. Thaçi të ketë kontrolluar apo të ketë
17 mbikëqyrur se çfarë thonin apo publikonin të tjerët në UÇK.

18 Në hënën, ju e dëgjuat sërish pretendimin që z. Thaçi ka
19 qenë "shefi i drejtimit të informimit deri në nëntor 1998".
20 Edhe një herë, për këtë s'na dhanë asnjë provë.

21 Ju kërkoj ndjesë një çast.

22 Habitem që përkthyesit pritën kaq gjatë për të më
23 komentuar.

24 Diapozitivi 116.

25 Thaçi nuk kontrollonte komunikatat publike të UÇK-së.

1 ZPS-ja pretendon në paragrafin 68 të dosjes përfundimtare
2 se drejtorja e informimit pranë Shtabit të Përgjithshëm,
3 përfshirë z. Thaçi personalisht, kishte kontroll të
4 konsiderueshëm mbi komunikimet publike, përfshirë
5 vendimmarrjen lidhur me atë për çfarë do të informohej
6 publiku, ushtrimi i kontrollit për intervistat që jepnin
7 komandantët e UÇK-së edhe sajnin deklarata publike.

8 Por ju keni dëgjuar dëshminë e z. Maloku kur tha që edhe
9 kur Thaçi tha të mos fliste me mediat, ai vijoi të fliste
10 sidoqoftë. Vetë dëshmia e Malokut tregon që, në fakt, Thaçi
11 nuk mund ta kontrollonte se çfarë bënin ushtarët e UÇK-së në
12 terren. Dhe dëshminë e tij e keni aktualisht në diapozitiv.

13 ZPS-ja po ashtu pretendon se drejtorja politike e Thaçit
14 ka luajtur një rol qendror në operacionet e UÇK-së dhe në
15 trajtimin e oponentëve.

16 Shohim diapozitivin 117.

17 Unë do të filloj duke trajtuar shkurtimisht një argument
18 që ngriti z. Halling, ku pretendonte se dëshmia e Sokol
19 Bashotës ku thuhej se z. Thaçi nuk ka qenë themelues i shtabit
20 qendror është "e pakonfirmuar" sipas tij. Kjo nuk është e
21 vërtetë. ZPS-ja qartazi nuk e ka lexuar dosjen tonë ku e kemi
22 cituar intervistën e 2002-shit të Nait Hasanit, ku ai në fakt
23 ka konfirmuar të njëjtët themelues të shtabit qendror që
24 konfirmoi dhe Sokol Bashota. Z. Thaçi nuk është një prej tyre.
25 Shihni provën 1D223.

1 As nuk ka pretenduar ndonjëherë z. Thaçi për ZPS-në që ka
2 qenë themelues i Shtabit Qendror apo Shtabit të Përgjithshëm,
3 por ka qenë një nga themeluesit e UÇK-së si lëvizje. Pra, ka
4 dyshime për këtë çështje.

5 Në paragrafin 224, ZPS-ja pretendon se Hashim Thaçi
6 drejtonte drejtorinë politike të paktën nga qershori i 1998-s.
7 Shohim diapozitivin 118.

8 Por Bislim Zyrapi vetë ju tha se Hashim Thaçi merrej me
9 median dhe marrëdhëniet me publikun dhe punët e jashtme
10 përpara nëntorit '98-s, jo me drejtorinë politike. Nuk ka
11 asnjë provë që të ketë ushtruar funksione të drejtorisë
12 politike përpara kësaj periudhe. Të flasim tani për provën e
13 Ambasadorit Hill që ka kaluar të gjithë verën duke kërkuar një
14 pikë kontakti të UÇK-së, tha, "dhe nuk e gjeta dot një pikë
15 kontakti", dhe arriti kulimin kur i tha vetë Uashingtoni në
16 shtator '98 që nëse doni të sillni UÇK-në për të negociuar,
17 gjeni një tavolinë të madhe atëherë se janë shumë. Shikoni
18 transkriptin faqja 27677.

19 ZPS-ja, asnjëherë nuk e kontestoi këtë pikë, nuk i tregoi
20 atij që ka pasur një drejtori politike funksionale që
21 kontrollonte politikat e UÇK-së asokohe dhe që drejtohej prej
22 Hashim Thaçit.

23 Tani ZPS-ja mbështetet në librin e Nuhi Bytyqit ku thuhet
24 se Thaçi pretendonte se ka qenë drejtori i drejtorisë politike
25 në fund të tetorit 1998. Ju lutem shihni transkriptin përkatës

1 dhe ky është një pretendim tjetër që ZPS-ja në fakt nuk ja
2 bëri pyetje dëshmitarit. Ne ju inkurajojnë ta shikoni dhe një
3 herë videon e paraqitjes së parë publike të Thaçit që është
4 incizuar në fund të tetorit por që është transmetuar në fund
5 të nëntorit, ku në fakt Thaçi nuk është prezantuar me këtë
6 titull. Shihni provën, ju lutem, P01256.

7 Vetë dëshmitari, gjatë kundërpvetjeve tha para këtij
8 Trupi Gjykues se z. Thaçi nuk ka qenë drejtori i drejtorisë
9 politike deri në nëntor 1998. Faqja e transkriptit 16783. ZPS-
10 ja nuk e kontestoi dëshminë e tij kur pati mundësinë për t'i
11 bërë pyetje shtesë.

12 Diapozitivi 119.

13 Zyrapi më pas ju tha se në fillim të nëntorit '98 z.
14 Thaçi drejtonte drejtorinë politike por nuk ka qenë i
15 përfshirë në çështjet ushtarake. Dëshminë e tij mund ta shihni
16 aktualisht në ekran. Ne e dimë që Bislim Zyrapi ka drejtuar
17 operacionet e UÇK-së të paktën nga korriku i '98-s, fillimisht
18 si drejtor i drejtorisë operative dhe më pas si shef i Shtabit
19 të Përgjithshëm. Zyrapi ju tha se Thaçi nuk ka pasur rol në
20 operacionet ushtarake të UÇK-së, e jo më të ketë luajtur
21 ndonjë rol qendror në operacione të tilla. ZPS-ja ju tha që
22 Zyrapi është një dëshmitar i besueshëm. ZPS-ja nuk e kontestoi
23 dëshminë e z. Zyrapi lidhur me këtë pikë gjatë periudhës që ai
24 dha dëshmi, dhe kanë qenë tri javë dëshmi.

25 Nuk duhet t'i vendosni peshë pretendimeve të ZPS-së që

1 Zyrapi ka folur në këtë mënyrë sepse ishte besnik ndaj z.
2 Thaçi apo për shkak të atmosferës së frikësimit në Kosovë, por
3 ZPS-ja nuk guxonte t'ja bënte pyetjet z. Zyrapi sepse kishte
4 frikë për përgjigjen që do të merrte. Kjo nuk është drejtë për
5 dëshmitarin dhe kjo nuk është e drejtë për të akuzuarit.

6 Pra, jepini peshën e duhur dëshmisë së z. Zyrapi dhe
7 duhet të hidhni hiye dyshimi mbi provat që ka ZPS-ja lidhur me
8 këtë pikë.

9 Më pas, ZPS-ja nuk ju jep asnjë provë lidhur me
10 pretendimin e vet se Thaçi ka qenë figurë udhëheqëse në LPK
11 dhe për ne kjo është thjesht e pabazë.

12 Kalojmë në diapozitivin 120.

13 ZPS-ja pretendon se Thaçi mbikëqyrte shpërndarjen e
14 informacionit publik që të garantonte që të ishte në favor të
15 strategjisë së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. S'ka asnjë
16 ndonjë informacion të besueshëm që Hashim Thaçi të ketë
17 mbikëqyrur shpërndarjen e informacioneve publike. Në veçanti,
18 ZPS-ja nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se Hashim
19 Thaçi ka pasur ndonjë përfshirje në përgatitjen e komunikata
20 dhe deklaratave politike. Asnjë dëshmitar nuk ka dhënë dëshmi
21 në lidhje me këtë. Asnjë prej librave të shumtë,
22 dorëshkrimeve, shënime, artikujve në gazeta apo dokumenteve të
23 tjera nuk përmbajnë qoftë edhe prova dytësore lidhur me faktin
24 që Hashim Thaçi të ketë hartuar komunikata apo deklarata
25 politike. Në fakt, në paragrafin 1477, poshtëshënimi 6234,

1 ZPS-ja arrin të citojë vetëm dy prova për të mbështetur
2 pretendimin e tyre se Hashim Thaçi ka pasur rol në përgatiten
3 e komunikatave.

4 Diapozitivi 121.

5 E para është një intervistë që ka dhënë Rexhep Selimi për
6 ZPS-në ku ai pretendon se Hashim Thaçi ka pasur një farë
7 lidhje me Komunikatën 59. Pretendimet e Selimit nuk mund të
8 merren parasysh për shumë arsye, të cilat ne i kemi përcaktuar
9 në paragrafët 236, 241 të dosjes sonë përfundimtare. Në
10 intervistën për ZPS-në Selimi i ka thënë kësaj të fundit që
11 nuk ka pasur dijeni personalisht se kush i hartonte
12 komunikatat e UÇK-së dhe thjesht ka hamendësuar, dhe mbi të
13 gjitha pretendimet e tij për Komunikatën 59 janë të
14 pakonfirmuara. Dhe z. Thaçi nuk ka pasur asnjë mundësi të
15 kontestojë dëshminë e z. Selimi kur janë bërë kundërpyetjet në
16 lidhje me këtë pikë. Në bazë të rregullës 140, Trupi Gjykses
17 nuk duhet ta përdorë këtë provë kundër z. Thaçi. Së fundit, ne
18 vërejmë se vetë z. Selimi në dosjen e tij përfundimtare në
19 paragrafin 614, e ka pranuar se nuk ka pasur dijeni se kush i
20 hartonte komunikatat dhe thjesht ka spekuluar gjatë kohës që
21 ka dhënë intervistën për ZPS-në.

22 Diapozitivi 122.

23 Prova e dytë dhe e fundit që ka ZPS-ja në lidhje me këtë,
24 pra, që z. Thaçi kinse ka pasur rol në hartimin dhe
25 shpërndarjen e komunikatave është një pjesë e një libri të

1 shkruar prej Nuhi Bytyqit, ku vetë Bytyqi shkruan se në fund
2 të tetorit 1998 z. Thaçi i kishte kërkuar Bytyqit të shkruante
3 një buletin për mediat ndërkombëtare e të raporte se z. Thaçi
4 ishte takuar me Byrnes, ku ZPS-ja merr një pjesë dhe thotë që
5 është publikuar nga drejtoria për informimin më 1 nëntor ku
6 raportohej takimi i UÇK-së me Shaun Byrnes. Është prova 303
7 kjo, faqja e fundit.

8 E shikoni këtë në ekran aktualisht. Dokumenti ka titullin
9 "shënim, informim", as "komunikatë" as "deklaratë politike".
10 Dhe është thjesht një raport, pra, është thjesht një raport
11 faktik që i dhënë medias që flet për takimin që ka pasur UÇK-
12 ja me një ndërkombëtar. As nuk flitet për oponentë, as për
13 luftë speciale në këtë informacion dhe dokumenti nuk mund ta
14 mbështesë kurrë pretendimin e ZPS-së dhe z. Thaçi paska qenë i
15 përfshirë në hartimin e komunikatave në përgjithësi apo ndonjë
16 tjetër më konkrete ku janë diskutuar bashkëpunëtorët apo lufta
17 speciale.

18 Kaq. ZPS-ja nuk jep një provë të vetme që z. Thaçi të
19 ketë pasur ndonjë rol në hartimin apo në shpërndarjen e
20 komunikatave apo deklaratave politike.

21 Mbi të gjitha edhe sikur ZPS-ja të arrijë të tregojë një
22 lidhje mes z. Thaçi dhe komunikatave, deklaratave politike,
23 ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë se këto komunikata dhe
24 deklarata politike kanë qenë një kontribut i konsiderueshëm në
25 lidhje me krimet për të cilat ngrihen akuzat në këtë çështje

1 gjyqësore. Do të trajtojmë aspektin juridik më pas në
2 parashtrimet e mia.

3 Dje, z. Halling na u duk sikur sugjeroi që z. Thaçi ka
4 qenë i lidhur me një komunikatë të pretenduar lidhur me
5 policinë ushtarake lidhur me zotërinjtë Desku dhe Kastrati.
6 Këtë pretendim s'e kanë të parashtruar në dosjen e tyre. E
7 vetmja komunikatë specifike me të cilën ZPS-ja lidh z. Thaçi
8 janë pikërisht komunikatat të evidentuara në poshtëshënimin që
9 unë sapo diskutova.

10 Diapozitivi 123.

11 ZPS-ja pretendon që Thaçi i shikonte oponentët si
12 kërcënim dhe i ka paralajmëruar se do të ndëshkoheshin.
13 Përfaqësues 484. Poshtëshënimi 2011, [Sipas përkthimit] që
14 pretendohet se e mbështet këtë në fakt, është një pjesë që
15 lidhet me z. Krasniqi. Është e paqartë për ne se si kjo pjesë
16 mbështet pretendimin që z. Thaçi ka kërcënuar oponentë dhe ne
17 nuk kemi asnjëherë argument në lidhje me këtë pikë.

18 Diapozitivi 124.

19 Thaçi ka marrë pjesë në vizita strategjike të Shtabit të
20 Përgjithshëm në zona operative për të formalizuar komandën, të
21 udhëzonte komandantët për luftën speciale dhe t'u tregonte
22 politikat e shënjestrimit dhe të garantonte ekzekutimet në
23 nivel -- dhe garantonte zbatimin e planit të përbashkët në
24 nivel terreni.

25 Ky është një pretendim bombastik që të shtyn të vrasësh

1 mendjen, dhe unë ju sugjeroj të lexoni poshtëshënimet. Këtu
2 bëhet fjalë për udhëtime të Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë
3 Hashim Thaçin dhe Bislum Zyrapi drejt Shalës, Llapit dhe
4 Dukagjinit. Këto i kam diskutuar tashmë. ZPS-ja nuk ka
5 vërtetuar se ka pasur diskutimet për luftë speciale në këto
6 mbledhje apo për ndonjë politikë të përbashkët.

7 Edhe një herë, është e paqartë si mundet që në të njëjtën
8 kohë ZPS-ja të pranojë edhe Bislum Zyrapi edhe nuk është
9 anëtar i NKP-së dhe anëtarë të NKP-së nuk duhet të diskutojnë
10 politikën, proponentët me të, por po ashtu argumenton se ai
11 është një nga personat që ka marrë pjesë në të gjitha takimet
12 në zona kur pretendohet se është diskutuar "realizimi i
13 politikave të shënjestrimit". Pra, nëse prania e Zyrapi në
14 këto takime nuk e bën këtë person një anëtar të NKP-së,
15 atëherë as Thaçi nuk është anëtar i NKP-së.

16 125.

17 Thaçi në mënyrë vazhdueshme ka inkurajuar arritjen e
18 qëllimit të përbashkët përmes autoritetit ekzekutiv si
19 kryeministër në Qeverinë e Përkohshme, por ZPS-ja nuk jep
20 asnjë provë në mbështetje të këtij pretendimi. Ky është një
21 shembull pse ju inkurajoj, ju lutem, lexoni poshtëshënimet
22 përpara se të pranoni argumentet e ZPS-së.

23 Kontributi tjetër i konsiderueshëm që pretendohet se
24 është bërë nga Hashim Thaçi është pjesëmarrja në lehtësimin,
25 inkurajimin e krimeve për realizimin e qëllimit të përbashkët.

1 Pretendimi i parë është që Thaçi ka urdhëruar anëtarë të
2 UÇK-së ta ndihmonin në kryerjen e krimeve.

3 Për këtë duhet të kalojmë në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë në incidentin e

6 Qirezit.

7 Dhe shfaqim në ekran diapozitivin 145.

8 Është e padiskutueshme dhe e padebatueshme se delegacioni
9 parlamentar në Qirez u mbajt i ndaluar përreth 48 orë. Për
10 arsyet e shpjeguara në këtë diapozitiv, ndalimi i 48 nuk mund
11 në vetvete të shkelë të drejtën ndërkombëtare themelore.

12 Diapozitivi 146.

13 Provat në dosje tregojnë se ndalimi nuk ishte pjesë e një
14 sulmi sistematik dhe të gjerë kundër popullatës civile.
15 Përkundrazi, UÇK-ja kishte arsye ushtarake për të ndaluar
16 delegacionin dhe për të marrë në pyetje atë. Mund t'i shihni
17 referencat për provat relevante në këtë diapozitiv.

18 Nëse ka dyshim të arsyeshëm se qëllimi i ndalimit është
19 motivuar, ishte bërë për arsye ushtarake siç është frika se
20 delegacioni mund të ketë ardhur i palajmëruar më parë për të
21 inkurajuar dorëzimin në një moment kur Qirezi ishte nën sulm,
22 atëherë ky ndalim nuk ka për synim që të realizojë qëllimin
23 kriminal të përbashkët të pretenduar të marrjes dhe ushtrimit
24 të kontrollit në të gjithë Kosovën dhe është jashtë
25 fushëveprimit të pretendimit për NKP të ngritur nga ZPS-ja.

1 Nuk ka rëndësi nëse synimi i UÇK-së për të realizuar
2 objektivin ushtarak nuk kishte arsye të besueshme të
3 mjaftueshme sepse realizimi i papërshtatshëm i objektivave
4 ushtarake të synuar nuk do të thotë se objektivi ishte politik
5 siç është përshkruar në qëllimin kriminal të përbashkët të
6 ZPS-së.

7 Diapozitivi 147.

8 Shqetësimet objektive të UÇK-së pasqyrohen në dokumentet
9 bashkëkohore që mund t'i shihni në këtë.

10 Diapozitivi 148.

11 UÇK-ja e lejoi delegacionin që të hyjë në Qirez, të flasë
12 me njerëzit, ashtu siç kishin lejuar më parë delegacione
13 parlamentare në zona të tjera.

14 Nëse ndalimi, në fakt, ishte pjesë e një sulmi të
15 organizuar kundër kundërshtareve, UÇK-ja nuk do të kishte
16 lejuar vizitat e tilla apo fjalime publike. Dhe në qoftë se ka
17 interpretim të arsyeshëm të provave se ndalimi ishte si pjesë
18 e realizimit të objektivit ushtarak për të ndaluar
19 parlamentarët nga inkurajimi i çarmatosjes në mes të
20 përplasjes ushtarake, atëherë kjo është jashtë qëllimit
21 kriminal të përbashkët të NKP-së.

22 Për më tepër, ZPS-ja të hënën u përpoq të siguronte se
23 komunikata e lëshuar më 18 shtator në një farë mënyre lidhej
24 me incidentin e Qirezit. Megjithatë, UÇK-ja nuk e dinte se do
25 të bëhej një vizitë në Qirez dy ditë më vonë dhe fillimisht e

1 lejoi delegacionin që të futej aty dhe të fliste me njerëzit.
2 Komunikata e 18 shtatorit nuk ka mundur të kontribuojë në
3 mënyrë të rëndësishme në ngjarjen e Qirezit.

4 Diapozitivi 149.

5 UÇK-ja nuk kishte ndërmarrë veprime kundër përfaqësuesve
6 të LDK-së në Qirez përpara datës 20 shtator 1998. Edhe këtu
7 është e pabesueshme [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR] të vazhdueshme dëshmuan se

1 delegacioni nuk u keqtrajtua dhe nuk u kërcënua në Qirez.

2 Diapozitivi 153. Këto nuk duhet të transmetohen për
3 publikun.

4 ZPS-ja nuk vërtetoi përtej dyshimit të arsyeshëm se
5 anëtarët e delegacionit u abuzuan në mënyrë të rëndë në Baicë.
6 Në të kundërt Dedaj dëshmoi se ka patur thjesht një zënkë të
7 vogël, një përplasje të vogël në të cilën askush nuk pati
8 lëndime që kërkonin ndërhyrje apo trajtim mjekësor. Dëshmia e
9 Dedajt në sallë të gjyqit lidhur me këtë pikë mbështetet nga
10 burime të shumta të provave bashkëkohore dhe asnjë provë
11 bashkëkohore e 1998-s nuk e kundërshton atë.

12 Diapozitivi 154.

13 Për shembull, Dedaj deklaroi se delegacioni u trajtua
14 mirë gjatë kohës që po flisnin në konferencën për shtyp më 23
15 shtator 1998 dhe në takimin vijues me PLK-në. Këtë mund ta
16 shihni në dokumentet bashkëkohore që e mbështesin dëshminë e
17 dhënë në gjyq nga Dedaj lidhur me këtë pikë.

18 Diapozitivi 155.

19 Një tjetër provë bashkëkohore që konfirmon se anëtarët e
20 delegacionit nuk u abuzuan apo keqtrajtuat në mënyrë të rëndë
21 është në këtë video, të shohim në këtë video të konferencës
22 për shtyp të Dedaj në 23 shtator. Kjo video tregon disa
23 anëtarë të delegacionit dhe konfirmon që nuk ka lëndime të
24 dukshme pak orë pas lirimit të tyre. Edhe më e rëndësishme,
25 ZPS-ja mesa duket nuk ishte në dijeni të videos së konferencës

1 për shtyp përpara deklaratës hyrëse të Mbrojtjes, që do të
2 thotë se ZPS-ja ngriti këto akuza pa shikuar videon e asokohe
3 për të vlerësuar besueshmërinë e deklaratës së dhënë EULEX-it
4 nga Dedaj në 2014-n.

5 Diapozitivi 156.

6 Duke mos qenë në gjendje të kundërshtojë të vërtetën siç
7 e paraqet videoja e bërë në atë kohë, ZPS-ja në gjykim u
8 përpoq që të shtrembërojë këtë video duke pretenduar se ajo
9 tregon mavijosje të Dedajt. Ne e kemi pjesën relevante të
10 deklaratave, parashtrimeve të ZPS-së në këtë diapozitiv.

11 Diapozitivi 157.

12 Megjithatë, gjatë pyetjeve tona ne vërtetë se ajo që
13 ZPS-ja përpigëj të paraqiste si mavijosje ishte në fakt një
14 hije nga ndriçimi për kamerat. Dhe pjesa relevante përkatëse e
15 transkriptit gjendet në këtë diapozitiv lidhur me këtë pikë.
16 Tani do t'ju lëshojmë një pjesë të shkurtër, fragment të
17 shkurtës të kësaj videoje, prova materiale P00321, që vërteton
18 këtë pikë. Edhe pse kemi audio, nuk kemi nevojë për përkthim
19 për këtë pikë.

20 [Luhet videoincizimi]

21 Z. MİSETIC: [Përkthim]

22 Diapozitivi 158.

23 Më së fundmi, në këtë diapozitiv mund të bëhet krahasimi
24 midis pjesës së videos që ju ka treguar ZPS-ja dëshmitarit
25 gjatë marrjes në pyetje dhe pjesëve të videos që i ka treguar

1 Mbrojtja gjatë marrjes në pyetje që ajo i ka bërë. Siç e tha
2 vetë dëshmitari, videoja që i ka treguar Mbrojtja, në fakt,
3 videoja që i ka treguar Mbrojtja tregon se dora e tij ishte "e
4 bardhë si bora".

5 Diapozitivi 159.

6 ZPS-ja e di që kjo video diskrediton argumentet e saj
7 lidhur me Qirezin, megjithatë nuk ka thënë asnjë fjalë të
8 vetme ZPS-ja lidhur me këtë video në dosjen e saj që përbëhet
9 nga 870 faqe. Dhe nuk ka thënë asgjë edhe në parashtimet
10 përmbyllëse pavarësisht asaj që ka thënë Mbrojtja në
11 deklaratën e saj përmbyllëse, as në pyetjet që i ka bërë z.
12 Gjergj Dedaj dhe pavarësisht faktit që ZPS-ja ka vendosur, e
13 ka paraqitur këtë video si pranim si provë materiale.

14 Pranimi nga ZPS-ja i efektit të fuqishëm të kësaj videoje
15 lidhur me këtë argument është ngjashme kur, në qoftë se i
16 kujtohet Trupit Gjykues, se si në këtë dosje të ZPS-së,
17 paragrafi 468, ZPS-ja pretendon që Dedaj "ishte traumatizuar
18 rëndë nga ky parandalim, ende ka dhimbje në këtë dorë si
19 rezultat i kësaj" dhe për këtë bazohet në intervistën e Dedaj
20 me EULEX-in në vitin 2014.

21 Diapozitivi tjetër nuk është për publikun.

22 Në paragrafin 945, duke folur për impaktin e viktimës
23 lidhur me ngjarjet e Qirezit, ZPS-ja vazhdon të citojë
24 deklaratën për EULEX-in të 2014, Dedaj në provën 680, në faqen
25 346260, por e ka ndryshuar këtë pretendim duke thënë që tani

1 Dedaj "ka dhimbje kronike dhe humbje të dëgjimit", që janë
2 lëndime të cilat nuk janë të dukshme dhe mund të hidhen poshtë
3 nga videoja e Qirezit, por e ka hedhur poshtë pretendimin që
4 Dedaj vazhdon të vuajë nga dhimbja në krahun e djathtë apo në
5 dorë si rezultat i ngjarjeve në Qirez, siç ka thënë në
6 deklaratën e EULEX-it në 2014-n. Arsyeja e vetme që ZPS-ja ka
7 hedhur poshtë këtë pretendim që ka bërë në dosjen e saj
8 paraprahe është për shkak se ZPS-ja e pranon që videoja e
9 Qirezit e diskrediton deklaratën për 2014 që ka dhënë Dedaj.

10 Diapozitivi tjetër mund të transmetohet për publikun.

11 Si përmbledhje, dëshmitë e kohës tregojnë që delegacioni
12 nuk është abuzuar në mënyrë të rëndë as në Qirez, as në Baicë
13 dhe nuk ka dëshmi të kohës që nga 1998 të tregojë që një gjë e
14 tillë ka ndodhur. Në të njëjtën kohë, këto prova e
15 diskreditojnë deklaratat e mëparshme të Dedajt si dhe
16 deklaratat e disa anëtarëve të tjerë të delegacionit dhe
17 krijon të paktën dyshim të besueshëm lidhur me përmbajtjen e
18 këtyre deklaratave.

19 Nga ana tjetër, ZPS-ja përpiqet që t'i hedhë poshtë
20 pranimet që ka bërë në gjykatë Dedaj se lidhur me faktin që
21 deklarata e tij e 2014-s ishte e fabrikuar duke argumentuar
22 ose që ka pasur frikë t'i tregojë të vërtetën para Trupit
23 Gjykses, apo që ka bërë ndërhyrje ndaj tij pavarësisht se nuk
24 është ngritur akuzë ndaj asnjë dëshmitari lidhur me këtë
25 aspekt.

1 Megjithëkëtë, fakti që Dedaj e ka tërhequr deklaratën e
2 tij në 2014-n për EULEX-in provohet nga provat e kohës,
3 përfshirë edhe këtë video të Qirezit. Siç e kam thënë, e
4 pranon heshtazi edhe vetë ZPS-ja. Ai nuk është gjuajtur edhe
5 goditur rëndë në dorën e tij, siç ka thënë në deklaratën e tij
6 për EULEX-in në 2014 dhe të cilën e pranon tani ZPS-ja.
7 Tërheqja e kësaj deklarate në gjykatë është tani e provuar dhe
8 ngre dyshim lidhur me vërtetësinë e deklaratës së tij të 2014.

9 Megjithëkëtë, këto dyshime të arsyeshme që dalin nga
10 dokumentet e kohës dhe videoja nuk mund të anashkalohen nga
11 frika e dëshmitarit, siç ka thënë në dosjen përfundimtare ZPS-
12 ja.

13 Diapozitivi 162.

14 Në fakt, pretendimi i ZPS-së se dëshmitari e ndryshoi
15 dëshminë për shkak të frikës nuk është i bazuar në logjikë.
16 ZPS-ja, në fakt, pretendon që Dedaj, si të tjerët, nuk kanë
17 patur frikë që të flisnin kundër Hashim Thaçit mes 2001 dhe
18 2014, kur Hashim Thaçi, në fakt, ishte në pushtet në Kosovë
19 dhe ata ishin kundërshtarët e tij politikë, por një dekadë më
20 vonë, papritur patën më shumë frikë pavarësisht se Hashim
21 Thaçi nuk kishte më funksione politike në Kosovë dhe mbahej i
22 paraburgosur në Hagë.

23 Është më shumë më e qartë se këto deklarata i kanë bërë
24 këto deklarata të rreme kur kanë menduar që mund të përfitojnë
25 politikisht prej tyre por nuk ishin në gjendje që t'i bënin

1 këto deklaratat të rreme kur janë marrë në pyetje si pjesë e
2 kësaj çështjeje gjyqësore.

3 Diapozitivi 163.

4 Edhe në qoftë se në Baicë ka patur keqtrajtim, ZPS-ja nuk
5 ka treguar që këtë ta ketë drejtuar Hashim Thaçi. Përkundrazi
6 provat e kohës tregojnë edhe një herë që delegacioni ia ka
7 vënë fajin Sabit Gecit. Dhe kjo reflektohet në telegramet
8 diplomatike të Shteteve të Bashkuara ku fajësohet Geci dhe nuk
9 përmendet Thaçi. Po kështu nuk është e vërtetë që Rugova dhe
10 udhëheqësit e tjerë të LDK-së, me të cilët ka patur kontakte
11 të shpeshta Shaun Byrnes, të mos kenë thënë asgjë që të
12 implikonte Thaçin dhe t'jua thoshte që Thaçi dhe të tjerët
13 duke patur parasysh që Thaçi ishte në atë kohë edhe kryesuesi i
14 delegacionit të Kosovës në Rambuje.

15 Diapozitivi 164.

16 Edhe dy çështje të tjera. Së pari, për arsye që kam
17 shpjeguar në këtë diapozitiv të cilat janë më në hollësi në
18 paragrafin 375 të dosjes sonë, rrëfimi i ZPS-së lidhur me
19 torturën nuk ka mbështetje.

20 Diapozitivi 165.

21 Dhe, së dyti, ZPS-ja nuk ka provuar përtej dyshimit të
22 arsyeshëm që Sabit Geci ka kërcënuar që do vrasë Agim
23 Krasniqin. Përkundrazi, deklaratat e 2014-s e vetë Agim
24 Krasniqit nuk përmend ndonjë kërcënim të tillë.

25 Dhe tani do të kthehem në çështjen e dy të ashtuquajturve

1 "gazetarë" serbë të cilët ishin parandaluar.

2 Të dy diapozitivat në vazhdim nuk duhet të transmetohen
3 në publik.

4 Diapozitivi 166.

5 Mund të ketë një deduksion të arsyeshëm që të
6 ashtuquajturit gazetarë serbë kanë qenë luftëtarë dhe/ose janë
7 parë si të tillë. Ata nuk janë ndaluar për shkak se ata ishin
8 në "kundërshtim me synimin e përbashkët kriminal për të marrë
9 kontrollin në Kosovë".

10 Trupi Gjykses është në dijeni të provave se njëri prej
11 këtyre të ashtuquajturve gazetar ishte i njohur si
12 paraushtarak serb nga luftërat në Kroaci dhe në Bosnjë dhe një
13 kontrabandist armësh dhe një person i dyshuar si kriminel
14 lufte. Nuk ka kundërshtim për këtë.

15 Në qoftë se këta të dy janë ndaluar për shkak të
16 realizimit të objektivave ushtarake të UÇK-së për shkak se ata
17 po silleshin në mënyrë të dyshimtë apo vepronin në mënyrë të
18 atillë apo kishin hyrë në një zonë luftarake pa kredenciale të
19 medias, atëherë ndalimi i tyre është si në zbatim të
20 objektivave ushtarake dhe jo të luftës kundër kundërshtarëve
21 të cilët kundërshtojnë anëtarët e NKP-së që në objektivin e
22 tyre për të siguruar kontrollin e Kosovës. Në qoftë se është
23 kështu, atëherë pretendimi nuk mund të shfrytëzohet për të
24 mbështetur argumentin që bëhet fjalë për një NKP të
25 përbashkët.

1 Diapozitivi tjetër mund të transmetohet. Diapozitivi 167.

2 Nuk mund të bëhet një deduksion i arsyeshëm këtu që z.

3 Thaçi nuk ka marrë pjesë -- në fakt është një deduksion që z.

4 Thaçi nuk ka marrë pjesë në këtë pyetje të personit. As i

5 ashtuquajhuri gazetar nuk e ka identifikuar Thaçin që ta ketë

6 marrë në pyetje. Z. Thaçi nuk flet serbisht dhe ekziston një

7 dyshim i arsyeshëm nëse ai ka luajtur rol në pyetjen e këtyre

8 individëve dhe kjo diskutohet në mënyrë të plotë në paragrafët

9 379, 383 të dosjes sonë përfundimtare.

10 Nuk është e pazakontë që individë të tillë nuk i kanë

11 dërguar para një gjykatësi. Ata janë paraburgosur në tetor

12 1998, menjëherë pas ofensivës serbe, e cila kishte shkatërruar

13 UÇK-në dhe përpara se të hynte në fuqi armëpushimi.

14 Diapozitivi 168.

15 UÇK-ja nuk ishte në gjendje që të përqendrohej në

16 krijimin e institucioneve të një procesi të drejtë në verë dhe

17 në vjeshtë të vitit 1998. Vetëm pas armëpushimit të tetorit

18 ishte në gjendje UÇK-ja, në nëntor të 1998-s, që të fillonte

19 ristrukturimin, përfshirë duke krijuar dhe institucionet e një

20 procesi të drejtë.

21 Udhëzuesit e prillit 2023 të Kryqit të Kuq të cilat

22 diskutohen në paragrafin 66 të dosjes sonë përfundimtare,

23 merren pikërisht me këtë dilemë të grupeve joshtetërore të

24 armatosura dhe procesit të drejtë dhe Kryqi i Kuq i ka

25 përcaktuar se disa kushte të paraburgimit do të duhet të

1 respektohen nga pala parandaluese brenda kapaciteteve të tyre
2 dhe Kryqi i Kuq e pranon apo vëren se "mund të duhet kohë për
3 t'i gjetur burimet dhe për të krijuar këto procedura të
4 efektshme të rishikimit dhe për t'i përcaktuar dhe zbatuar
5 ato". Dhe një gjë e tillë ka ndodhur pikërisht këtu. Aftësia e
6 UÇK-së për të krijuar procesin e drejtë mund të duhet të
7 vlerësohet brenda rrethanave në të cilat gjendet dhe jo
8 procesit që ekziston në shtetet e krijuara prej kohësh.

9 Rrjedhimisht, ekziston dyshimi i arsyeshëm lidhur me
10 pretendimin e ZPS-së në këtë argument të saj se në rastin e dy
11 të ashtuquajturve gazetarë serbë z. Thaçi ka patur një
12 kontribut substancial lidhur me krimet për të cilat përdoren.

13 Tani do të flas lidhur me çështjen që ka të bëjë me Ukë
14 Bytyqin dhe Avdyl Ramën. Për të kursyer kohën, do t'i kërkoja
15 Trupit Gjykues që të përqendrohen në paragrafët 346, 352 të
16 dosjes përfundimtare të Thaçit.

17 Diapozitivi 169.

18 ZPS-ja pretendon se z. Thaçi i inkurajoi anëtarët e UÇK-
19 së që të "luftonin" kundër të gjithë atyre që [nuk] kanë
20 respektuar Shtabin e Përgjithshëm apo të respektonin urdhrat e
21 vetë Thaçit dhe siç vartësit e tij e kanë kuptuar këtë mesazh
22 dhe zbatuar atë. Ky pretendim është i bazuar në udhëtimin e
23 Shtabit të Përgjithshëm në Dukagjin në fillim të shtatorit
24 1998 dhe ai analizohet në paragrafët 141, 145 të dosjes
25 përfundimtare të Thaçit dhe për të kursyer kohë nuk do t'i

1 përsëris këtua.

2 Megjithëkëtë, si përfundim, incidenti që ka të bëjë me
3 Tahir Zemajn është provokuar nga Tahir Zemaj dhe përpjekje të
4 Bukoshit për të shënjestruar UÇK-në për ta marrë kontrollin
5 nga FARK-u të të gjithë Kosovës, kryesisht të zonës së
6 Dukagjinit dhe, që zona e Dukagjinit të mbështeste Rugovën si
7 negociator në bisedimet me Ambasadorin Hill dhe jo Adem
8 Demaçin që ishte zgjedhja e Shtabit të Përgjithshëm. Anëtarët
9 e Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë Bislum Zyrapi, erdhën në
10 Dukagjin për ta parandaluar Bukoshin dhe Zemajn që të
11 ekzekutonte këtë kontroll dhe z. Thaçi nuk ka përdorur dhe as
12 që ka nxitur përdorimin e dhunës kundër askujt.

13 Edhe një herë, duhet nënvijëzuar se Bislum Zyrapi ka qenë
14 i pranishëm.

15 Për sa i përket përkthyesit po kalojmë në diapozitivin
16 171.

17 ZPS-ja më pas argumenton se Thaçi ka bërë një kontribut
18 të ndjeshëm në NKP duke mos parandaluar, hetuar apo dënuar të
19 tjerë. ZPS-ja thotë që aktivitetet kriminale janë aprovuar nga
20 Thaçi apo Shtabi i Përgjithshëm por nuk ka prova për këtë. E
21 thekson dëshminë e W04748, që i cili nuk ka pretenduar që z.
22 Thaçi ka lëshuar apo miratuar urdhra për aktivitete kriminale.
23 Më pas ata citojnë incidentin e Qirezit, por nuk e mbështesin
24 këtë pretendim për arsye të cilat i kemi thënë.

25 Kalojmë tek 173 dhe mund të transmetohet në publik.

1 ZPS-ja thotë, pretendon se Thaçi ka shfrytëzuar fuqinë si
2 kryeministër për të emëruar të bashkakuzuarit dhe anëtarët e
3 tjetër të NKP-së në pozicione të nivelit të lartë në Qeverinë
4 Provizore.

5 Së pari, nuk ka prova përtej dyshimit të arsyeshëm që z.
6 Hashim Thaçi të këtë caktuar që të jenë anëtarë të qeverisë,
7 të shfrytëzojë pushtetin e tij si kryeministër për të emëruar
8 të bashkakuzuarit dhe anëtarët e tjerë në Qeverinë e
9 Përkohshme.

10 Së dyti, ZPS-ja nuk ka arritur që të provojë dhe as të
11 pretendojë që Hashim Thaçi e kishte ditur që ndonjë anëtar i
12 Qeverisë së Përkohshme të ketë kryer krime.

13 Diapozitivi 174.

14 Në paragrafët 475, 456, ZPS-ja thotë se KFOR-i nuk ka
15 marrë njoftime nga udhëheqja e UÇK-së për të hetuar krime të
16 bëra nga anëtarë të UÇK-së pavarësisht se ka patur mundësinë
17 për ta bërë një gjë të tillë dhe për të marrë masa kundër
18 tyre.

19 Së pari, nëse ka marrë apo jo UÇK-ja referime apo ka
20 marrë masa disiplinore nuk ka vlerë lidhur me vlerësimin e
21 rolit apo kontributit të ndjeshëm të z. Thaçi. Është e
22 rëndësishme -- janë veprimet personale të Thaçit. Nuk ka prova
23 përtej dyshimit të arsyeshëm që Thaçi të ketë patur njohuri
24 për krime specifike të bëra nga anëtarë të UÇK-së që të ishin
25 vartësit e tij dhe për të cilat nuk ka patur dijeni KFOR-i o

1 UNMIK-u.

2 Kalojmë në 175.

3 Në fakt, Paul Williams tha që nuk i kujtohet askush nga
4 anëtarët e komunitetit ndërkombëtar që të ketë thënë që z.
5 Thaçi apo UÇK-ja do të duhet të bënë më shumë për të hetuar
6 dhe për të ndjekur krimet dhe se ai vetë, si këshilltari
7 ligjor i delegacionit të Kosovës, nuk i ka thënë ndonjëherë z.
8 Thaçi që ai ka patur detyrimin për të hetuar dhe për të dënuar
9 të tjerët.

10 Më tej, ZPS-ja pretendon se z. Thaçi ka kontribuar ndaj
11 synimit të përbashkët kriminal përmes shpërndarjes së
12 informacionit për ta nxitur synimin e përbashkët dhe për të
13 krijuar frikë, pabesim dhe urrejtje.

14 Në paragrafin 492, ZPS-ja thotë se Thaçi ka përdorur
15 informacionin dhe shpërndarjen e tij përmes deklaratave
16 publike dhe medias si mekanizëm për të nxitur synimin e
17 përbashkët në drejtim të anëtarëve të UÇK-së të cilët do të
18 ishin ata që do ta zbatonin.

19 Diapozitivi 176.

20 ZPS-ja nuk ka treguar se si këto deklarata publike apo
21 fjalime publike kanë kontribuar për krime të cilat paraqiten
22 në aktakuzë apo që ka patur ndonjë lidhje mes shpërndarjes së
23 informacionit në fjalë dhe krimeve të aktakuzës. Trupit
24 Gjykues i kërkohet që ta vlerësojnë një gjë të tillë pasi kemi
25 parë në raste të mëparshme të NKP-së kur gjykatësit kanë parë

1 efektin dhe impaktin e deklaratave publike dhe fjalimeve të të
2 akuzuarve. Ju referoj juve ndaj çështjeve që paraqisnin këtë
3 diapozitiv.

4 Diapozitivi 178.

5 Deklarata numër 7 ku bëhet fjalë për "grushtin e
6 pamëshirshëm" dhe "luftën speciale".

7 Nuk ka prova se kush është autori i këtij teksti. ZPS-ja
8 nuk ka prova të besueshme që ta lidhin Hashim Thaçi në
9 përgatitjen apo shpërndarjen e ndonjë komunikate apo deklarate
10 publike, përfshirë edhe këtë. Edhe në qoftë se do të kishin
11 këto, si është ndërlidhja logjike me krimet e aktakuzës? Çfarë
12 provash janë parë që dikush e ka shkruar këtë deklaratën nga
13 ana e UÇK-së dhe është inspiruar apo frymëzuar për të bërë
14 krimet në cilat paraqiten në këtë aktakuzë?

15 Diapozitivi 179.

16 ZPS-ja thotë që Thaçi ka vazhduar që të nxisë, që të
17 përmendë çështjen e luftës speciale dhe aktivitetet e
18 kundërshtarëve dhe si pjesë e masave parandaluese. Dhe këtu
19 ata citojnë paraqitjen televizive të Thaçit në nëntor të 1998-
20 s. Por nuk ka thënë asgjë për nxitjen e krimeve. Nuk ka ndonjë
21 lidhje logjike me ndonjë krim. Dhe ndërhyrja e tij publike
22 vjen menjëherë pas krimit të gjykatës ushtarake për t'u marrë
23 me bashkëpunëtorët dhe urdhrin 1D29 të Zyrarit për t'i
24 trajtuar në mënyrë të duhur civilët, siç e kam thënë më herët
25 edhe vetë ZPS-ja thotë që ka ardhur në kohën kur UÇK-ja donte

1 që të shihej si një ushtri ndërkombëtarisht si një ushtri që
2 respektonte ligjin. Nuk ka ndonjë lidhje logjike apo shkakore
3 këtu apo ndjekje të kësaj politike.

4 Më pas, në 494, ZPS-ja thotë që z. Thaçi, ka shfrytëzuar
5 autoritetin si kryeministër dhe ka përdorur autoritetin e tij
6 duke shfrytëzuar burimet organizative në drejtim të nxitjes së
7 synimit të përbashkët përmes medias. E vetmja mbështetje për
8 këtë është pretendimi në poshtëshënimin 2037, që Thaçi dhe
9 Veseli kanë vizituar KosovaPress më 12 maj 1999 dhe kanë
10 shprehur vlerësim të punës së tyre. Dhe më pas është thënë që
11 ata kishin mbështetjen, KosovaPress kishte mbështetjen e
12 Shtabit të Përgjithshëm të Qeverisë së Përkohshme dhe Qeverisë
13 së Shqipërisë.

14 Siç kemi thënë në paragrafin 253 deri 255 videoja e
15 vizitës nuk tregon ndonjë dëshmi të Thaçit që të vlerësojë
16 KosovaPress. Megjithëkëtë, vetëm fakti që Thaçi mund të ketë
17 shprehur vlerësim të punës së KosovaPress në mes të luftës së
18 pastrimit etnik që bënte Serbia në Kosovë apo të autoritetit
19 apo të fushatës bombarduese të NATO-s kjo nuk është bazë për
20 të konkluduar që "Thaçi ka vazhduar ta shfrytëzojë autoritetin
21 për të luftuar kundërshtimin politik me luftë".

22 Diapozitivi 181.

23 Në 495, ZPS-ja thotë që Thaçi ka bërë deklarata publike
24 të cilat synonin që të krijonin frikë dhe urrejtje të
25 oponentëve. Shumë organe të medias kanë botuar komunikata të

1 cilat thuhej se kishin autor Thaçinin dhe të cilat kishin gjëra
2 të pasakta dhe të rrezikshme të cilat synonin të eliminonin
3 oponentët.

4 Dhe për ta mbështetur këtë ata mbështeten në deklaratën e
5 ZPS-së të Rexhep Selimit që ka të bëjë me Komunikatën 59, që
6 nuk është e besueshme për arsyet që kemi përmendur.

7 Kemi përmendur po kështu, u mbështetëm po kështu dhe në
8 dy intervista të gazetave të janarit 1999 dhe të majit 1999.
9 Nuk ka asgjë për të sugjeruar këtu që z. Thaçi donte që të
10 bëheshin krime kundër civilëve dhe gjatë gjithë kësaj periudhe
11 komuniteti ndërkombëtar e ndiqte punën e z. Thaçi. Megjithatë,
12 nuk ka prova që të paraqiten që ndokush në UÇK edhe kur i ka
13 lexuar këto intervista të ketë arritur në përfundimin që t'i
14 ketë lexuar apo të jenë frymëzuar prej këtyre për të kryer
15 krimet siç paraqiten në aktakuzë. Dhe në këtë mënyrë as nuk
16 mund të arrihet konkluzioni që të ketë patur një kontribut të
17 ndjeshëm për ndonjë krim.

18 Në paragrafin 496, ZPS-ja thotë që "anëtarët e UÇK-së
19 kanë kuptuar që deklaratat politike dhe komunikatat që Thaçi
20 dhe të tjerët kanë nxjerrë janë shfrytëzuar si udhëzime
21 përfshirë dhe në çështjen e paraburgimeve".

22 Këtu, ZPS-ja citon urdhrat e Remit për amnisti për të
23 parandaluarit që thotë janë bazuar në komunikata të UÇK-së.
24 Por siç e kemi thënë gjatë marrjes në pyetje të Remit nga ana
25 jonë - dhe mund të shihni në diapozitiv - nuk ka komunikata të

1 tilla t'u kërkojnë komandantët të zonave që të bëjnë amnisti
2 dhe ZPS-ja nuk ka arritur të identifikojë ndonjë komunikatë të
3 tillë.

4 Në qoftë se ZPS-ja nuk është në gjendje të tregojë
5 komunikata të cilat i kërkojnë Remit që të bëjnë amnisti, ZPS-
6 ja nuk mund të argumentojë dhe të thotë që "anëtarët e UÇK-së
7 e kanë kuptuar që deklaratat politike dhe komunikatat që Thaçi
8 dhe të tjerët kanë nxitur janë shfrytëzuar si udhëzime".

9 Edhe një herë mund ta them që ZPS-ja nuk ka prova të
10 besueshme që thonë që Thaçi të ketë patur rol në nxjerrjen e
11 një deklarate të vetme apo deklarate të tillë.

12 Diapozitivi 182.

13 Në paragrafin 497, ZPS-ja thotë që Thaçi e ka drejtuar
14 mesazhin ndërkombëtar i cili e ka mohuar, e ka zvogëluar
15 politikën e shënjestrimit, ndërkohë që deklaratat e Shtabit të
16 Përgjithshëm dhe komunikatat e kanë vazhduar që ta
17 propagandojnë këtë politikë brenda.

18 Dhe një numër pyetjesh dalin këtu. Si mund që deklaratat
19 e Shtabit të Përgjithshëm dhe komunikatat ta propagandojnë një
20 gjë të tillë në mënyrë të brendshme? Ato ishin deklarata
21 publike. Si mund të mos i shihnin ndërkombëtarët atë të
22 ashtuquajturin "shënjestrimin e kundërshtarëve për krime"
23 ndërkohë që në mënyrë të brendshme mund ta shihte UÇK-ja? Si
24 ka mundësi që Zyrapi nuk i ka deshifruar këto dhe ta kuptonte
25 se UÇK-së po i kërkohej përmes komunikatave që të luftonte

1 kundërshtarët dhe të bënte krime lufte?

2 Tre diapozitivat në vazhdim nuk duhet të transmetohen në
3 publik.

4 Në paragrafin 498, ZPS-ja thotë që Thaçi nuk ka treguar
5 informacion që kishte lidhur me viktimat me qëllim që të
6 pengonte hetimin dhe nga ana e familjeve.

7 Së pari, ZPS-ja nuk ka treguar që Hashim Thaçi të ketë
8 patur informacion që nuk e kanë patur familjet.

9 Së dyti, takimet e z. Thaçi me familjet nuk janë pjesë e
10 periudhës së aktakuzës dhe janë jashtë juridiksionit të kohor.
11 Dhe nuk mund të shfrytëzohen si *actus reus* për krimet të cilat
12 paraqiten në këtë aktakuzë.

13 Diapozitivi 184.

14 Ne vërejmë se kur pala mbrojtëse ka kundërshtuar pyetjen
15 e anëtarëve të familjes me z. Thaçi që bien jashtë periudhës
16 së kësaj aktakuze, ZPS-ja ka thënë që nuk po përpiqet që të
17 merrte dëshmi lidhur -- që të provonte *actus reus* e ndonjë
18 krimi përfshirë dhe lidhur me zhdukjen e dhunshme, por për të
19 provuar *mens rea* e tij për krimet që janë brenda periudhës së
20 aktakuzës. Trupi Gjykues e lejoi ZPS-në që të vazhdonte mbi
21 bazën e asaj oferte. Ne jemi kundër, ne e kundërshtuam
22 mungesën e njoftimit lidhur me përpjekjen e ZPS-së për ta
23 shfrytëzuar këtë provë të takimit që është jashtë afatit kohor
24 të aktakuzës për të provuar *actus reus* të një kontributi të
25 rëndësishëm në NKP.

1 Diapozitivi 185.

2 Në paragrafin 499, ZPS-ja pretendon që takimi i Thaçit me
3 *The Human Right Watch* në nëntor të 1999-s "ka legjitimuar së
4 brendshmi krimet e UÇK-së duke e çuar më tej kështu synimin e
5 përbashkët kriminal".

6 Siç e kemi shpjeguar, përkundrazi, siç e kemi shpjeguar
7 në paragrafin 271, 277 të deklaratës sonë përfundimtare, ka
8 një pretendim të arsyeshëm që Thaçi e ka përçuar këtë
9 informacion nga takimi me *The Human Right Watch* dhe Fred
10 Abrahams dhe u krijua një gjykatë ushtarake. Në të njëjtin
11 muaj, Zyrapi lëshoi urdhra për të ndaluar abuzimin e civilëve
12 të cilët ZPS-ja vetë e pranon që ishte mundësi "për t'u
13 treguar ndërkombëtarëve që ishin ushtri e disiplinuar".
14 Poshtëshënimi 280 i ZPS-së.

15 Është e arsyeshme që të arrihet konkluzioni që Hashim
16 Thaçi ka kaluar atë që kishte mësuar nga Fred Abrahams dhe kjo
17 çoi në faktin që Shtabi i Përgjithshëm u përpoq që të
18 përmirësonte zbatimin të së drejtës ndërkombëtare.

19 Diapozitivi 186.

20 Gjatë argumenteve përmyllëse më 9 shtator 2026, ZPS-ja
21 foli për këtë takim dhe tha që ishte një shembull i fjalëve
22 të z. Thaçi dhe i sjelljes së tij që ishte në fakt vetëm një
23 pretendim i anëtarëve të NKP-së "për të fshehur shënjestrimin"
24 e kundërshtarëve dhe krimet.

25 Edhe një herë e them se asgjë në këtë nuk është, nuk ka

1 cituar transkriptin e dëshmisë së z. Abrahams që ta mbështesë
2 këtë argument. Z. Thaçi e ka thënë në mënyrë specifike i ka
3 kërkuar z. Abrahams që për këtë çështje. Dhe Gjykatësi Barthe,
4 në fakt, e ka pyetur z. Abrahams pikërisht këtë pyetje, ai
5 tha se nuk ishte në gjendje që të fliste lidhur me këtë takim.
6 Siç mund të shihet në diapozitivin 187 dhe 188.

7 Kalojmë tani në diapozitivin 191.

8 Në paragrafin 501 -- është në faqen 100 të këtij
9 dokumenti që ta shfrytëzojnë përkthyesit.

10 Në paragrafin 501, ZPS-ja pretendon që Thaçi po drejtonte
11 një" këshill personal të personelit". Që në fillim, nuk ka
12 asnjë pretendim në aktakuzë apo në dosjen paraprake të ZPS-së
13 që të pretendojë që Hashim Thaçi ka patur rol lidhur me
14 politikën e personelit të këshillit apo të ketë drejtuar një
15 këshill personal dhe jemi kundër mungesës së njoftimit lidhur
16 me këtë, pasi nuk kemi pasur mundësi për të dëgjuar për këtë.
17 Ne kemi, për shembull, eksploruar këtë me z. Zyrapin dhe i kemi
18 dhënë dhe në qoftë se ZPS-ja do na kishte njoftuar për këtë do
19 ta kishim drejtuar këtë çështje.

20 Diapozitivi 192.

21 Këshilli i personelit është diskutuar në takimin e
22 janarit 1999 kur Hashim Thaçi nuk ka qenë në vend dhe nuk ka
23 dëshmi që ndokush të ketë komunikuar me z. Thaçi lidhur me
24 vendimin, lidhur me personelin kur ishte ai jashtë.

25 Organigrama e ZPS-së thotë që drejtorja e personelit

1 është në varësi të Zyrapit. Në paragrafin 172, 184, ZPS-ja
2 thotë që përmes kësaj drejtorie "Shtabi i Përgjithshëm ka
3 miratuar, konfirmuar, caktuar personat e besuar të cilët
4 kishin demonstruar besnikëri dhe angazhim ndaj synimit të
5 përbashkët kriminal dhe kanë shkarkuar ata të cilët nuk kanë
6 qenë pjesë e kësaj".

7 Diapozitivi 194.

8 Atëherë si mund të zbatonte departamenti i personelit, si
9 mund të zbatonte një politikë të një synimi të përbashkët
10 kriminal kur ishte nën Zyrapin dhe ZPS-ja thotë në paragrafin
11 1432 që ai nuk ishte në të njëjtin rreth të brendshëm të
12 Shtabit të Përgjithshëm si të akuzuarit, nuk ishte i besuar
13 nga anëtarët e tjerë të UÇK-së dhe këta janë faktorë të cilët
14 bëjnë që të mos diskutohen çështje të NKP-së pasi nuk i
15 besojnë atij lidhur me politikën e luftës kundër
16 kundërshtarëve.

17 Në paragrafin 176, për shembull, u fol se Halitjaha
18 përmes personelit, drejtorisë së personelit thotë "në shkurt
19 dhe në mars të 1999-s, se së bashku me Bislim Zyrapin dhe Sali
20 Veselin, ku mes të tjerave kanë folur për luftën speciale". Si
21 Zyrapin nuk ishte anëtar i NKP-së dhe nuk kishte dijeni për
22 synimin e përbashkët, si mund të ketë ndodhur një gjë e tillë
23 atëherë?

24 Vazhdojmë më tej me diapozitivin 197, është një
25 diapozitiv që nuk duhet të paraqitet për publikun.

1 Më tej, ZPS-ja vazhdon dhe i referohet incidentit të
2 Tahir Zemaajt duke thënë që kjo ishte provë e aftësisë së
3 Thaçit për të zbatuar vendimin e Shtabit të Përgjithshëm për
4 të zëvendësuar Zemajn me Haradinaj. Megjithatë sikurse e kemi
5 shpjeguar në dosjen tonë, dëshmia ishte që Ramush Haradinaj
6 kishte dhënë vendin e tij Zemaajt në mënyrë vullnetare dhe, në
7 fund fare, ishte vendim i Haradinajt në qoftë se do kthehej në
8 të njëjtin pozicion apo jo dhe pa diskutim që nuk ishte vendim
9 i Hashim Thaçit. Dhe Haradinaj e mori këtë pozicion përsëri.

10 Haradinaj nuk varej nga askush. Në qoftë se mund të
11 përdorë një analogji të sportit, Ramush Haradinaj ishte një
12 lojtar futbolli i lirë dhe ishte ai i cili vendoste me kë ekip
13 të shkonte dhe në fund fare ishte vetë ai i cili vendosi të
14 ishte pjesë e ekipit të Shtabit të Përgjithshëm.

15 Vazhdojmë me diapozitivin e radhës.

16 Dëshmitari W01493 ka hedhur poshtë në mënyrë të
17 drejtpërdrejtë argumentin e ZPS-së. Ai ka bërë të qartë që as
18 z. Thaçi dhe askush tjetër në Shtabin e Përgjithshëm nuk
19 kishte autoritet të merrte vendime në qoftë se do zëvendësohej
20 Zemaj apo jo, dhe që në fund ishte Haradinaj ai që kishte
21 kompetencën të bënte vendimin përfundimtar apo të merrte
22 vendimin përfundimtar. Këtë mund ta shikoni në diapozitivin e
23 radhës.

24 Ndërkohë vijojmë me diapozitivin e radhës që është
25 diapozitivi 200 që mund të paraqitet për publikun.

1 Ekziston pretendimi që z. Thaçi dhe Shtabi i Përgjithshëm
2 në mënyrë kolektive siguruan që kishte mbështetje logjistike
3 për nevojat e vartësve të UÇK-së, përfshirë këtu edhe nevojat
4 për drejtimin e qendrave të ndalimit.

5 Po ashtu Prokuroria i referohet intervistës së Zyrapit të
6 dhënë për ZPS-në ku ai thotë që Shtabi i Përgjithshëm ka dhënë
7 mbështetje logjistike për krijimin e qendrave të ndalimit, por
8 kjo duket të ketë ndodhur pas ristrukturimit.

9 Ajo çfarë është më e rëndësishme është që nuk ka asnjë
10 provë që citon që Hashim Thaçi personalisht ka dhënë
11 mbështetje logjistike. Zyrapit ka dhënë mbështetje logjistike
12 por nuk është në NKP, sipas ZPS-së, ndërkohë që Thaçi nuk ka
13 qenë fare i përfshirë në mbështetjen logjistike, por sipas
14 ZPS-së sërish ai ishte pjesë e NPK-së.

15 Sipas ZPS-së, Thaçi ka dhënë armë dhe, sipas ZPS-së
16 përsëri, këto janë dhënë "vetëm me mbështetje të Shtabit të
17 Përgjithshëm".

18 Ndërkohë që nuk ekzistojnë prova absolutisht për të
19 siguruar që ishin dhënë urdhra për furnizimin me armë të
20 urdhëruar nga Thaçi, nga Selimi, Veseli apo Krasniqi. Nuk
21 ekzistojnë prova po ashtu që Thaçi ishte i vetëdijshtë apo
22 ishte i informuar që armën do të përdorehin për të mbështetur
23 qëllimin e përbashkët kriminal të pretenduar.

24 Më pas thuhet që z. Thaçi ka luajtur një rol të
25 rëndësishëm përmes koordinimit dhe ndërlikohjes ndërmjet

1 anëtarëve të NKP-së dhe instrumenteve në dispozicion.

2 Domethënë, ky është një seksion të cilit unë i kam vënë
3 titullon faj përmes asocimit. Për shembull, thuhet që Thaçi ka
4 vizituar Lahi Brahimajn në Jabllanicë. Ndërkohë që nuk jepet
5 asnjë koment tjetër. Nuk ka asnjë pretendim dhe nuk ka asnjë
6 fakt që thuhet që z. Thaçi vinte për krimet në Jabllanicë.
7 Ndërkohë z. Haradinaj ishte pjesë e zonës ku pretendohet që të
8 këtë ndodhur krimi po ndërkohë nuk kemi asnjë akuzë për
9 anëtarësinë në NKP të tij.

10 Ndërkohë, më pas ZPS-ja pretendon që për të siguruar
11 qëllimin e përbashkët kriminal, z. Thaçi ka vizituar dhe është
12 lidhur me Lahi Brahimajn dhe është takuar gjithashtu me
13 zyrtarë të lartë në Likoc, Drenicë, Malishevë e të tjerë, duke
14 manifestuar rolin e tij për të pasur kontroll.

15 Në interes të kohës, do të thoja që ZPS-ja nuk jep asnjë
16 provë që Thaçi ka pasur ndonjë bisedë me asnjë palë për sa i
17 takon bashkëpunëtorëve të ndaluarve apo nevojës për të
18 shenjëstruar të ashtuquajturit oponentë.

19 ZPS-ja nuk jep asnjë provë që deklaron që z. Thaçi ka
20 kontaktuar me ndonjë nga këta persona në këto vende. Dhe
21 përsëri më duhet ta theksoj faktin që Zyrapin ka qenë i
22 pranishëm në shumë prej këtyre takimeve.

23 Tani do të trajtoj temën tjetër që është tema e komandës
24 së z. Thaçi.

25 Sikurse e kemi thënë në dosjen tonë, ne i qëndrojmë

1 pozicionit tonë që ZPS-ja nuk ka provuar asnjë prej elementëve
2 të përgjegjësive komanduese që do ta bënte z. Thaçi
3 përgjegjës. Dëshirojmë që të theksojmë disa pika të tjera
4 shitesë të cilat rrjedhin nga dokumentet e ZPS-së, përkatësisht
5 nga dosja e saj dhe nga deklarata përmyllëse.

6 Diapozitivi 204.

7 Besoj që ju kujtohet që dëgjuat z. Tieger të diskutonte
8 për rastin e Bellacërkës. Megjithatë besoj dhe për të qenë më
9 konkret bëhet fjalë në diapozitivin 205 të dosjes së ZPS-së ku
10 thuhet që z. Thaçi dhe z. Veseli kanë qenë vetë në këtë vend
11 më datë 17 qershor 1998 në Gurin e Bardhë.

12 Vazhdojmë më tej në të njëjtin diapozitiv. Në
13 poshtëshënimin 1653, ZPS-ja i referohet zhdukjes së personave
14 që punonin në minierë. Ndërkohë që sipas artikujve të gazetës
15 kjo nuk ka ndodhur deri më datë 22 qershor. Kështu që nuk e
16 kuptojmë se ku do të dalë ZPS-ja ndërkohë që thotë që z. Thaçi
17 dhe z. Veseli kanë qenë atje ndërkohë që krimi ka ndodhur pesë
18 ditë pasi kanë qenë ata të dy atje.

19 Më tej ZPS-ja diskuton një takim midis Thaçit dhe Veselit
20 me ndërkombëtarët në pasojat e sulmit të Rahovecit. Në
21 përmbledhje dëshiroj të them që edhe në këtë rast ZPS-ja
22 injoron dëshmitë e dhëna këtu në sallën e gjyqit, në veçanti
23 dëshminë e dëshmitarit z. Kickert. Ai ka thënë përpara Trupit
24 Gjykses që nuk i kujtohet në qoftë se ka pasur ndonjë diskutim
25 lidhur me Konventat e Gjenevës. Ndërkohë që, një procesverbal

1 i asaj kohe nuk përmend fare diskutime të kësaj natyre apo
2 Konventat e Gjenevës.

3 Vijojmë me diapozitivin e radhës që është diapozitivi
4 209.

5 Roli i z. Thaçi si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme.
6 Diapozitivi 210.

7 Për procesverbal dëshiroj të them që nuk ka pretendim nga
8 ZPS-ja në dosjen e vet që ka prova të Rexhep Selimit që i ka
9 raportuar Hashim Thaçit apo që ka marrë urdhra prej z. Hashim
10 Thaçi si ministër i rendit publik si dhe nuk ka pretendime që
11 Selimi si ministër ka qenë vartës i Thaçit gjatë periudhës së
12 Qeverisë së Përkohshme apo në ndonjë periudhë tjetër.

13 Në Diapozitivin 211, ZPS-ja pretendon që në paragrafin
14 298 Thaçi ka emëruar Selimin. Megjithatë, citimet që jep ZPS-
15 ja në poshtëshënimin 1230 nuk demonstrojnë shprehimisht që
16 Thaçi personalisht e ka emëruar atë.

17 Diapozitivi 212.

18 Ndërkohë që ZPS-ja nuk jep asnjë provë të asnjë takimi të
19 Qeverisë së Përkohshme në verën e vitit 1999.

20 Dhe, në fund, Diapozitivi 214.

21 ZPS-ja nuk bën asnjë pohim që Hashim Thaçi ka qenë
22 aktualisht komandant. Nuk ka asnjë provë të urdhrave të dhëna
23 prej tij apo raportime të bëra prej tij, nuk ka prova të asnjë
24 raporti që ai i ka dhënë asnjë linje policie, qoftë ajo
25 ministri e rendit publik ose ushtri dhe nuk ka asnjë provë të

1 mundshme që tregon që ai ka dhënë urdhra për ndonjërin prej
2 këtyre institucioneve.

3 Të nderuar Gjykatës, tani dëshiroj që t'i jap fjalën znj.
4 Tavakoli, ndërkohë që unë do të vazhdoj me pjesën tjetër të
5 prezantimit tim gjatë pasdites.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Tavakoli
7 kurdo që të jeni gati mund të filloni.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

9 Sipas Prokurorisë, Qeveria e Përkohshme e ka qenë "një
10 prej strukturave dhe mekanizmave të kompetencës të krijuara të
11 zbatuara dhe/ose të kontrolluara nga të akuzuarit për të
12 avancuar qëllimin e përbashkët kriminal". Sipas Prokurorisë
13 ajo ishte "një mjet për të ekzekutuar dhe për të realizuar
14 planin e tyre të përbashkët kriminal".

15 Ekzistojnë tre faktorë që krijojnë dyshim të arsyeshëm që
16 kjo nuk ka qenë asnjëherë qëllimi i tyre, këto faktorë janë:
17 përbërja shumë politike, mbështetja e ndërkombëtarëve, si dhe
18 realiteti që ai nuk mund të ishte asnjëherë një mekanizëm
19 pushteti në një vend të tillë.

20 Tani dua të them atë që çfarë u tha dhe më herët gjatë
21 prezantimit të ditës së sotme, që Qeveria e Përkohshme e
22 Kosovës ishte një qeveri shumë partiake dhe që prej fillimit
23 ishte e krijuar si e tillë.

24 Sikurse parashtrohet në paragrafin 25 të dosjes sonë,
25 krijimi i saj është mbështetur prej Shteteve të Bashkuara,

1 Mbretërisë së Madhe, si dhe shtete të tjera evropiane si
2 mënyrë për të unifikuar shqiptarët e Kosovës.

3 Kjo mbështetje ndërkombëtare në vetvete ngre dyshim të
4 arsyeshëm që ajo është krijuar si një shtysë për të ekzekutuar
5 një plan të përbashkët kriminal për të akuzuarit për të marrë
6 kontroll mbi Kosovën, në përjashtim të rastit kur, sigurisht,
7 që ZPS-ja mbase mund të pretendojë që Shtetet e Bashkuara,
8 Mbretëria e Bashkuar dhe Evropa ishin mbështetëse të një plani
9 të tillë kriminal, ose thotë ZPS-ja që po bëhet fjalë për një
10 dështim masiv të diplomatëve evropian dhe shërbimeve të
11 inteligjencës evropiane të cilët nuk e kuptuan kurrë,
12 asnjëherë që ky ishte qëllimi i vërtetë?

13 Si është e mundur që klienti ynë që në atë kohë ishte 29
14 vjeç vetëm t'i ketë gënjyer të gjithë ata?

15 Tani le të kalojmë në dosjen tonë në paragrafët 564, 566,
16 sipas kësaj Qeveria e Përkohshme gjithmonë ka qenë një prej
17 përpjekjeve aspiruese dhe e ashtuquajtura qeveri nuk mund të
18 drejtonte një vend që nuk ekzistonte. Në Rezolutën e Kombeve
19 të Bashkuara 1244, sikurse e dimë, pra, kjo rezolutë ka
20 vendosur të ardhmen e Kosovës nën UNMIK-un, gjë e cila ka
21 çimentuar fatin e Kosovës që prej asaj kohe.

22 Tani le t'i kthehem veprimeve konkrete të Hashim Thaçit
23 që, sipas ZPS-së, Hashim Thaçi ka dhënë një kontribut
24 domethënës sa i takon NKP-së, së pari duke u bërë
25 kryeministër, së dyti, në këtë rol të tij duke bërë emërim

1 politike dhe duke miratuar ligje, së treti, duke kontestuar
2 autoritetin e UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244 duke vendosur
3 epërsinë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe, së fundi,
4 duke qenë i informuar për krimet e kryera në verën e vitit
5 1999 por duke mos i parandaluar apo ndëshkuar krimet e bëra.

6 Thaçi ka mbajtur pozicionin e kryeministrit, por çfarë
7 kompetencë reale kishte ai në atë pozicion në mënyrë të tillë
8 që të realizonte një plan të përbashkët për të pasur kontroll
9 mbi Kosovën në një situatë kur komuniteti ndërkombëtar as nuk
10 e njihte fare një pozicion të tillë? Ai nuk mund t'i dërgonte
11 as edhe një letër UNMIK-ut në atë rol që kishte si
12 kryeministër sepse këto letra ata ia kanë kthyer mbi bazën e
13 një politike zyrtare. Dhe këtë mund ta gjeni më konkretisht në
14 provën 1D00361.

15 Ai nuk mund të nënshkruante asnjë angazhim domethënës
16 detyrues për kosovarët në rolin e tij si kryeministër. Siç ka
17 dëshmuar John Duncan këtë përpara jush, ai nuk mund ta
18 nënshkruante marrëveshjen për demilitarizimin e UÇK-së duke
19 përdorur titullin e kryeministrit pasi fuqitë e aleancës nuk
20 do e pranonin këtë sepse ato nuk ishin të gatshëm që ta
21 njihnin Kosovën dhe nuk sigurisht që nuk ishin të gatshëm që
22 të pranonin Hashim Thaçin si udhëheqës të Kosovës.

23 Në realitet, ky ishte thjesht një titull, një ofiq për
24 një shtet që nuk ekzistonte fare, nuk ishte një shtysë përmes
25 të cilës NKP-ja mund të zbatohet.

1 ZPS-ja pretendon se në rolin e vet si kryeministër,
2 Hashim Thaçi ka miratuar legjislacion si dhe ka bërë emërime
3 politike të cilat ishin një kontribut domethënës për qëllimin
4 e përbashkët kriminal. Megjithatë, ZPS-ja nuk ka vërtetuar
5 përtej dyshimit të arsyeshëm që ai personalisht ka nxjerrë
6 ligjet dhe dekretet e Qeverisë së Përkohshme që kishin të
7 bënin me aspekte të qeverisjes civile.

8 Në paragrafin 44 të dosjes sonë -- jo, në fakt, në
9 paragrafin 44 të dosjes së ZPS-së, ZPS-ja i referohet
10 dokumenteve shtesë përveç atyre të cilat ne i kemi trajtuar në
11 dosjen paraprake dhe që i kemi elaboruar më tej në paragrafët
12 213, 229 të dosjes sonë për të mbështetur këtë pretendim. Këto
13 "dokumente të reja" nuk i çojnë ata, e çojnë Prokurorinë
14 asgjëkund.

15 Asnjë prej dekretëve apo dokumentëve të tjera të lidhura
16 të Qeverisë së Përkohshme nuk është nënshkruar nga Hashim
17 Thaçi. Dhe në këto dokumente as nuk përmendet fare ai. Asnjë
18 prej raporteve nga organizatat ndërkombëtare që lidhen me
19 Qeverinë e Përkohshme dhe që kanë të bëjnë me vendosjen e
20 taksave dhe tatimeve nuk e përmendin Hashim Thaçi dhe nuk kanë
21 asnjë përfshirje të tij. Dhe asnjë prej raporteve të
22 aktivitetit të qeverisë në nivel rajonal nuk e përmend Hashim
23 Thaçin dhe veprimet e vetë Qeverisë së Përkohshme.

24 Por, të nderuar Gjykatës, edhe në qoftë se Prokuroria do
25 ishte bindur që Thaçi do kishte miratuar legjislacion, ku do

1 të dalë Prokuroria me këtë gjë? Se asnjë prej legjislacionit
2 nuk është penal dhe nuk ka asnjë provë përtej dyshimit të
3 arsyeshëm që ky legjislacion ka hyrë në fuqi.

4 Fakti që Thaçi mund t'i ketë thënë gazetarëve në fund të
5 qershorit të 1999-s se Qeveria e Përkohshme kishte arritur një
6 shpërndarje horizontale dhe vertikale të qeverisë në të gjitha
7 komunat, në vetvete nuk e bën atë të vërtetë. Dhe, në fakt,
8 vetë kjo Gjykatë ka dëgjuar dëshmi të dëshmitarëve
9 ndërkombëtarë të besueshëm që kanë qenë në terren në atë kohë
10 e që kanë thënë që Qeveria e Përkohshme asnjëherë nuk ka qenë
11 një qeveri tërësisht funksionale, kështu që çdo përpjekje e
12 pretenduar për ta bërë këtë qeveri të tillë nuk mbeten fare
13 reale dhe janë thjesht aspirata.

14 Tani do të kaloj tek pjesa e emërimeve. Nuk do futem në
15 hollësi pasi z. Misetic e përmendi këtë. Megjithatë, për sa i
16 takon masës që kemi pretendime për emërime të reja - përfshirë
17 këtu Jakup Krasniqin dhe të tjerët - dëshiroj të them që neve
18 mbështetemi në të njëjtën bazë provash për ta rrëzuar këtë
19 pretendim. Që emërimet e përfshira dhe të bëra sipas provës
20 P00813, sipas paragrafit 208 deri në 209, janë të pabazuara.
21 Gjithashtu do ju referonim që të shikoni provën 1D00070,
22 paragrafi 210. Si dhe deklaratën e paverifikuar të
23 bashkëtkëakuzuarve në paragrafin 119.

24 Në çdo rast, pavarësisht konstatimeve që do të bëni ju,
25 të nderuar Gjykatës, sa i takon emërimeve në fjalë, Prokuroria

1 nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm, domethënë, me
2 fjalë të tjera nuk ka dëshmuar që ka pasur raportime ose
3 urdhra të dhëna nga Thaçi për personat e emëruar ose nga e
4 kundërta.

5 Pretendimi i ZPS-së që Thaçi ka emëruar kryetarët e
6 komunave është po ashtu i pabazuar. Nuk ka fare prova,
7 thjesht, bëhet fjalë për fjalë që qarkullonin të individëve që
8 thonin që ishin të emëruar prej Thaçit.

9 Megjithatë, të nderuar Gjykatës, edhe në qoftë se
10 argumenti i ZPS-së ju duket bindës ju, nuk di se ku do të dalë
11 ZPS-ja me këtë? Sepse këto emërime në vetvete nuk është se
12 ishin vepra ose aspekte kriminale.

13 Pavarësisht kësaj, deri në masën që ekzistonte një
14 përpjekje nga Qeveria e Përkohshme për të krijuar një soj
15 qeverie qoftë kjo përmes hartimit ose miratimit të
16 legjislacionit apo qoftë kjo përmes emërimit të politikanëve
17 kombëtar lokalë ose kombëtar, gjithsesi kjo është një mundësi
18 e arsyeshme për të krijuar një lloj administrate civile pas
19 kolapsit të tërë të shërbimeve bazike kur u larguan serbët dhe
20 nuk është fare asnjë lloj përpjekje për të pasur kontroll mbi
21 vendin.

22 Fakt është që kjo Gjykatë ka dëgjuar dëshmi të
23 gjerësishme nga ndërkombëtarët, disa prej të cilëve unë do t'i
24 përmend në këtë diapozitiv, përfshirë John Duncan, Dëshmitarin
25 W02135, W012161 dhe kur lufta përfundoi dhe popullata serbe u

1 largua kryesisht nga Kosova, strukturat qeveritare u kolapsuan
2 tërësisht sepse ato kryesisht predominoheshin prej serbëve.

3 Në këtë realitet, është mundësia e arsyeshme që
4 shqiptarët e Kosovës, përfshirë këtu dhe ata që ishin pjesë e
5 Qeverisë së Përkohshme dhe UÇK-së të përpigeshin që shoqëria
6 të fillonte të punonte sërish. Ajo çfarë ka ndodhur është që
7 Dëshmitari W02161 dëshmoi dhe tha që UÇK-ja u mundua që të
8 gjente shqiptarë që të ushtronin shërbimet bazë, shërbimet e
9 energjisë elektrike, të ujësjellës-kanalizimeve, shërbime të
10 tjera bazike pasi pas kohës së largimit të serbëve nuk mbeti
11 asgjë që funksiononte.

12 Tani më lejoni që t'i kthehem pretendimeve që Hashim
13 Thaçi ka kontestuar autoritetin e UNMIK-ut.

14 Ne nuk e mohojmë ashtu siç tha Covey, se në ditët e para
15 të misionit të UNMIK-ut, Hashim Thaçi garoi për ndikim me
16 UNMIK-un dhe u mundua që të krijonte një rol për Qeverinë e
17 Përkohshme sa i takon qeverisjes së Kosovës. Por, në fund, ai
18 iu drejtua bashkëpunimit me UNMIK-un.

19 Është e rëndësishme gjithashtu që të kujtohet që të
20 paktën ka pasur "tre qeveri" në Kosovë në atë kohë. Ishte
21 Qeveria e Përkohshme e Kosovës, qeveria e Bukshit dhe ishte
22 zyra e qeverisë serbe ose jugosllave në Prishtinë. Asnjëra
23 prej këtyre qeverive nuk ishte ligjore në përputhje me
24 rezolutën 1244, por ZPS-ja nuk pretendon që dy qeveritë e
25 tjera ishin mjet i NKP-së. Por thonë që LDK-ja ishte thjesht

1 viktimë e NKP-së së Qeverisë së Përkohshme.

2 Në bazë të Rezolutës 1244, UNMIK-u e ka drejtuar Kosovën,
3 kështu që çdo përpjekje nga Thaçi për të marrë, për të fituar
4 kontroll dhe kompetencë donte të thoshte që ai këtë kompetencë
5 duhej t'ia merrte UNMIK-ut i cili e kishte marrë këtë
6 kompetencë, këtë autoritet prej Këshillit të Sigurimit të
7 Kombeve të Bashkuara. Dëshmia e diplomatit veteran amerikan,
8 John Covey, që ka qenë zëvendësdrejtues i UNMIK-ut e ka thënë
9 qartë se ky nuk ka qenë asnjëherë synimi i Hashim Thaçit dhe
10 vetëm kjo ngre dyshimin e arsyeshëm që marrja e kontrollit nuk
11 ka qenë fare synim i tij edhe pse vitet e para të
12 administratës së vet ai ka konkurruar me UNMIK-un për
13 autoritet.

14 Në fakt, ashtu siç dëshmohet edhe përmes këtij
15 diapozitivi, Covey dha dëshmi që ai së bashku me Bernhard
16 Kouchner kur janë vendosur kishin dekada përvojë në këtë
17 fushë, dhe sigurisht që ata e prisnin që të kishte një lloj
18 kontestimi, një lloj kundërshtimi fillestar të UNMIK-ut për të
19 parë se kush ishte në gjendje që të bënte administrimin e
20 vendit.

21 Dhe në këtë aspekt, Thaçi i përmbushi pritshmëritë e
22 tyre. Dhe sipas fjalëve të Covey, ai fillimisht u përpoq që të
23 legjitimizonte pretendimet e qeverisë së Kosovës për
24 administrimin e Kosovës në kundërshtim të plotë me mandatin e
25 Rezolutës së Këshillit të Sigurimit përpara sesa të kuptonte

1 që interesat e tij shërbeheshin më mirë në qoftë se do të
2 bashkëpunonte me UNMIK-un.

3 Në të vërtetë, Hashim Thaçi në fund njohu dhe respektoi
4 autoritetin e UNMIK-ut, gjë e cila është konfirmuar edhe nga
5 vetë Bernard Kouchner në një kabllogram që mban datën 16
6 nëntor 1999, të cilën mund ta shikoni në diapozitivin që keni
7 përpara. Ai deklaroi të gjithë udhëheqësit, përfshirë këtu dhe
8 Thaçin, e pranuan "rolin tim të posaçëm, pra, si autoritet
9 legjislativ dhe si vendimmarrës fundor".

10 Tani le të kthehemi tek ditët e para, ditët e hershme të
11 mandatit të UNMIK-ut, Covey nuk ishte i befasuar nga mënyra se
12 si Thaçi fillimisht konkurroi me mandatin e UNMIK-ut dhe e
13 thotë me fjalët e veta, të cilat mund t'i lexoni në këtë
14 diapozitiv, që ata po merreshin me "dikë që kishte një moshë
15 shumë të re, ishte shumë i ri dhe i cili po përpigjej që të
16 ndërtonte, po përpigjej që të kapte mundësinë që ai mendonte që
17 e kishte përpara vetes. Pse do befasohej ai që kjo ishte
18 mënyra se si ai u soll fillimisht". Bëhej fjalë thjesht për
19 një person që ishte shumë i ri, që ishte shumë ambicioz dhe që
20 po përpigjej që të gjente rolin e vet.

21 Të nderuar Gjykatës, sikurse e dini, kjo është ajo çfarë
22 bëjnë politikanët. Politikanët mundohen që të kenë posturën
23 dhe pozicionin dhe që të bindin audiencat ose zgjedhësit e
24 tyre për përfitime të tyre politike aktuale ose të ardhme.

25 Prokuroria e ka shumë të vështirë që të provojë përpara

1 jush përtej dyshimit të arsyeshëm se kur Thaçi është
2 pozicionuar në një formë të caktuar dhe kur ka qenë real dhe i
3 vërtetë?

4 Një shpjegim i arsyeshëm i sjelljes së Thaçit sa i takon
5 UNMIK-ut ishte që ai po mundohej që të ndërtonte një bazë
6 pushteti për një jetë të tërë në politikë, sepse, sipas
7 fjalëve të Covey, që jepen në transkript 251001, "ai e dinte
8 që këto kompetenca ai nuk i kishte" në atë kohë.

9 Besoj që ju kujtohet, të nderuar Gjykatës, në qoftë se do
10 shihni provën materiale 1D00216 që vera e 1999-s vijoi me
11 krijimin e partisë politike të tij më datën 10 tetor 1999.
12 Megjithatë, erdhi një kohë, ashtu siç është dëshmuar dhe prej
13 Durkee dhe Covey, që Thaçi e kuptoi që ambiciet e veta
14 përmbusheshin më mirë po të bashkëpunonte me UNMIK-un, gjë të
15 cilën ai e bëri fakt. Për procesverbal mund t'i referoheni
16 transkriptit në faqen 251002, faqja 27594, 1D000390,
17 paragrafët 69 deri në 71 dhe më pas 1D00428, paragrafi 19,
18 transkripti 25113, faqja 28024.

19 Në deklaratën e vet, z. Covey thotë, z. Thaçi luajti një
20 rol shumë konstruktiv për të avancuar qëllimet paqeruajtëse
21 edhe paqevendosëse të UNMIK-ut, duke pranuar se Qeveria e
22 Përkohshme e Kosovës, ku ai ishte kryeministër, ishte bërë jo
23 e rëndësishme pa mbërritjes së UNMIK-ut duke pranuar role të
24 duhura brenda strukturave të përbashkëta të administrimit,
25 duke ndarë kompetencat, si dhe duke njohur figurat të cilat ai

1 më parë kishte denoncuar dhe duke pranuar problemet e partisë
2 së vet në nivelet dhe gjithashtu duke njohur dhe humbjet e
3 partisë së vet, pra, në zgjedhjet e komunave dhe zgjedhjet
4 lokale.

5 Të nderuar Gjykatës, si është e mundur që një person, një
6 burrë i cili pajtohet që të demilitarizojë UÇK-në, që punon në
7 mënyrë konstruktive me UNMIK-un mbas luftës, dhe i cili më pas
8 në tetor të 2000-s dhe në nëntor të 2001-shit pranoi humbjet
9 në zgjedhjet demokratike dhe vazhdoi që të punonte fort derisa
10 i fitoi zgjedhjet në vitin 2007, kështu që si mundet që një
11 person i tillë të duket një person që po mendohej që të kishte
12 kontroll dhe të fitonte kontroll mbi Kosovën?

13 Ne themi që ky nuk është rasti.

14 Dhe mendojmë që ZPS-ja nuk është bindëse në atë çfarë
15 thotë dhe nuk ka pikë dëshmie dhe prove për argumentet e veta.

16 Mendojmë që ky është një moment i përshtatshëm për të
17 bërë pushimin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Do bëjmë pushimin deri në orën 2.30.

20 Tani do bëjmë pushimin.

21 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.58

22 --- Seanca rifillon në orën 14.30

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

24 Tavakoli, fjala është ende për ju.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

1 Tani do të flas për argumentin e fundit të Prokurorisë,
2 që Hashim Thaçi e ka bërë të qartë synimin e tij dhe ka dhënë
3 kontribut të konsiderueshëm për planin e përbashkët në verën e
4 1999 duke mos parandaluar apo mosndëshkuar krimet. Unë nuk do
5 të përsëris atë çka është thënë në dosjen tonë, por duhet të
6 theksoj se ZPS-ja nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të
7 arsyeshëm se Thaçi ka pasur dijeni për krimet në verën e '99-s
8 dhe ka ditur vetëm diçka në vija të përgjithshme. Për këtë
9 jemi përgjigjur në dosjen tonë 288, 289, 294 deri në 296 dhe
10 në paragrafin 607. Ose që Thaçi ka pasur kontroll efektiv mbi
11 kryesit e pretenduar saqë ai mund t'i parandalonte apo të
12 ndëshkonte këto krime. Ju lutem, shikoni dosjen tonë,
13 paragrafët 456, 595, Seksionin V(C) (3).

14 Të martën, Prokuroria theksoi një takim të 27 korrikut
15 1999 ku Hashim Thaçi u përshkrua si person që nuk iu përgjigj
16 çështjes apo aspektit të kriminalitetit, këtu bëhet fjalë për
17 çështjet e krimeve të policisë ushtarake që pretendohen se
18 kanë ndodhur. Siç kemi thënë në paragrafin 45 të dosjes sonë,
19 Covey, që ka marrë pjesë në këtë takim, i përshkroi përgjigjet
20 e "vagullta" të Thaçit si në përputhje me botëkuptimin që
21 kishte ai për "ai ka pasur një influencë shumë të vogël por
22 nuk ka dashur ta shprehë këtë".

23 Një pjesëmarrës tjetër, 02183, po ashtu ka qenë
24 pjesëmarrës në këtë takim, dhe kur diskutoheshin këto
25 përgjigjet evazive të Thaçit si përpjekje për të minimizuar

1 përgjegjësinë, nuk arrinte të konfirmonte nëse Thaçi apo Çeku
2 kishin kontroll të drejtpërdrejtë mbi policinë apo brigadën
3 Atlantike.

4 Sidoqoftë, pas Rezolutës 1244 UNMIK-u ka qenë i vetmi
5 organ që mund të ndëshkonte krimet. Nuk mundej Hashim Thaçi të
6 ndëshkonte krimet.

7 Tani të flasim se çfarë mund të bënte Hashim Thaçi. Ai
8 mund të fliste. Dhe ai ka folur. Siç e kemi diskutuar në
9 dosjen tonë përfundimtare në paragrafët 409, 417, transkriptet
10 gjyqësore janë të mbushura plot me prova ku Thaçi ka folur
11 kundër dhunës, ka kërkuar për qëndrueshmëri në Kosovë që dhe
12 serbët e Kosovës të qëndronin, por gjithashtu ka marrë masa
13 konkrete; për shembull, ka shoqëruar SRSG-në për të përdorur
14 influncën e tij që të qetësonte shqiptarët e Kosovës që
15 protestonin në Mitrovicë dhe ka vizituar viktimat serbe bashkë
16 me Kouchner. Për këtë ka dhënë dëshmi edhe Covey, mund ta
17 shikoni këtë në transkriptin përkatës 25100, 227166. Covey ka
18 qenë i qartë kur i bëri pyetje Gjykatësi Barthe, në faqen
19 27610 që nuk ishte sinjalizim sepse ky kishte një rrezik të
20 madh personal dhe politik sepse Thaçi po ekspozohej me këto që
21 po bënte.

22 Sipas nesh këto deklarata dhe veprimet e Thaçit, të cilat
23 Gjenerali Clark i konsideroi të singerta, shtojnë më tej
24 dyshimet nëse ai vërtetë kishte synimin të merrte kontrollin
25 në Kosovë duke kryer krime. ZPS-ja argumenton të kundërtën. Në

1 dosjen e tyre përfundimtare ata thonë që këto deklaratat në
2 verën e 1999-s nuk mund të thonë që s'ka pasur synim Thaçi
3 sepse synimin që të realizonin qëllimet e tij personale të
4 cilat ishin bërë njëkohësisht dhe ishin në kundërshtim me ato
5 që ju kishte thënë ndërkombëtarëve. Pra, e thënë ndryshe,
6 vazhdonin kryerja e krimeve përkundër asaj që ju thuheshin
7 ndërkombëtarëve.

8 Sigurisht që deklaratat i realizuan qëllimet e Hashim
9 Thaçit sepse interesi i tij ishte pikërisht bashkëpunimi me
10 komunitetin ndërkombëtar. Po, kjo është. Po, ndonjëherë ka
11 bërë deklaratat kur i është kërkuar që t'i bëjë këto deklaratat
12 prej ndërkombëtarëve. Por në çdo deklaratë që ka bërë, e ka
13 vendosur në një rrezik të jashtëzakonshëm personal, por ai
14 sidoqoftë i bëri këto deklaratat.

15 Fakti që ka pasur krime dhe më pas, pavarësisht
16 deklaratave të Thaçit nuk e mohojnë synimin e tij siç
17 pretendohet. Në fakt, Prokuroria sipas nesh është bazuar
18 kryesisht në provat e Dëshmitarit 02183, i cili asokohe ka
19 qenë një ndërkombëtar i ri në detyrën e tij, dhe ishte detyra
20 e dytë në sferën ndërkombëtare, i cili nuk e kuptonte pse,
21 pavarësisht, pra, duke pasur parasysh pozicionin e Hashim
22 Thaçit si kryeministër ai s'e kuptonte se pse pavarësisht
23 deklaratave dhuna nuk ndaloi, edhe ai doli në përfundimin se
24 dhuna nuk ndaloi se me siguri Thaçi e ka orkestruar këtë
25 dhunë.

1 Pra, ne gjykojmë që duhet të merrni parasysh deklaratën e
2 Jock Covey, që tha që shumë nga UNMIK-u pretendonin që Thaçi
3 kishte pushtet, dhe sipas nesh një nga këta individë ishte
4 pikërisht dëshmitari që sapo përmenda, 02183. Deklaratën e
5 Covey mund ta shikoni në paragrafin 72.

6 "Instinktet e z. Thaçi mund të ketë qenë të dobishme nga
7 pikëpamja politike përpara audiencave kosovare, por ama u
8 keqkuptuan fatkeqësisht nga disa persona në komunitetin e të
9 drejtave të njeriut, përfshirë specialistë të të drejtave të
10 njeriut të UNMIK-ut të cilët në mënyrë të padrejtë dolën në
11 përfundimin se Thaçi, në fakt, kishte pushtetin për të
12 kontrolluar dhunën që kryhej nga elementë të cilët ishin
13 tërësisht të decentralizuar, por tani ishin ish-ushtarë të
14 UÇK-së. Për të gjithë ne në terren ishte e qartë se ambicia e
15 z. Thaçi ishte shumë më tepër se influenza që kishte ai
16 konkretisht ndaj UÇK-së."

17 Në fakt, kur bëmë pyetje, Dëshmitari 02183 ai e pranoi se
18 nuk e dinte strukturën e komandës dhe të kontrollit të UÇK-së
19 dhe nuk ishte personi i duhur për të dhënë opinione për
20 aspekte ushtarake. Këtë mund ta shikoni në transkript në faqen
21 23889, 23890 e në vijim.

22 Ne mendojmë që pse vazhdoi dhuna në verën e 1999-s,
23 pavarësisht thirrjes së z. Thaçi për tolerancë, ishte
24 pikërisht se z. Thaçi nuk e kishte pushtetin ndaj këtyre
25 kryesve. Tani, a ka ndodhur kjo se po kryheshin krimet nga ish

1 apo ushtarë të UÇK-së, grupet e organizuara kriminale apo
2 refugjatët që po ktheheshin në vendin e tyre, këto nuk mund
3 t'i diskutojmë dhe ZPS-ja nuk mund të thotë që z. Thaçi kishte
4 kontroll ndaj tyre. Siç e diskutuam në paragrafët 34, 416,
5 586, 636 dhe 654 në dosjen tone, kjo ka qenë dhe pikëpamja e
6 NATO-s dhe e shteteve anëtare të NATO-s sikurse u shpreh nga
7 Gjenerali Clark, Duncan dhe Michael Durkee.

8 Individualisht apo bashkërisht, provat e tyre hedhin
9 dyshime dhe nuk mund të thonë që z. Thaçi mund t'i
10 parandalonte apo ndëshkonte krimet në verën e 1999-s kishte
11 apo nuk kishte dijeni ai në lidhje me to.

12 Prandaj, për këto arsye, ZPS-ja nuk ka vërtetuar përtej
13 dyshimit të arsyeshëm se Thaçi e ka përdorur Qeverinë e
14 Përkohshme që të realizonte planin e përbashkët kriminal të
15 pretenduar.

16 Tani do ja jap fjalën Ambasadorit Prosper.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
18 znj. Tavakoli.

19 Z. Prosper, fjala është për ju.

20 Z. PROSPER: [Përkthim] Mirëdita, të gjithëve.

21 Unë do të flas shkurt sepse nuk kemi dhe shumë kohë,
22 sepse do të flasë sërish kryembrojtësi. Por unë dua të flas
23 për dëshmitarët e Mbrojtjes, ndërkombëtarët dhe sulmet që kanë
24 ndodhur gjatë apo akuzat që janë hedhur ndaj tyre gjatë kësaj
25 seance. Do të flas në vija të përgjithshme.

1 Dje komunikova me një shokun tim, një diplomat i lartë që
2 ka qenë shumë herë ambasador, një i dërguar i posaçëm dhe i
3 lexova disa nga citimet e së hënës nga Zyra e Prokurorit të
4 Specializuar, veçanërisht për faktin që:

5 "Trupi Gjykses ... ka dëgjuar dëshmi nga shtatë
6 dëshmitarë të Mbrojtjes, të gjithë ndërkombëtarë. Të gjithë u
7 përpoqën me çiltërsi që të sillnin pagën në Kosovë ... Por
8 përfshirja e tyre në këtë çështje gjyqësore dhe observimet e
9 tyre të kufizuara a janë apo s'janë të vlefshme për Trupin
10 Gjykses kjo është një çështje më vete. Shtatë dëshmitarët
11 ndërkombëtarë u sollën këtu në një situatë të vështirë sepse
12 kishin shumë pak njohuri lidhur me aktorët e përfshirë, gjuhën
13 nuk e flisnin, kanë komunikuar vetëm disa herë me aktorët
14 kryesorë, nuk kanë lexuar ndonjëherë rregullore të UÇK-së,
15 urdhëresa të UÇK-së, apo komunikata të UÇK-së dhe nuk e
16 njihnin ... strukturën e UÇK-së."

17 Dhe vazhdon më tej prokuroria dhe thotë që "kishin
18 informacione shumë të kufizuara".

19 Kolegu im më tha, "E tmerrshme, kaq pak e respektojnë
20 profesionin tonë?".

21 Të nderuar zotërinj, duhet ta shikojmë ndryshe këtë
22 çështje sepse këto komente tregojnë arrogancë, mungesë
23 respekti, i cili, në fakt, ka qenë i pranishëm në këtë gjykim
24 qysh prej fillimit. Të rrëzosh menjëherë përvojat, dëshmitë e
25 këtyre profesionistëve me përvojë të cilët e kanë pasur për

1 detyrë të shkonin, të analizonin, të vlerësonin situatat, të
2 shikonin ngjarjet në mënyrë që të ruanin sigurinë
3 ndërkombëtare është e pabesueshme. Është e gabuar edhe, në
4 fakt, për mua është një gjest dëshpërimi.

5 Nuk është për t'u habitur që qeveritë dyshojnë tashmë në
6 besueshmërinë e tribunaleve ndërkombëtare. Se kur vetë
7 profesionistët e tyre dalin para Trupit Gjykues tregojnë çfarë
8 ka ndodhur edhe deklaratat e tyre hidhen poshtë nga persona që
9 as nuk kanë qenë të pranishëm në vendin përkatës, kjo është
10 një çështje shumë problematike.

11 Duhet të kemi parasysh se këto institucione, këto
12 tribunale janë një mjet, një instrument i sistemit të rendit
13 ndërkombëtar se personat që kanë qenë përpara jush janë pjesë
14 e këtij sistemi, janë persona që vendosin, në fakt, nëse duhet
15 të ketë tribunale dhe nëse duhet të ketë drejtësi. Nuk mund të
16 themi, po ata nuk e dinë ç'po flasin. Ju ishit atje, ju keni
17 qenë atje por ju nuk e dini. Sepse ne do t'i interpretojmë
18 gjërat ndryshe. Mos u besoni më syve, mos u besoni më veshëve.
19 Dimë ne më shumë se ju.

20 Është e rëndësishme që t'i kujtojmë vetes rëndësinë e
21 këtyre dëshmitarëve. Mund të mos ju pëlqejnë, as nuk ka pse
22 t'ju pëlqejnë. Mund të mos i respektoni dëshmitarët
23 ndërkombëtarë si individë dhe as nuk keni pse ta bëni këtë.
24 Por, duhet të respektoni rolin që kanë pasur, profesionet e
25 tyre, dhe shtetet që përfaqësojnë, qeverinë e Shteteve të

1 Bashkuara, britaniken, NATO-n edhe kombet e bashkuara. Këta
2 persona nuk erdhën këtu në cilësinë e personave privatë për të
3 thënë, "Po kështu e mendoj unë diçka". Folën me ju, folën për
4 ju në emër apo bazuar në përvojat e tyre dhe veçanërisht në
5 emër të institucioneve që përfaqësonin. Përndryshe pse duhet
6 të merrnim autorizim për këta persona që të flinin? Sepse
7 informacioni që kanë këta persona i përket institucioneve
8 përkatëse.

9 Pra, kur ju dhanë këndvështrimet e tyre, ishin të matura,
10 këndvështrimet e tyre ishin produkt i bashkëpunimit. Kishin
11 informacion të organizatave ushtarake, civile, nga komuniteti
12 i shërbimit informativ, raporte nga OJQ-të, debate të
13 brendshme, konstatime personale në terren, nga raportimet që
14 merrnin prej terrenit, pra kishin këndvështrime tërësisht të
15 bazuara.

16 Jamie Rubin, ka punuar për Senatorin Biden, këshilltar i
17 Sekretares së Shtetit. Në fakt, ai e ka pasur për detyrë për
18 shkak se ka qenë në çdo takim me Sekretaren e Shtetit. Ai
19 ishte personi që u caktua të shkonte dhe të zbulonte kush
20 ishte Hashim Thaçi. I thanë shko, kalo kohë me të. Dhe nëse ju
21 kujtohet nga dëshmia e tij ai në Rambuje sa herë që i jepej
22 rasti shkonte pinte një cigare me z. Thaçi, ishte i pranishëm
23 me të në sallë. Ai pati mundësinë të bënte vëzhgimet përkatëse
24 dhe ju dha mendimet e veta.

25 Profesori Paul Williams, një profesor i nderuar në një

1 universitet amerikan. Tani ky është shumë interesant sepse
2 këtu ishte një person i cili ka ndihmuar shtetet e dobëta, të
3 brishta dhe qeveritë që të gjenin pagën, të ndërtonin
4 shoqëritë demokratike dhe këtë e ka bërë falas, *pro bono*. Ka
5 qenë i pranishëm atje. Ka qenë në sallë. I ka dëgjuar bisedat
6 me veshët e tij. Ka parë komunikimet mes këtyre personave dhe
7 erdhi këtu vullnetarisht sikurse të tjerët t'ju jepte
8 këndvështrimin e tij. Nuk mund të hidhet poshtë mendimi i tij.

9 John Duncan, Ambasadori John Duncan, Mike Durkee,
10 diplomat i lartë, diplomat karriere me shumë, shumë përvojë.
11 Durkee, veteran ushtarak. Pra, këta persona ishin pjesë e
12 NATO-s që përfaqësonin vendet e tyre dhe kanë qenë këshilltarë
13 politikë. I kanë studiuar me imtësi këtë çështje ditë pas
14 dite.

15 Jock Covey, i caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm,
16 këshilltar për çështjet diplomatike, edhe ai erdhi këtu dha
17 këndvështrimet e tyre.

18 Dhe prapë Prokuroria i hedh poshtë përvojën e tyre.

19 E dimë Ambasadorin Hill, e njohim, gjashtë herë ka qenë
20 ambasador. Edhe mund të vazhdoj e të flas për përvojat e tjera
21 që ka pasur Ambasadori Hill, por pjesa më e rëndësishme është
22 fakti që ai ka qenë i Dërguari i Posaçëm për Kosovën, një
23 detyrë ka pasur ai: të zbulonte çfarë roli kishte gjithsecili,
24 çfarë ndodhte në sferën e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Kjo ka
25 qenë detyra e tij, por Prokuroria do që ne të besojmë që ai

1 informacionin e ka të kufizuar. Thjesht u detyrua të vinte
2 këtu. Më vjen keq, e besueshme është kjo? Nëse Presidenti i
3 Shteteve të Bashkuara, grupi i tij, Shtetet e Bashkuara,
4 Mbretëria e Bashkuara, Franca, Italia, Gjermania, Rusia këto
5 shtetet duhet ta dinin kush ishte gjithsecili dhe çfarë bënte
6 gjithsecili. Ju besoni se këta persona u kthyen në shtetet e
7 tyre dhe i thanë, "Znj. Sekretare, informacione sipërfaqësore
8 kam. E di që ju doni të vendosni nëse të filloni luftën apo
9 jo, por ja unë po ju jap përshtypjet e mia sipërfaqësore",
10 sikurse do Prokuroria që ne të besojmë tani.

11 Po Gjenerali Clark, West Point grad, gjeneral me katër
12 yje i nderuar, ka qenë në Dayton, sikurse ka qenë Ambasadori
13 Hill, Gjenerali, komandanti i forcave aleate supreme në
14 Evropë. Erdhi këtu, dha pikëpamjet e tij të bazuara në
15 informacionet që kishte marrë prej informacionit të përpunuar
16 nga takimeve profesionale dhe nga burime të tjera. Ai ju ka
17 thënë që lexoja çdo gjë, dhe kishte dalë në përfundimin që e
18 ndau me ju këtu kur ishte i pranishëm.

19 Këta persona kanë pasur komunikime personale. Këto nuk
20 kanë qenë vetëm një mision i izoluar. Nuk ishin se kishin
21 shkuar për safari në Kosovë.

22 Tani, Prokuroria do që ju të besoni që këta persona
23 thjesht kanë qenë kalimtarë. Edhe në këtë udhëtim bënë disa
24 konstatime sipërfaqësore. Duan të minimizojnë rolin e tyre.
25 Është mungesë respekti. Këto persona i shërbenit vendit të

1 tyre, u shërbenin institucioneve të tyre. Kjo tregon
2 injorancë, nëse më lejoni të shprehem kështu, sa i takon këtij
3 procesi. Këta diplomatë, këta ekspertë, bëhet fjalë për punën
4 e jetës së tyre, të cilët erdhën këtu vullnetarisht të flisnin
5 me ju për t'ju thënë: këto dimë ne, këto kemi parë ne, këto
6 janë përfundimet e mia prej eksperti, dhe të gjitha ne këto do
7 t'i hedhim në plehra?

8 Të nderuar Gjykatës, besoj se duhet t'i kujtojmë vetes se
9 nëpunësit civilë luajnë një rol. Nëpunësit civilë kanë diçka
10 për të ofruar. Ne, si juristë, si avokatë nuk i dimë të
11 gjitha, kështu duhet t'u besojmë personave që kanë qenë atje.

12 Në fakt, mendoj se është po ashtu e rëndësishme ta
13 shikojmë edhe nën lupën historike.

14 Ata kanë punuar në një vit të vështirë, në vitin 1999. Ju
15 lutem, kini pak durim. Vetëm disa vite më përpara ndodhi një
16 ngjarje në Somali, ku komuniteti ndërkombëtar humbi 18 anëtarë
17 të SHBA-së edhe u vranë 11 ndërkombëtarë që ishin të OKB-së.

18 Kjo e tronditi komunitetin paqeruajtës kaq shumë sa që në
19 Ruanda më pak se një vit më pas u tërhoq dhe kishte frikë të
20 përfshihej për shkak të asaj që mund të ndodhte, dhe u vranë 1
21 milionë persona brenda 100 ditësh. Edhe kaq shumë u tronditën
22 sa që forcat holandeze në Srebrenicë panë sesi u vranë 8000
23 burra dhe djem sepse ishin shumë të frikësuar të bënin diçka.

24 E tani pse ndryshoi situata në vitin 1999, dhe komuniteti
25 ndërkombëtar papritmas thotë, "Pa pasur informacionin e duhur

1 do të hapin luftë kundër Serbisë", pa e ditur kush është
2 gjithsecili? Pa e ditur çfarë është UÇK-ja? Janë shokët tanë,
3 janë armiq, mund të punojmë me ta? Cila është organizata e
4 tyre? Kush është përgjegjës? Me cilin do bisedojmë? Sigurisht
5 që këto pyetje i kanë bërë. Duhet t'i bënin.

6 Pra, kur erdhën këta dëshmitarë këtu edhe ndanë
7 informacionin me ju pas 26 vitesh, informacion që sigurisht
8 është po ashtu i bazuar në kujtime. Ju duhet të dini që
9 asokohe informacioni ka qenë real, ka qenë solid, nuk ka qenë
10 informacion sipërfaqësor, dhe nuk ka qenë thjesht përshtypje
11 personale.

12 Z. Halling tha ditën e hënë diçka shumë interesante. Unë
13 do ta perifrazoj atë që tha ai, por në thelb ai tha se
14 ndërkombëtarët - Jamie Rubin, Wesley Clark - u mashtruan prej
15 një 29 vjeçari siç ishte Hashim Thaçi. Vërtetë e besoni ju
16 këtë? Kemi një zotëri këtu që dikur ishte student, ka kaluar
17 kohë në Zvicër dhe ky person u hodh hi syve këtyre personave
18 kaq të nderuar? Sigurisht që jo.

19 Të gjithë këta dëshmitarë erdhën këtu dhe ndanë diçka me
20 ju. Ju thanë nuk ka pasur komandë e kontroll efektiv të UÇK-
21 së. Nuk ka pasur strukturë politike. Hashim Thaçi nuk ka qenë
22 përgjegjës dhe konflikti i armatosur përfundoi në qershor
23 1999. ZPS-ja nuk do që ju të fokusoheni në këtë pjesë. Madje
24 as nuk i thirrën këta dëshmitarë që janë të përmendur në të
25 gjitha provat e mundshme. Vendosën të mos i intervistojnë, as

1 gjitha provat e mundshme. Vendosën të mos i intervistojnë, as
2 të mos i thërrisin.

3 Por Prokuroria vjen këtu sot dhe merret me prova
4 shkresore, përpiqet të shtrembërojë e të ndryshojë faktet duke
5 shpresuar që ju të mos e shikoni që ata nuk i kanë provat e
6 duhura. Ata e kanë barrën e provës dhe duhet t'i kujtojmë
7 vetes se kjo barrë prove është shumë e lartë, përtej dyshimit
8 të arsyeshëm.

9 Ju lutem reflektoni, qoftë kur keni qenë studentë të
10 juridikut, juristë, gjykatës dhe mësuar kriterin e barrës së
11 provës. Se sa e rëndësishme është barra e provës, sa i lartë
12 është pragu për të garantuar që nëse do të mohojmë, do t'i
13 heqim dikujt lirinë, nëse një qeveri do ta bëjë këtë gjë apo
14 një autoritet do ta bëjë këtë duhet të jemi të bindur, të jemi
15 të sigurt.

16 Dëshmitarët ndërkombëtarë thonë që s'ka dyshim të
17 arsyeshëm. I marrim një për një. Jamie Rubin, ka qenë i
18 pranishëm. E ndau përvojën e tij. Foli për Rambujenë, për
19 demilitarizimin. Paul Williams, dhe ai ka qenë atje, edhe ai
20 ju tregoi çfarë kishte parë. John Duncan ka qenë i pranishëm
21 me komandantët e zonave dhe tha që ishin komandantët e zonave
22 ata që drejtonin. Ka qenë i pranishëm. Mike Durkee ka qenë i
23 përfshirë, ka pasur informacion dhe ka qenë në takime me
24 Hashim Thaçin dhe komandantin e Forcave Aleate. Christopher
25 Hill, ka qenë gjatë gjithë kohës. Nuk komentojnë aspekt për

1 dëshminë e tij Prokuroria. Gjenerali Wesley Clark, titulli
2 flet për rëndësinë që ka ky person, dhe ai ju tregoi çfarë
3 kishte parë.

4 Ju mjaft të besoni një prej këtyre dëshmitarëve.
5 Sidoqoftë merrini të tërë bashkë edhe e keni të gjithë
6 panoramën e situatës. Ata konfirmuan njëri-tjetrin dhe ndanë
7 me ju të njëjtën situatë dhe të njëjtën gjë që Hashim Thaçi
8 nuk është fajtor për akuzat që ngrihen ndaj tij.

9 Prokurori doli në përfundimin në fjalën e saj se Gjykata
10 është kthyer në një Gjykatë të rregullt dhe konvencionale. Kam
11 frikë se kjo Gjykatë nuk është një model i asaj që ne duam dhe
12 nuk është pikërisht modeli se si duhet të jenë Gjykatat dhe
13 sundimi i ligjit, sepse për shkak edhe të kësaj Prokurorie,
14 është kthyer në simbolin e asaj që përpiqemi të parandalojmë.

15 Kjo çështje është në duart tua. Ju lutem lexoni
16 dëshmitë e këtyre dëshmitarëve ndërkombëtarë, të personave që
17 kanë punuar gjithë jetën dhe ishin këtu për të ndarë me ju
18 historitë nga bota reale për atë çka ndodhi realisht në vitin
19 1998 dhe 1999. Faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
21 z. Prosper.

22 Z. Misetic, kuptoj që e keni ju fjalën tani -- diçka për
23 të thënë më tej.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, ndoshta keni mall të dëgjohemi
25 akoma, edhe 30 minuta.

1 Do të largohem nga faktet dhe do bëj disa parashtime të
2 shkurtra lidhur me aspektet ligjore dhe të provave në këtë
3 çështje - në provat e ZPS-së.

4 Duke filluar me gjënë e parë, që na goditi dje kur
5 filluam -- kur filluam -- filluam të lexonim dosjen e ZPS-së,
6 përfundimtare, në fillim, pra, kur filluam dhe lexuam, ishte
7 nivel apo shkallë të cilën ZPS-ja mbështeti në provat pa
8 verifikuar.

9 Edhe pse Trupi Gjykses dëgjoi 130 dëshmitarë në sallë të
10 gjyqit në këtë çështje, dosja përfundimtare e ZPS-së dhe
11 parashtimet e tyre përfundimtare mbështeten në pjesën
12 dërrmuese të tyre në materiale, autorët e të cilave, apo
13 autorët e pretenduar të cilëve nuk u thirrën apo nuk u morën
14 në pyetje. Në disa raste ishin edhe të panjohur.

15 Duke -- disa statistika. Fillojmë me deklaratat e
16 mëparshme të vetë të akuzuarve. Deklaratat zyrtare të
17 akuzuarit ndonjëherë në këtë çështje nuk kanë dhënë dëshmi, që
18 është e drejtë e tyre. Ata, megjithatë, kanë bashkëpunuar
19 përmes dhënies së intervistave ZPS-së dhe autoriteteve të
20 tjera të Prokurorisë, të cilat nuk iu nënshtruan verifikimit
21 apo marrjes kundër pyetjeve dhe u pranuan megjithëse ne bëmë
22 kundërshtime. ZPS-ja mbështetet në deklaratat formale të
23 paverifikuara të të akuzuarve, më shumë se 1100 herë për të --
24 në përpjekje për të vërtetuar akuzat e tyre. Dhe do t'i lexoj
25 këto, pra është --

1 Deklaratat e mëparshme të z. Selimi citohet 499 herë.

2 Deklarata të mëparshme të z. Krasniqi dhe citohen 274
3 herë.

4 Deklaratat e mëparshme të z. Thaçi citohen 229 herë.

5 Deklaratat e mëparshme të z. Veseli citohen 100 herë.

6 Dhe kjo është përpara se të marrim parasysh tani të
7 vlerësojmë deklaratat joformale, përfshirë edhe citime, qindra
8 e qindra citime të intervistave të tjera, librave të
9 publikuara, të botuara apo të pabotuara, apo dokumente që kanë
10 përgatitur, për të cilat z. Thaçi nuk pati mundësi t'i
11 kundërshtonte apo t'i verifikonte. Për shembull, një libër i
12 shkruar nga z. Krasniqi është cituar 271 herë në dosjen
13 përfundimtare të Prokurorisë. Libra të tjerë të pasluftës,
14 dorëshkrime apo dokumente, që pretendohet që janë shkruar nga
15 z. Krasniqi, janë cituar më shumë se 100 herë dhe intervistat
16 joformale me z. Selimi janë cituar më shumë se 80 herë.

17 Diapozitivi 226.

18 Kjo është një praktikë. ZPS-ja është përpjekur të
19 ndërtojë provat e tyre bazuar në dokumente, dorëshkrime,
20 intervista. Artikuj shtypi, të gjithë të pranuar si prova
21 jогоjore, dhe të pa verifikuar në sallën e gjyqit. Ky është
22 gjykim mbështetur në thashetheme.

23 Rreziku me këtë është që provat që keni dëgjuar nga
24 dëshmitarët, dëshmitë e tyre të cilat u kun -- morën në pyetje
25 nga pala kundër, të dhënë -- dhanë dëshmi nën betim lidhur me

1 propagandën gjysmë të vërteta të ekzagjerime që kanë ndikuar
2 në mbështetshmërinë e materialeve dhe dokumenteve është -- u
3 krijuan pas luftës -- gjatë luftës, dhe të cilat ndikuan në
4 rrëfime që u krijuan pas kësaj.

5 Sokol Bashota shpjegoi këtë fenomen juve kur atij ju
6 treguan dokumente që pretendohet të kenë autor z. Selimi, z.
7 Krasniqi dhe të tjerë, në të cilat ZPS-ja tani mbështetet për
8 të vërtetuar çështje e tyre. Z. Bashota shpjegoi se që nga
9 lufta njerëzit kanë ekzagjeruar rolin e tyre dhe të tjerëve
10 për arsye të shumta, për të glorifikuar procesin e kohës së
11 luftës dhe për egon e tyre personale apo për qëllime politike.

12 Në mënyrë të ngjashme, Hajri Shkurtaç [Sipas përkthimit]
13 i cili u largua nga -- domethënë, u distancua librat që ai
14 vetë kishte publikuar, duke i quajtur ata të ekzagjeruar dhe
15 të pambështetshëm.

16 Kjo bëhet edhe më e rëndë nga fakti se këto materiale të
17 paverifikuara shpesh kanë për origjinë apo burojnë nga ish-
18 anëtarë të UÇK-së që pretendojnë të ketë qenë të rëndësishëm
19 apo që anëtarë të NKP-së siç emërohen vëzhgues ndërkombëtarë
20 të cilët ZPS-ja mund t'i kishte thirrur për të bërë
21 autentifikimin e këtyre materialeve, por zgjodhi të mos e bëjë
22 këtë gjë. Për shembull ZPS-ja intervistoi -- për të bërë këtë
23 gjë.

24 Tani, për diapozitivi 227.

25 Do të doja t'iu referoja te vendimi i këtij Trupi

1 Gjykues, me anë të të cilit pranohen këto deklara --
2 deklaratat e -- këto deklarata të akuzuarve, në të cilin
3 thuhet:

4 "... rregulla 140 (4) parasheh se -- dhe shpallja e
5 fajësisë dhe një verdikt fajësie nuk mund të bazohet vetëm,
6 apo në shkallë të gjerë në deklaratën e një dëshmitari të
7 cilin Mbrojtja nuk ka pasur mundësi ta marrë në pyetje."

8 Dhe ju siç e shihni, se vendimi i Trupit Gjykues është i
9 theksuar. Dhe paneli, Trupi Gjykues me tej shton: "Për shkak
10 se të akuzuarit mund të zgjedhin të mos japin dëshmi, Trupi
11 Gjykues do të kushtojë vëmendje të veçantë ekzistencës së apo
12 jo të materialeve të provave të verifikuara, konfirmuese,
13 përpara se të mbështetet në deklaratën e një të akuzuari,
14 lidhur me një të bashkëakuzuari. Në veçanti në lidhje me
15 aspektet tejet të rëndësishme materiale të provave të
16 Prokurorisë."

17 Tani, duket ishte në -- u sugjerua dje që nuk keni
18 nevojë për prova të verifikuara që është në kundërthënie të
19 drejtpërdrejtë me vendimin tuaj për pranimin e deklaratave të
20 të bashkëakuzuarve. Këto deklarata nuk janë, nuk paraqit --
21 nuk përmbajnë konfirmim të pavarur përmes provave të
22 verifikuara dhe nuk mund jenë të mbështetshme të provohen, të
23 mbahen si bazë, të përdoren si bazë kundër Hashim Thaçit.

24 Diapozitivi 228.

25 Një shembull domethënës është propozimi në paragrafin

1 1477 të dosjen e Prokurorisë përfundimtare. Jua kam treguar
2 këtë më herët, aty thuhet se përgjegjësia kryesore për
3 komunikatat ishte me z. Thaçi dhe z. Krasniqi. Ju kam sqaruar
4 arsyen sepse burimet e -- në poshtëshënimet relevante 6234 nuk
5 e mbështesin këtë propozim apo qëndrim, përfshirë edhe
6 mosvërtetimin përtej dyshimit të arsyeshëm se Hashim Thaçi
7 kishte ndonjë përfshirje në përgatitjen e komunikatave dhe
8 deklaratave politike.

9 Gjithashtu vëmë në dukje se z. Thaçi nuk ishte në gjendje
10 të verifikonte asnjë prej këtyre provave të cituara prej ZPS-
11 ja për të mbështetur pretendimin e tyre se përgjegjësia
12 kryesore për komunikatat ishte e z. Thaçi, dhe në mënyrë
13 konkrete z. Thaçi nuk ka qenë në gjendje të marrë në pyetje
14 Rexhep Selimin, të kundërshtojë sugjerimin e tij se z. Thaçi
15 në një farë mënyre ishte i përfshirë në përgatitjen e
16 komunikatës 59.

17 Për sa i përket sugjerimit të Prokurorisë në
18 poshtëshënimin 6234 se z. -- intervista e z. Selimi i dhënë
19 ZPS-së konfirmohet nga një postim në Facebook i z. Krasniqi
20 dhe ne e kundërshtojmë këtë si mbështetje. E njëjta si provë
21 mbështesë dhe e njëjta gjë zbatohet. Z. Thaçi nuk i pati
22 mendësi që të verifikojë as atë të kara -- z. -- të
23 kundërshtojë z. Krasniqi apo të verifikojë atë.

24 Gjithashtu ju japim shembuj të tjerë, përfshirë qëndrimet
25 në paragrafin 230, poshtëshënimin 940 të paragrafit 266, dhe

1 paragrafin 503, poshtëshënimi 2056 dhe 2057. Kjo është listë
2 që nuk është e plotë po ju kërkojmë që t'i shqyrtoni me kujdes
3 e të identifikoni të gjitha qëndrimet e ZPS-së, pretendimet e
4 tyre në dosjen e tyre, të cilat mbështeten vetëm në provat e
5 dhëna nga të bashkëakuzuar -- dëshmitë e dhëna nga të
6 bashkëakuzuarit e z. Thaçi, formal po ajo form -- deklarata
7 formale apo joformale, të cilat ne nuk kemi pasur mundësi që
8 t'i kundërshtojmë.

9 Diapozitivi 229.

10 Kalojmë te mënyra, format e përgjegjësisë. Do të doja të
11 bëja disa parashtime të shkurtra lidhur me NKP-në.

12 230 tani.

13 Pika jonë fillestare për çështje e NKP-së, aspektin e
14 NPK-së është se qëllimi kriminal i përbashkët që pretendohet
15 në këtë çështje nuk ka ekzistuar. Nuk ka pasur kurrë një plan
16 të për -- kriminal për të fitu -- për të marrë e për të
17 ushtruar kontroll në gjithë Kosovën përmes kryerjes së krimeve
18 që paraqiten në aktakuzë.

19 Dhe nëse Z -- edhe sikur ZPS-ja ta kishte vërtetuar
20 ekzistencën e këtij plani të përbashkët përtej dyshimit të
21 arsyeshëm ajo gjithsesi duhet, megjithatë duhet të vërtetojë
22 kontributin të konsiderueshëm të z. Thaçi dhe po -- dhe në
23 mënyrë konkrete kontri -- cili kontribut domethënëse dhe nëse
24 -- për çfarë në mënyrë të saktë.

25 Në gjithë dosjen e tyre ZPS-ja pretendon se të akuzuarit

1 kanë dhënë kontribut të rëndësishëm, plane të përbashkët. Për
2 shembull paragrafët 471, 481 dhe 570.

3 Megjithatë, qëndrimi i kësaj Gjykate është se përgjegjës
4 -- që në mënyrë që të kemi përgjegjësinë për NKP-në, ZPS-ja
5 duhet të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm se z. Thaçi
6 dha kontribut të rëndësishëm në krimet për të cilat ai
7 shpallet fajtor. Me fjalë të tjera, z. Thaçi duhet të ketë
8 kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në kryerjen e krimeve
9 që paraqiten në aktakuzë. Vrasje, torturë, trajtim mizor, e të
10 tjerë, dhe kjo është në përputhje me formulimin e gjuhës që
11 shihet në ekran, në aktgjykimin e kësaj Gjykate, përfshirë
12 vendimin e konfirmimit F0026, paragrafi 110.

13 Diapozitivi 231, ju lutem.

14 Që të jemi të qartë, jurisprudenca e qartë vërteton
15 pjesëmarrjen në NKP. Mund të -- që pjesëmarrja NTP mund të
16 marrë formën e kontributit në planin e përbashkët. Megjithatë,
17 e njëjta jurisprudencë jep hollësi të mëtejshme dhe përcakton
18 se ky kontribut "duhet të paktën të jetë kontribut i
19 konsiderueshëm në krimet për të cilat i akuzuari është
20 shpallur përgjegjës."

21 Hapi i radhës është edhe më i rëndësishëm, dhe ZPS-ja ka
22 gabuar në të dyja parashtimet e saj dhe në paraqitjen e
23 provave në këtë çështje. Pjesë të tëra të dosjes së
24 Prokurorisë i kushtohen faktit nëse të akuzuarit i kanë dhënë
25 kontribut të konsiderueshëm planit të, qëllimit të përbashkët

1 por pa parashtruar se si veprimet e pretenduara të z. Thaçi
2 dhe sjellja e tij kanë kontribuar në krimet që bëhen në
3 aktakuzë.

4 Pyetja të cilës ZPS-ja nuk iu përgjigj është se si Hashim
5 Thaçi dha kontribut të konsiderueshëm për vrasjet dhe ndalimet
6 e paligjshme, se si dha ai kontribut të konsiderueshëm për
7 torturën. Në veçanti, dhe siç e tregojnë edhe provat, ai ishte
8 jashtë vendit për pjesën më të madhe të periudhës që mbulohet
9 nga aktakuza dhe që shumë prej kryerësve vepronin mbi bazën --
10 për arsye, për motive personale dhe si për hakmarrje.

11 Të hënën ZPS-ja ju tha juve se -- i tregoi për motivet --
12 se motivet e tjera nuk e mohojnë qëllimin e përbashkët edhe --
13 dhe nuk e heqin ndonjëherë -- krim nga fushëveprimi i tij, nuk
14 e largojnë atë. Në fakt, kryerësi i drejtpërdrejtë nuk ka
15 nevojë të ketë pasur qëllim që përbashkët. Kjo është e
16 vërtetë. Ne nuk kemi thënë kurrë që ligji lidhur me NKP-në
17 kërkon që secili prej kryerësve duhet të ketë të njëjtin
18 qëllim të përbashkët, por ZPS-ja duhet të hetojë përtej
19 dyshimit të arsyeshëm se Hashim Thaçi dha kontribut të
20 konsiderueshëm për krimet në aktakuzë.

21 Prokuroria, në përfundim, pretendoi se dosja e ZPS-së,
22 përfundimtare, përcakton dhe shtjellon në hollësi në Pjesën
23 III "deklaratat e anëtarëve të NKP-së, të cilët përputhen,
24 përkojnë me sulmet thelbësore në terren. Kjo është -- kjo nuk
25 është e vërtetë. ZPS-ja ka bërë këtë gjë, në asnjë moment

1 lidhur me Hashim -- me z. Thaçi, duke iu referuar provave që
2 tregojnë fjalimin se deklarata publike përputhet me krimet në
3 vij -- që pasuan më vonë dhe kjo lidhje duhet të përcaktohet
4 dhe të vërtetohet.

5 Znj. Lawson ju tha ju që duhet të ketë një lidhje të
6 mjaftueshme midis kryerësit në fjalë dhe anëtarit të NKP-së.
7 Nëse kryerësit kanë vepruar për arsye -- për motive personale
8 dhe jo sepse -- për shkak të diçkaje që z. Thaçi ka urdhëruar,
9 atëherë ku është kjo lidhje.

10 Në realitet, nëse kemi njerëz në terren që kryejnë krime
11 për arsye personale për zënie pro -- për arsye pro --
12 konflikte pronash apo për hakmarrje, për dhunë të kaluar
13 kundër anëtarëve të familjes, kjo ngre dyshimin e arsyeshëm
14 lidh -- sa i takon pretendimit të ZPS-së se ky person është
15 përdorur si instrument i NKP-së dhe kjo është pa -- dhe kjo
16 pa dyshimi i heq ato krimet nga fushëveprimi i NKP-së.

17 Diapozitivi 232.

18 Gjithashtu dua të trajtoj shkurtimisht çështje që ngritëm
19 në deklaratat hyrëse lidhur me mënyrën se si ZPS-ja është
20 përpjekur të shtrembërojë elementët kontekstualë që lidhen me
21 krimet ndaj njerëzimit në këtë çështje. Ne fillimisht e
22 ngritëm këtë në deklaratën hyrëse para tre vitesh, dhe kemi
23 shprehur qëndrimin tonë në paragrafin 3.

24 ZPS-ja ngriti këto akuza me krime kun -- akuza për krime
25 kundër njerëzimit duke ditur shumë mirë se TPNJ-ja kishte

1 ekzaminuar nëse anëtarët e UÇK-së kishin kryer krime kundër
2 njerëzimit dhe nuk kishte gjetur Selimi dhe Haradina -- në
3 çështjen e Limaj dhe Haradinajt se Prokuroria kishte vërtetuar
4 sulme sistematike dhe të gjerë -- dhe të shtrira kundër cilës
5 -- kundër popullsisë civile. Për t'iu -- për të anashkaluar
6 konstatimet e TPNJ-së të cilat minojnë dhe që provat e -- apo
7 qëndrimin e Prokurorisë për krimet kundër -- kryerjen e
8 krimeve kundër njerëzimit, ZPS-ja kishte ndryshuar strategji
9 dhe përpiqej të rishkruante ligjin për krime kundër
10 njerëzimit.

11 Diapozitivi 234.

12 Konkretisht, në vend që të pretendonte se kjo ishte një
13 fushatë sistematike dhe e shtrirë drejtuar kundër popullsisë
14 civile, ZPS-ja e ngushtoi atë, pra shënjestrën për sulmet e
15 pretenduara të UÇK-së, duke thënë që kjo bëhej kundër
16 "popullsisë civile të kundërshtarëve", duke përkufizuar
17 popullin apo njerëzit të cilët konsideroheshin në atë kohë që
18 ishin kundër UÇK-së. Në -- me fjalë të tjera, njerëzit që ZPS-
19 ja pretendon se ishte sulmuar nga UÇK-ja.

20 Pra, në vend që të vlerësonte nëse kishte sulme kundër
21 popullsisë civile, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të vlerësojë
22 nëse UÇK-ja sulmonte njerëzit që ajo pretendonte që e
23 sulmonin. Kjo lloj arsyetimi që sillet rrotull, është një
24 shtrembërim dhe falsitet logjik që njihet si grackë. Pra,
25 pyetjes nëse një grup i caktuar ishte pjesë e popullsisë të

1 shënjestruar, në vend që t'i bëjë, t'i përgjigjet kësaj, ZPS-
2 ja ju kërkon juve që t'i konsideroni ata si viktimë të
3 kryerësve.

4 Përkufizimi i ngushtë pa dyshim e ndihmon ZPS-në në
5 vërtetimin e krimeve të kryera si pjesë e sulmeve se si pjesë
6 e sulmeve që ishin të shtrira dhe të gjera. Nëse ju ngushtoni
7 përkufizimin e popullsisë civile që -- të pretenduar te
8 njerëzit të cilët janë sulmuar, është shumë e lehtë të thuhet
9 që një pjesë e vogël e -- më e vogël e popullsisë ka qenë
10 viktimë e sulmeve të gjera dhe të shtrira.

11 E kemi përshkruar këtë si numër, pra, që ka shifra që
12 kanë shtuar vlerën e provave të Prokurorisë ndërsa kanë ulur
13 atë kur bëhet fjalë për numra më të vogël, pra, të civ -- të
14 popullsisë civile e cila ishte shënjestruar.

15 Diapozitivi 235.

16 Në dosjen e tyre, ZPS-ja këmbëngul dhe thekson qasjen e
17 tyre dhe përdor terma të gjuhës që fillojnë sulmi "ishte
18 drejtuar kundër kundërshtarëve, një pjesë e popullsisë që
19 ishte në pjesën e saj, në pjesën e saj dërmuese civile".
20 Paragrafi 1373. Pra, ZPS-ja pranon se sulmin e ka përkufizuar
21 në termat që kanë të bëjnë me një pjesë më të vogël të
22 popullsisë, një segment i popullsisë.

23 Problemi është popullsia në elemente kontekstuale të
24 krimeve kundër njerëzimit nuk është diçka që mund të
25 ndryshohet në këtë mënyrë. Jurisprudenca e kërkon që për të

1 përbërë një popullsi për nevojat e krimit kundër njerëzimit,
2 një grup duhet të formohet dhe të përbëjë "një grup individësh
3 mjaftueshëm të qëndrueshëm dhe të identifikueshëm, qoftë
4 gjeografikisht apo si rezultat i tipareve të përbashkëta. Pra,
5 grup individësh që kanë të njëjtin etni, besim, apo
6 karakteristika etnike që mund të përbëjnë këtë popullsi". Me
7 fjalë të tjera, popullsia civile duhet të përkufizohet duke iu
8 referuar karakteristikave objektive.

9 Popullsia në këtë çështje nuk është mjaftueshëm e
10 qëndrueshme dhe e identifikueshme. ZPS-ja nuk ka përkufizuar
11 popullsinë civile duke iu referuar karakteristikave objektive.
12 Kjo është ndryshim i bërë nga ana e tyre, subjektiv, për të
13 parë antëritë e për të konsideruar anëtarët e UÇK-së të
14 paidentifikuar në një moment të caktuar kohor.

15 Ky është problem me mënyrën se si ka vepruar Prokuroria.
16 Kriteri se krimet duhet të kryhen në një kontekst të sulmeve
17 kundër popullsisë civile duhet të ketë një domethënie dhe të
18 trajtohet si e tillë dhe duhet të ketë më shumë domethënie se
19 sa një sulm i kryer kundër një -- kundër personave që pre --
20 që vetë ZPS-ja pretendon që janë sulmuar. Duke më -- në
21 përpjekje për të zgjeruar krimet kundër njerë -- për të
22 zgjeruar përkufizimin të krimeve kundër njerëzimit përtej
23 kufizimeve të dhëna në çështjen Limaj dhe Haradinaj, ZPS-ja ka
24 tejkaluar kufijtë e saj, elementët kontekstualë që
25 karakterizojnë këtë krim.

1 Dhe së fundi, më lejoni të komentoj për anomalinë e
2 provave 236 -- diapozitivi 236.

3 Një prej anomalive është shkalla në të cilën dëshmitarët
4 e ZPS-së të njohur si luftëtarë të UÇK-së -- ish-luftëtarë të
5 UÇK-së, por edhe të tjerë, dhanë dëshmi që minonte provat e
6 ZPS-së.

7 Një prej pasojave të kësaj ishte se ne mund të shohim --
8 tani ZPS-ja përpiqet të tërhiqet nga këto prova që ajo -- nga
9 vetë dëshmitarët e tyre, pra, që dhanë sipas rregullës 143.
10 ZPS-ja në mënyrë të përsëritur po i kërkon Trupit Gjykses që
11 të mos marrë parasysh materialet shfajësuese që u morën përmes
12 dëshmimeve të këtyre dëshmitarëve, mbi bazën se këto janë,
13 kundërshtohen nga provat e tjera të konfirmuara.

14 Diapozitivi 238.

15 Duke bërë këtë pretendim, ZPS-ja keqinterpretton
16 standardin ligjor, keqzbaton. Rregulla 139(6) e KS -- e
17 rregullave të KS -- e rregulloreve së KSC-së parasheh se "Mos
18 përputhet nga një provë në vetvete nuk kërkon Trupin -- që
19 Trupi Gjykses ta hedhë poshtë atë si të pambështetshme. Trupi
20 Gjykses mund të pranojë pjesë të kësaj prove dhe të hedhë
21 poshtë të tjerat."

22 Dhe kjo është pjesë e jurisprudencës së kësaj Gjykate,
23 siç e shihni në referencën në diapozitivin 238.

24 Pra, ndërsa Trupi Gjykses mund të zgjedhë të mbështetet
25 në disa pjesë të dëshmisë së një dëshmitari, dhe jo në të

1 tjera, jurisprudenca nuk miraton një propozim apo qëndrim më
2 të gjerë se Trupi Gjykses mund të pranojë vetëm prova
3 fajësuese dhe të mos marrë parasysh prova shfajësuese.

4 Diapozitivi 239.

5 Për më tepër ZPS-ja rrallë herë paraqet prova të
6 dëshmitarëve për të kundërshtuar dëshminë e tyre shfajësuese.
7 Kjo shkel të drejtat për gjykim, të drejtë themelor të të
8 akuzuarve, por në mënyrë që Trupi Gjykses të mos marrë
9 parasysh provat shfajësuese të dëshmitarëve që nuk janë
10 kundërshtuar nga ZPS-ja në gjykim. Dhe do të ishte tërësisht e
11 padrejtë dhe thelbësisht e padrejtë për dëshmitarët që të
12 mbajnë provat shfajësuese dhe të konsiderohen këto si jo të
13 besueshme për shkak të frikës së pretenduar të një klime friks
14 -- të një atmosfere frikësimi në Kosovë apo sepse -- apo për
15 shkak të besnikërisë së tyre të pretenduar ndaj të akuzuarve.
16 Por këto nuk janë ballafaquar në asnjë moment nga ZPS-ja dhe
17 nuk është dhënë asnjë mundësi që të përgjigjen, që palët të
18 përgjigjen ndaj këtyre pretendimeve.

19 Provat e bes -- çdo provë e besueshme nga dëshmitarët e
20 ZPS-së që kundërshton provat e ZPS-së apo dëshmitë e tyre,
21 duhet të merret parasysh të -- për të -- si dyshim i arsyeshëm
22 i ngritur.

23 Kalojmë te diapozitivi 240.

24 Qasja e ZPS-së ndaj dëshmisë së Sokol Bashotës në dosjen
25 e tyre është shembull i mirë. ZPS-ja deklaron në përgjithësi

1 aty ku sa -- në rastet ku -- dëshmia e Sokol Bazhot -- e
2 Bashotës shfajëson të akuzuarit. Kjo duhet të hidhet poshtë
3 sepse në kundërthënie me dëshmitë e mbështetshme kundërthënëse
4 kjo është në poshtëshënimin 56 -- 596.

5 Përsëri edhe ky argument është i -- nuk qëndron. Duke --
6 në vlerësimin e besueshmërisë dhe mbështetshmërisë së provave
7 ose dëshmisë së tij. Kërkohet një peshim i kujdesshëm dhe
8 analizë e kujdesshme më shumë se sa hedhje poshtë e thjeshtë.

9 ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të hedhë poshtë provat
10 shfajësuese, përfshirë edhe shpjegimin se deklarata e tij e
11 mëparshme në PNJ -- në TPNJ ku i referohet politikës të
12 Shtabit të Përgjithshëm për të -- që shënjestrimi i
13 bashkëpunëtorëve ishte hipotetik, por nuk japin asnjë arsyetim
14 të mëtëjshëm sepse -- duke thënë që është shfajësuese dhe nuk
15 bëjnë përpjekje të njëmend për të vërtetuar pse kjo është e
16 pabesueshme, nuk duhet të besohet.

17 Por shumë faktorë minojnë qëndrimin e ZPS-së. Bashota
18 ishte në gjendje të shpjegonte në mënyrë koherente dhe dha
19 përgjigjet e tij -- përgjigjet që kishte dhënë, dhe shpjegoi
20 përgjigjet që kishte dhënë në TPNJ. Ai i kuptoi të dyja,
21 pyetjen dhe përgjigjen që ishin hipotetike, deklaratën që
22 përsëriti disa herë gjatë gjithë dëshmisë së tij.

23 Një gjë e tillë, fakti se Bashota po fliste në një mënyrë
24 hipotetike në TPNJ konfirmohet nga fakti se hetuesit e TNJ-së
25 [Sipas përkthimit] nuk u përpoqën që të merrnin hollësi të

1 mëtejshme lidhur me shembujt konkretë të Shtabit të
2 Përgjithshëm, ku Shtabi i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhra për
3 të shënjestruar bashkëpunëtorë duke treguar se ata e kishin
4 kuptuar se Bashota po fliste në mënyrë hipotetike.

5 Pika jonë fillestare është se ZPS-ja nuk ka vërtetuar
6 akuza kundër Thaçit dhe duhet -- se ai duhet të shpallet i
7 pafajshëm dhe të lirohet menjëherë dhe të kthehet në familjen
8 e tij dhe vendin e tij.

9 Është e çuditshme që të bëjmë parashtime lidhur me
10 dënimin në një pikë ku Mbrojtja është e pasionuar lidhur me
11 qëndrimin e saj që -- dhe rezultati i vetëm është lirimi,
12 shpallja e pafajshme e Hashim Thaçit. Duke bërë parashtimet
13 lidhur me dënimin tani kërcënojmë -- krijojmë situatën që të
14 krijojmë përshtypjen e gabuar se Mbrojtja pranon mundësinë e
15 shpalljes fajtor. Ne ju besojmë si pro -- si gjyqtarë
16 profesionistë të kuptoni qëndrimin dhe pozicionin në të cilin
17 jemi.

18 Megjithatë, më lejoni të marr disa sekonda për të folur
19 për dënimin që ZPS-ja ka kërkuar. Ata kanë kërkuar 45 vjet
20 dënim që është dënim me je -- në mënyrë efektive dënim i
21 përjetshëm. ZP -- pika fillestare e ZPS-së është që nuk ka
22 faktorë zbutës në këtë çështje. Kjo është një parashtim i
23 pabesueshëm nga një zyrë që e di se në Dhomat e Spe -- se
24 Dhomat e Specializuara të Kosovës, ZPS-ja nuk do të duhej edhe
25 të ekziston -- nuk do -- do -- nuk do të ekzistonin po të mos

1 ishte për të akuzuarin.

2 Kjo është një pabesueshëm. Kjo është e qartë, relevante,
3 dhe zbutëse, pra se z. Thaçi bashkëpunoi me Prokurorinë, dha
4 dorëheqjen nga presidenca, u dorëzua vetë dhe erdhi në Hagë
5 për t'u përballuar me këtë Gjykatë për të pastruar emrin e
6 tij. Pretendimi i ZPS-së se të gjitha këto nuk kanë asnjë
7 vlerë, nuk është parashtrim serioz.

8 Më tej, dënimi me 45 vjet burg -- duke kërkuar këtë
9 dënim, ZPS-ja mbështetet për -- si krahasim në çështje që
10 thotë përfshin "vepra penale të ngjashme dhe rrethana të
11 ngjashme": Stakic, Martić dhe Taylor.

12 Diapozitivi 245.

13 Këto çështje nuk ja -- këto raste nuk janë të
14 krahasueshme.

15 Stakic është dënuar për eksternalizimin i rreth 1500
16 civilëve dhe i zhvendosje me forcë të dhjetëra mijëra të
17 tjerë. Ai ka pasur një rol kyç në koordinimin e persek -- e
18 kamp -- e fushatës persekutuese -- përndjekëse dhe ka marrë
19 pjesë në urdhërimin e sulmeve kundër joserbëve. Përkundër, në
20 ndryshim nga Thaçi, ai nuk është paraqitur vullnetarisht për
21 t'u dorëzuar dhe është dënuar me 40 vjet burgim.

22 Martinic është dënuar për 16 akuza, përfshirë vrasje
23 përndjekje, tortura, akte çnjerëzore, për sjelljen e tij, e
24 cila shtrihej në vite. Ai ka kryer këto krime me qëllim, me
25 synimin diskriminues dhe ato ishin, drejtoheshin drejt një

1 spastrimi etnik të një territori për të cilin ai nuk ka
2 treguar asnjë pendesë. Përkundër z. Thaçi, ai ishte i -- i
3 kishte ikur drejtësisë për shtatë vite dhe u dënua me 35 vite.

4 Charles Taylor, ish-presidenti i Liberisë, u dënua për
5 mbështetjen e tij të rebelëve të RUF në Sierra Leone, për më
6 shumë se -- një periudhë më shumë se 6-vjetore dhe gjatë
7 konfliktit të armatosur brutal me rreth 50 mijë viktima, shumë
8 prej tyre fëmijë, dhe shumë prej tyre viktima të dhunimit dhe
9 skllavërisë seksuale. Përkundrazi z. Thaçi, ai nuk u dorëzuar
10 në mënyrë të vullnetarshme dhe dënimi i tij u rëndua nga
11 vuajtja e zgjatur e viktimave. Ai u dënua me 50 vjet burgim.

12 Kjo nuk -- nuk ka thjesht mundësi që të bëhen krahasime
13 mes sjelljes së tij dhe një të akuzuari si z. Thaçi. Në të
14 kundërt, ai nuk ka pasur rol udhëheqës në konfliktin relevant.
15 Z. Thaçi ka qenë jashtë Kosovës për pjesën më të madhe të
16 periudhës së aktakuzës, duke u përpjekur të gjente një mënyrë
17 për t'i dhënë fund këtij konflikti. Kërkesa e ZPS-së për 45
18 vjet burgim nuk bazohet në praktikën e kaluar apo në
19 realitetin e kësaj çështjeje.

20 246.

21 Tani do të përfundoj duke thënë: në fillim të fjalës së
22 sonë përfundim -- të deklaratës sonë përfundimtare, unë ju
23 thashë juve që ky gjykim është test për ZPS-në. Ne kemi -- nuk
24 kemi asnjë dyshim se ky Panel, ky trup Gjykues i shquar do të
25 analizojë të gjitha provat në këtë çështje në hollësi, si dhe

1 të gjitha parashtimet e bëra nga palët. Po ju bëj thirrje që
2 të mendoheni mirë dhe të rishqyrtoni këtë sa më me kujdes. Ka
3 shumë boshllëqe, shumë gabime, shumë të meta në provat e
4 Prokurorisë apo çështjen e tyre, shumë mospërputhje të
5 brendshme, shumë argumente të palogjikshme, shumë pyetje që
6 nuk kanë marrë përgjigje, shumë dëshmitarë ndërkombëtarë që ju
7 thonë juve se Hashim Thaçi nuk është fajtor, shumë dëshmitarë
8 të brendshëm që ju thonë juve të njëjtën gjë, dhe shumë
9 dokumente mungojnë siç janë urdhrat e paligjshëm që z. Thaçi
10 pretendohet të ketë dhënë apo prova se z. Thaçi ka autori i
11 komunikatave, në qoftë se teoria e Prokurorisë është e
12 vërtetë. Asnjë lidhje midis Hashim Thaçi dhe ndonjë sjellje
13 kriminale.

14 Ky është gjykim që ka zgjatur rreth tre vjet dhe është
15 test për Prokurorinë dhe Prokuroria ka dështuar. Prezumimi i
16 pafajësisë së z. Thaçi mbetet. Është koha që Hashim Thaçi të
17 shkojë në shtëpi. Ne ju kërkojmë që të merrni aktgjykim që do
18 ta lironi atë nga akuzat.

19 Të nderuar Gjykatës, ju falënderoj për durimin tuaj dhe
20 dëgjimin. Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 z. Misetic.

23 Tani do të marrim 15 minuta pushim dhe do t'ju jap
24 mundësinë që të filloni. E di që nuk mund të mbarojmë sot, por
25 keni kohë të mirë për të filluar.

1 --- Seanca ndërpritet në orën 15.29

2 --- Seanca rifillon në orën 15.45

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon,
4 fjala është për ju.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Ju faleminderit.

6 Çështja e Prokurorisë kundër z. Kadri Veseli mund të
7 përshkruhet më saktë si në vijim si një përpjekje për të
8 gjetur një njëbrirëshin. Për më shumë se pesë vjet që prej kur
9 u ngrit aktakuzë në këtë çështje gjyqësore, madje edhe më parë
10 që në 2015-n kur u krijuan Dhomat e Specializuara dhe filluan
11 hetimet, ZPS-ja ka gjëmuar diçka që nuk ekziston, konkretisht,
12 janë përpjekur të gjejnë prova për përfshirjen e z. Kadri
13 Veseli në veprimtari kriminale.

14 Ai është rast unik në këtë çështje gjyqësore, sepse nuk
15 ka asnjë provë e jo më të ketë bërë ndonjë vepër penale.
16 Sigurisht që ka qenë anëtar i përkushtuar i UÇK-së i cili, në
17 një kohë që kishte shumë nevojë, një student i ri, pa asnjë
18 përvojë ushtarake, u bashkua me mijëra të tjerë nga të gjitha
19 sferat e jetës për të luftuar për lirinë e Kosovës dhe për të
20 pasur një të ardhme pa autoritarizëm, pa aparteid dhe
21 brutalitet për veten dhe për fëmijët. Po ky nuk është një
22 krim. Aspak. Dhe në rolin e tij pranë UÇK-së me krenari dhe
23 kurajë dhe tërësisht në mënyrë legjitime nuk do të thotë që z.
24 Veseli të ketë marrë pjesë ndonjëherë në veprimtari kriminale.
25 Provat lidhur me z. Veseli, ose për të qenë më të saktë

1 mungesa e këtyre provave, flasin në vetvete. Sipas nesh
2 shpjegimet profesionale, kriminalistike të këtyre provave
3 pikërisht vërtetojnë se nuk ka pasur asnjë element kriminal në
4 të.

5 Të ndjekësh të pamundurën, këtë ka bërë ZPS-ja, gjatë
6 gjithë kohës në mënyrë të vazhdueshme kanë ndjekur rrugën për
7 të gjetur prova dhe kanë shpresuar se diçka do të dalë në
8 fund. Në mënyrë të dëshpëruar janë përpjekur të kapen pas çdo
9 fjale, kanë luftuar me çdo mulli ere përgjatë rrugës. Por
10 arritën në fund të rrugës, një rrugë të gjatë dhe ja ku janë
11 këtu përpara jush të nderuar Gjykatës, duarbosh. Dosja
12 përfundimtare e tyre është një përpjekje e dëshpëruar për të
13 paraqitur argumentet e tyre sikurse bënë edhe me parashtrimet
14 gojore këtë javë.

15 Ky është një rast kundër një personi që po luftohet prej
16 UÇK-së, pavarësisht të gjitha mangësive të UÇK-së e cila ka
17 qenë e dukshme që në fillim. Janë përpjekur dëshpërimisht të
18 paraqesin argumente të përfshijnë klientin tim në këtë çështje
19 gjyqësore. Po kur vendosën ta përfshinin në këtë çështje
20 gjyqësore, asnjëherë nuk e rishqyrtuan këtë vendim. Edhe pse
21 çdo dëshmitar që sollën këtu nuk dha ndonjë provë kundër z.
22 Veseli madje as nuk e kishin dëgjuar ndonjëherë emrin e tij,
23 po prapë ZPS-ja në mënyrë publike nuk u tërhoq në asnjë moment
24 në lidhje me këtë çështje. Qoftë edhe privatisht, por ama unë
25 besoj, që kur kanë shkuar në zyrat e tyre pas gjyqimit e kanë

1 menduar këtë gjë dhe thellë-thellë në zemër kanë pasur
2 dyshimet e veta. Dhe tani, gjendemi në një situatë ku ZPS-ja
3 duhet t'ju sjelli fakte konkrete, të nderuar Gjykatës, dhe
4 pikërisht shohim këto dyshime të cilat manifestojnë mangësi që
5 oshtijnë nga parashtrimet e tyre.

6 Mjaft të shohim rreshtat e parë të dosjes së tyre, të
7 cilën e kanë përsëritur disa herë dhe në Gjykatë: deklarata
8 publike që betonin të ndëshkonin oponentët. Rregullore të
9 diktuar që tregonin trajtimin e tyre të pamëshirshëm. Urdhra
10 që tregonin një praktikë që i shenjëstronte ata. Po ku janë
11 provat që z. Veseli paska qenë pjesë e kësaj, çfarëdo të ketë
12 qenë kjo gjë. Nuk ekziston qoftë një provë e vetme që ai të
13 ketë vepruar në këtë mënyrë.

14 Përkundrazi. Provat tregojnë se ai ka punuar në UÇK që të
15 parandalonte civilët e Kosovës, do përdorë fjalët e ZPS-së
16 tani, që të ndëshkoheshin, të trajtoheshin në mënyrë të
17 pamëshirshme dhe të shënjestroheshin dhe këtë e ka bërë duke u
18 angazhuar me komunitetin diplomatik, me komunitetin e fushës
19 së zbulimit jashtë vendit që ta kuptonin UÇK dhe të ndihmonte
20 njerëzit e Kosovës dhe, është shumë e rëndësishme, të sillte
21 paqen përmes një marrëveshjeje për paqen sa më shpejt që të
22 ishte e mundur dhe kemi prova dhe, këtë nuk mund ta
23 kontestoni, që ai nuk ka qenë fare i pranishëm për periudha të
24 gjata kohore.

25 Siç pretendon z. Tieger, ashtu është nuk filloi me sulmin

1 ndaj familjes Jashari nga forcat serbe, ndonëse z. Tieger nuk
2 ia nxë goja të thotë nga forcat serbe apo qoftë ta përmendi
3 fushatën serbe, sepse këtë bën ZPS-ja, ZPS-ja po rishkruan
4 historinë. Në fakt, ashtu është. Ka filluar shumë kohë përpara
5 kësaj, përpara këtij sulmi, siç e di shumë mirë z. Tieger
6 sepse ka qenë pjesë e Prokurorisë që ndoqi penalisht këtë
7 çështje në ish-tribunalin e Hagës. Filloi pikërisht me
8 politikat e regjimit të Milosevic që shënjestronte shqiptarët
9 që nga fundi i viteve 1980 dhe gjithë vitet 1990 përmes një
10 sistemi të organizuar shtypjeje, aparteidi dhe spastrimi
11 etnik. Ka qenë reagim ndaj asaj politike - kjo është, kjo
12 ishte një praktikë kriminale dhe plan kriminal - dhe
13 shqiptarët e Kosovës u detyruan të mbijetonin. Ideja se
14 shqiptarët ishin jashtë vendit duke komplotuar që të
15 ktheheshin në vendin e tyre në Kosovë të shenjëstronin
16 oponentët përmes një lufte speciale dhe se këtë luftë e
17 filluan duke u kthyer në mars të 1998 është absurde. Të lë pa
18 fjalë. Është njësoj si të themi tani që ukrainasit e filluan
19 luftën në vendin e tyre sepse ata kishin planifikuar që të
20 luftonin kundër një pushtimi të plotë, kur e kemi dëgjuar
21 diçka të tillë?

22 Shqiptarët e Kosovës, njësoj si z. Veseli, vullnetarisht
23 u përpoqën të shpëtonin vendin e tyre dhe popullin dhe i kanë
24 kushtuar gjithë jetën këtij qëllimi. Sigurisht që dhe ata do
25 kishin preferuar një jetë normale të paqte, të rrisnin fëmijët

1 e tyre, siç bëjmë ne në vendet demokratike, pa u konsideruar
2 si shtetas të dorës së dytë dhe të jetonin në frikë
3 vazhdimisht. Por nuk iu dha kjo mundësi, kjo nuk do të ndodhte
4 për ta dhe nuk kishin zgjedhje tjetër po t'i rezistonin
5 tiranisë së Milosevic. Dhe, në fakt, njihet si një moment për
6 t'u festuar në historinë botërore në vitet 1990 që demokracitë
7 qëndruan në krahun e humanitetit dhe ndërhyjnë për të ndaluar
8 dhunën e shqiptarëve në Kosovë pasi dështuan pikërisht në këtë
9 fushë në Bosnjë dhe në Ruandë më parë.

10 Pra, ZPS-ja mund të argumentojë derisa të vijë fundi i
11 botës nëse dëshiron se kanë provat kundër z. Veseli, por kjo
12 nuk ndryshon atë që ju, të nderuar Gjykatës, mund ta shihni
13 pikërisht tani që në fakt është një çështje e dobët kundër
14 tij. Madje, është pikërisht mosekzistenca e provave, ZPS-ja
15 ndjek të kotën dhe pikërisht kjo është në thelb të çështjes
16 kundër Veselit. Dhe duhen parë gjërat ashtu siç janë.

17 Na kujton kjo stilin oruellian të mendosh njëherazi,
18 gjegjësisht, aftësia mendore e një personi që njëherazi të
19 mbajnë në mendje dhe të pranojë dy pika tërësisht
20 kontradiktore, por të besojë që të dyja këto pika
21 kontradiktore janë të vërteta. Të luash me mendjen e njeriut
22 për të besuar të rremen që lufta është paqe, që pafajësia
23 është fajësi. ZPS-ja nuk mund të thotë që 2 plus 2 bëjnë 5.
24 Megjithatë ndonëse ata e mohojnë të vërtetën, e vërteta
25 vazhdon të ekzistojë.

1 Të nderuar Gjykatës, të trajtojmë dosjen përfundimtare të
2 ZPS-së dhe parashtrimet me gojë në vija të përgjithshme pastaj
3 do të flas paragraf për paragraf, poshtëshënim për
4 poshtëshënim të gabuar që do jetë një ushtrim goxha i
5 vështirë.

6 Po fillimisht ta marrin në vija të përgjithshme, janë
7 katër aspekte kryesore që unë dua të trajtojë sot dhe nesër do
8 të trajtojë pikat e tjera me hollësi, së pari, mungesa e
9 provave që tregojnë përfshirje të drejtpërdrejtë të z. Veseli
10 në veprimtari penale dhe në krimet që pretendohen, pra, dua të
11 fokusohem veçanërisht në provat dytësore - se këto janë shumë
12 të rëndësishme.

13 Së dyti, natyrën krejt rrethanore të argumenteve të ZPS-
14 së, që në fakt argumentet e tyre përputhen me pafajësinë.

15 Së treti, roli që luan drejtësia për viktimat siç e
16 theksoi z. Laws dhe, sigurisht, pa cenuar shtetin e së
17 drejtës.

18 Dhe më pas, së katërti, sjelljen e jashtëzakonshme të
19 Prokurorisë që kemi parë, që në fakt ka treguar s'kanë asnjë
20 argument kundër z. Veseli, e jo më të flasim tani për prapun e
21 dyshimit të arsyeshëm.

22 Këto janë katër pikat e përgjithshme, ndërsa nesër unë do
23 të zbërthej më në hollësi parashtrimet e ZPS-së, paragraf më
24 paragraf edhe do të sjell disa shembuj konkretë të deklaratave
25 të fryra, pasaktësive në tekst dhe burime të pabaza të shumë

1 prej poshtëshënimeve. Do jap vetëm disa shembuj përndryshe do
2 të ishim këtu me javë të tëra, por ata shembuj mjaftojnë për
3 të ilustruar gabimet në këtë çështje gjyqësore.

4 Unë ju thashë, të nderuar Gjykatës, që do t'i përgjigjem
5 argumenteve të Prokurorisë dhe të hënën dhe të martën do ta
6 bëjë këtë. Kështu që nuk do të përsërisë atë që kemi në dosjen
7 tonë përfundimtare, por duhet ta merrni në tërësinë e vet.

8 Së pari, nuk ekziston asnjë provë e drejtpërdrejtë e
9 dorës së parë që tregon përfshirje të z. Veseli në veprat
10 penale që pretendohet se ka kryer. Pretendimet e
11 drejtpërdrejta janë bazuar tërësisht në prova dytësore bazuar
12 në fjalë goje, pra, shpesh dhe janë hequr. ZPS-ja nuk ka
13 gjetur një dëshmitar të vetëm, pas gjithë kësaj kohe, të vijë
14 në Gjykatë dhe të pretendojë se z. Veseli ka kryer krime. Nuk
15 mund ta bënin se nuk ekzistojnë. Ky është një fakt befasues.

16 ZPS-ja thotë: Po mos u shqetësoni, janë të gjitha të
17 konfirmuara. Por siç do ta shihni, ky është një trillim, diçka
18 që e kanë thënë siç e kanë thënë gjatë gjithë kësaj kohe, por
19 kjo nuk është e vërtetë.

20 Ndonëse z. Veseli përmendet rreth 260 herë në dosjen
21 përfundimtare të ZPS-së asnjë prej këtyre deklaratave, pra,
22 janë thjesht disa deklarata të pabazuara, pra, asnjë prej
23 tyre, asnjë prej këtyre nuk tregon ndonjë element kriminal apo
24 të paligjshëm në sjelljen e tij. Gjithçka që ka kryer, ka qenë
25 legjitime. Kjo është një statistikë e jashtëzakonshme.

1 Edhe më e çuditshme është nëse marrim në konsideratë disa
2 gjykime të tjera pas hetimeve ndërkombëtare, duke filluar nga
3 1993 përpara ish-Tribunalit të Hagës dhe më pas gjykimet
4 përpara UNMIK-ut dhe EULEX-it, ku shumica prej këtyre krimeve
5 ekzakte kundër z. Veseli janë litiguar pa e përmendur emrin e
6 tij të përfshirë ndonjëherë në ndonjë prej këtyre veprave
7 penale. Nëse bëjmë një përlllogaritje në vija të trasha, po
8 flasim për gati 1000 dëshmitarë, mbase dhe më shumë të tjerë
9 të intervistuar në këto raste që sapo përmenda, konkretisht në
10 dy çështje gjyqësore këtu, nëntë përpara UNMIK-ut dhe EULEX-
11 it, pesë përpara TPNJ-së, me 1260 ditë gjykimi në të gjitha
12 këto çështje gjyqësore. Asnjë akuzë nuk është ngritur kundër
13 tij asnjëherë.

14 E pabesueshme sepse ka pasur kaq shumë hetime dhe ndjekje
15 penale do kishte dalë në ndonjë moment një provë kundër tij e
16 cila mund të përdorej kundër z. Veseli dhe këto hetime kanë
17 ndodhur gjatë gjithë kohës që ai ka qenë në moshë madhore,
18 duke filluar që nga TPNJ-ja në 1993 dhe sidoqoftë nuk është
19 gjetur asnjë element kriminal kundër tij derisa lindi kjo
20 çështja gjyqësore.

21 Dëshmitar pas dëshmitari kanë dhënë dëshmi këtu dhe kanë
22 thënë se gjatë luftës nuk e njihnin z. Veseli, nuk kanë pasur
23 kontakte me të dhe zor se kanë pasur ndonjë komunikim me të,
24 sepse ai nuk ka qenë aty, ka qenë më shumë jashtë vendit. Pas
25 luftës, kur u bë më i njohur nga pikëpamja politike, vetëm

1 atëherë dolën disa persona që u përpoqën të njollosnin emrin e
2 tij, ndonëse nuk thanë asgjë gjatë luftës për të, por më pas
3 në mjedisin politik pas luftës atëherë dolën disa akuza krejt
4 të pabaza. Por ama asnjë prej tyre nuk ka ardhur këtu për të
5 dhënë dëshmi që ta kontestojmë. Ne kemi ngelur në duart e
6 thashethemeve dhe asnjë provë tjetër dhe nuk ka asnjë provë
7 nga pikëpamja kriminalistike. Është për të ardhur keq.

8 Të nderuar Gjykatës, përveç disa rrëfimeve të dorës së
9 dytë të pavërtetuar të rolit të drejtpërdrejtë të pretenduar
10 të z. Veseli në kryerjen e ndonjë krimi nuk ngelet gjë tjetër,
11 kjo mbetet dhe, në fakt, janë informacione të thjeshta të
12 dorës së dytë të cilat z. Veseli -- për të cilat z. Veseli nuk
13 ka qenë në gjendje as të pyesë autorët që mund t'i kenë bërë
14 këto, siç është e drejta e tij sipas ligjit të kësaj Gjykate,
15 ligjit evropian apo të drejtës ndërkombëtare dhe nuk ka
16 vërtetim të asnjë gjëje.

17 Po flitet këtu për një numër shumë të vogël të
18 pretendimeve të rolit të drejtpërdrejtë, në fakt dy: njëri ka
19 bërë me dy persona të cilët janë marrë në Drenoc, dhe një
20 tjetër, Milan Mitrovic, në Kleçkë. Dhe disa copëza të
21 palidhura në të cilët janë përqendruar Prokuroria dhe të cilat
22 do t'i diskutoj.

23 Për herë të parë në këtë proces gjyqësor, kemi dëgjuar
24 dje z. Halling kur tha: Mos u shqetësoni, të nderuar Gjykatës,
25 rregulla 140(4) (a) nuk është e zbatueshme këtu. Mund të

1 gjendet fajtor një person mbi bazën e provave të pavërtetuara
2 të dorës së dytë që për z. Veseli dhe për rolin e tij në dy
3 incidente sepse kjo rregull zbatohet vetëm për deklaratat e
4 dëshmitarëve siç është përkufizuar nga Trupi Gjykues këtu.

5 Pra, sipas z. Halling, bëhet fjalë vetëm fjalë vetëm për
6 "dëshmitë e dëshmitarëve" siç është përcaktuar nga Trupi
7 Gjykues dhe sipas mendimit tonë kjo është një rishkruarje e së
8 drejtës themelore të Strasburgut dhe një grisje e rregullores
9 së DHSK-së. Është kaq gabim sa ZPS-ja tani mbështetet në këtë
10 argument dhe, në fakt, ata janë në kurth si të thuash. Nuk ka
11 justifikim për një gjë të tillë.

12 Rregulla 140(4)(a) është një dispozitë themelore që
13 zbatohet në të dy këto rastet e përfshirjes së drejtpërdrejtë
14 të pretenduar të z. Veseli. Provat për rolin e tij të
15 pretenduar në marrjen e dy personave vjen nga deklaratat e një
16 personi i cili nuk ka dhënë dëshmi në këtë gjykim, dëshmia e
17 të cilit nuk është vërtetuar. Pavarësisht se mund të ishte
18 thirrur si dëshmitar, siç kemi dëgjuar. ZPS-ja në fakt e
19 kishte marrë në intervistë. Deklaratat e tij, provat e tij që
20 të gjitha janë pranuar si prova këtu përmes dëshmitarëve të
21 tjerë dhe këtu kanë ardhur ata për të treguar se çfarë i ka
22 thënë ai atyre. Pra, e dorës së dytë. Pra, nuk ka rëndësi, të
23 nderuar Gjykatës, që ky informacion i dorës së dytë nuk ka
24 formën e një dëshmie të një dëshmitari siç përcaktohet nga
25 DHSK-ja. Është e rëndësishme që kjo deklaratë është e

1 pavërtetuar. Kështu zbatohet rregulla. Siç e ka pranuar Paneli
2 i Gjykatës së Apelit të kësaj Gjykate në rastin Shala, është
3 një rregull ky i cili rrjedh nga neni 6 i Strasburgut, i cili
4 garanton të drejtën e një të akuzuari për të ballafaquar një
5 dëshmitar që del kundër tij dhe për ta pyetur atë. Paneli i
6 Apelit e ka bërë të qartë që kjo rregull zbatohet për të
7 gjitha provat e pavërtetuara, pavarësisht nëse ato kanë të
8 bëjnë me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë apo me fakte të cilat
9 përbëjnë elementët e llojit të përgjegjësisë apo në fakt të
10 çfarëdolloj fakti të domosdoshëm për të arritur përfundimin e
11 fajësisë. Pra, ka të bëjë me të gjitha, ka të bëjë me rolin
12 drejtpërdrejtë, NKP, përgjegjësinë eprore, që të gjitha. Të
13 nderuar Gjykatës, gjendet kjo në paragrafin 478.

14 Dhoma e Apelit e përmend provat e pavërtetuara gjatë
15 gjithë kohës ku konfirmon zbatueshmërinë e rregullës 140(4)(a)
16 dhe e bëjnë tejet të qartë që kjo rregull është hartuar për të
17 mbrojtur mbështetjen e mëvetësishme dhe vendimtare në këto
18 lloj provash. Paragrafi 480, në të njëjtin aktgjykim, kur thua
19 që si duhet vlerësuar rregulla dhe këtu po citoj:

20 "... aspekti qendror është nëse fajësia varet në mënyrë
21 vendimtare në provat e pavërtetuara" - këtë ka thënë Gjykata,
22 pra, "bëhet fjalë për masën në të cilat të akuzuarit i është
23 dhënë mundësia për të bërë pyetje lidhur me këto prova të
24 cilat janë përmendur dhe që përbëjnë këtë ..."

25 Është një fjali shumë qendrore, unë po e përsëris, e kam

1 dhe në dosjen tonë përfundimtare:

2 "Kur një provë e paprovuar shfrytëzohet për të vërtetuar
3 një provë tjetër të paprovuar, që një trup gjykues duhet të
4 jetë i kujdesshëm në arritjen e përfundimit nëse kjo është e
5 domosdoshme për gjetjen e fajësorëve dhe po e theksoj këtu."

6 Paneli i Apelit ndalon pikërisht atë që po ju kërkon juve
7 të bëni, të nderuar Gjykatës, ZPS-ja, pra, për të gjetur një
8 person fajtor mbi bazën e provave të pavërtetuara.

9 Paneli i Apelit, duke u përgjigjur në rastin e apelit të
10 Dëshmitarit W04747 lidhur me pranueshmërin e provave, të
11 nderuar Gjykatës, do t'ju kujtohet, ka thënë që vërtetimi
12 përkufizohet si "konfirmim apo mbështetje nga provat e tjera
13 apo një autor tjetër" apo që "të vërtetojë", vërtetimi është
14 një përkufizim i asaj që do të thotë "të konfirmojë apo të
15 përforcojë", "ta bëj më të qartë", që do të thotë që dëshmia
16 nuk ka nevojë që të jetë "identike", siç e thotë Paneli i
17 Apelit, që "t'i përshkruajë faktet në të njëjtën mënyrë", por
18 pika qendrore, siç thanë ata është, që këto "prova duhet të
19 konfirmojnë në mënyra të ndryshme të njëjtin fakt. Jo një fakt
20 rrethanor por "të njëjtin fakt". Pra, provat provuese duhet të
21 konfirmojnë pikërisht atë përfundim. Dhe kjo gjendet në
22 paragrafin 36 të vendimit të Panelit të Apelit.

23 Këto janë parime themelore ligjore të cilat i anashkaloi
24 dje z. Halling. Ai përmendi përciptazi paragrafët 329 dhe 330
25 të aktgjykimit të apelit të Shalës për të mbështetur

1 pretendimin e padiskutueshëm dhe të përgjithshëm që shpeshherë
2 informacionet e dorës së dytë mund të jenë të bazueshme, por
3 nuk përmendi paragrafin kritik 333, ku Paneli i Apelit në
4 mënyrë të qartë e ka përforcuar kërkesën për vërtetim duke
5 pranuar që një dëshmitar që vjen për të dhënë dëshmi para një
6 trupi gjykues të jetë në gjendje që të vërtetojë identifikimin
7 e dorës së dytë të një të akuzuari. Pra, identifikimi i dorës
8 së dytë do të duhet që të vërtetohet nga një dëshmitar që jep
9 dëshmi në sallën e gjyqit. Kështu ka thënë Gjykatësi i Apelit
10 dhe kjo zbatohet në këto dy raste.

11 Më tej, z. Halling përmendi Karadzic dhe si referencë për
12 të mbështetur argumentin e tij. Edhe këtë herë, nuk e ka
13 nënvijëzuar paragrafin e fundit, fjalinë e fundit të këtij
14 paragrafi, paragrafi 452, e cila e bën të qartë që provat e
15 pavërtetuara që të jenë të mbështetshme kërkohet që të
16 vërtetohen në mënyrë të mjaftueshme dhe vetëm ashtu mund të
17 arrihet në një fajësi. Dhe kjo ndodhet në aktgjykimin e
18 Karadzic në paragrafin 452. Edhe një herë, bëhet fjalë për
19 "dëshmi të pavërtetuara" dhe jo për dëshmi dëshmitari apo
20 deklaratë dëshmitari sipas përkufizimit.

21 Pra, të nderuar Gjykatës, në këtë pikë ne po themi që: Z.
22 Halling, a po thotë që kjo provë e pavërtetuar e një personi i
23 cili nuk është paraqitur para një trupi gjykues të mund të
24 shërbejë si një bazë e vetme për gjetjen e fajësisë vetëm për
25 shkak se nuk është deklaratë dëshmitari sipas përkufizimit të

1 DHSK-së?

2 Në fakt ai e la këtë argument. Nuk e tha këtë në mënyrë
3 të hapur, nuk tha që kjo zbatohet për këta personat të cilët
4 janë marrë më tutje, të nderuar Gjykatës, është e rëndësishme
5 të mbahet parasysh apo e thotë këtë lidhur me këtë pretendim
6 dhe bëhet fjalë vetëm për dy raste në rastin e klientit tim,
7 që ju, të nderuar Gjykatës, të mund të bazoheni në dëshmi të
8 paprovuara e cila nuk është në formën e një deklarate
9 dëshmitari dhe mbi këtë të gjendet fajësia.

10 Në qoftë se nuk është duke thënë këtë gjë, ndoshta mund
11 ta sqarojë dhe mund të thotë që s'po thojë këtë. Megjithatë
12 unë do ta zhvillojë këtë argument për të thënë që nuk është,
13 në themel është i gabuar në bazë të ligjit të Strasburgut dhe
14 të kësaj Gjykate.

15 Në qoftë se ZPS-ja thotë, jo, jo, provat e pavërtetuara
16 janë të bazuara dhe të mbështetura nga të tjerët, atëherë
17 është një argument i ndryshëm. Dhe tani do të flas pikërisht
18 për këtë aspekt.

19 Pra, do të pyesim, do të presim se çfarë ka për të thënë
20 ZPS-ja, në qoftë se ata po thonë që nuk bëhet fjalë për
21 çështjet për kufizimit të deklaratave të një dëshmitari, por
22 bëhet fjalë për vërtetim, dakord, atëherë kjo është një
23 çështje e ndryshme, ka disa parime të cilat i kam përmendur të
24 cilat ZPS-ja do të duhet t'i marrë parasysh me qëllim dhe
25 t'jua tregoj juve pikërisht këtë gjë, të nderuar Gjykatës.

1 Pjesa e parë është, që provat e dorës së dytë mund të
2 shërbejnë si bazë për gjetjen e fajësisë, por do të duhet të
3 vërtetohen nga ZPS-ja. Por nuk mund të bëhet kjo përmes
4 deklaratave të pavërtetuara të dorës së dytë që të dihet një
5 gjë e tillë.

6 Dhe e dyta, ky është parimi i parë dhe e dyta, që vjen
7 nga apeli i 4747, këto prova do të duhet që të kenë të bëjnë
8 me faktet specifike të pretendimit të një roli dhe nuk janë
9 ato faktet e përgjithshme, por fakte specifike lidhur me rolin
10 e një të akuzuari. Prova të mëtejshme të një krimi në
11 përgjithësi nuk janë vërtetim i pretendimit kundër të një të
12 akuzuari.

13 Për t'i zbatuar tani këto, për sa i përket dy personave.
14 ZPS-ja mbështetet në materialet e tjera të dorës së dytë. Këtë
15 tha z. Pace në mënyrë shkarazi të hënën, por ai foli -- por
16 pala mbrojtëse nuk ka qenë në gjendje që t'i bëjë pyetje
17 këtyre dëshmitarëve të cilët janë në thelb të autorësisë së
18 këtij informacioni të dorës së dytë. Por kjo hidhet poshtë,
19 pra, pikërisht ligji që kërkon marrjen në pyetje, nuk ka
20 rëndësi se sa njerëz thonë që e kanë dëgjuar një gjë. Burimi i
21 një informacioni do të duhet të vërtetohet përmes marrjes në
22 pyetje dhe në qoftë se nuk bëhet një gjë e tillë, atëherë ZPS-
23 ja nuk mund të ketë argument. Nuk ka rëndësi nëse Mbrojtja
24 mund ta marrë këtë në pyetje këtë person i cili e ka kaluar
25 këtë informacion. Duhet të ekzistojë mundësia pikërisht e

1 autorit që të merret në pyetje. Përndryshe, nuk ka mundësi për
2 ta vërtetuar. Provat e pavërtetuara do të duhet të kenë
3 mbështetje, kaq pikë. Në mënyrë të ngjashme, dëshmitë e
4 paprovuara të të bashkëakuzuarve nuk mund të shërbejnë për të
5 vërtetuar dëshminë e pavërtetuar të cilën u paraqitën para
6 Trupi Gjykues, e cila është po ashtu e pavërtetuar. Dhe ky
7 është një qark që përsëritet.

8 Sa i përket pretendimit të dytë që ka të bëjë me një të
9 parandaluar në Kleçkë edhe kjo është thjesht e bazuar në
10 informacion të dorës së dytë. Të hënën z. Pace as nuk u përpoq
11 që ta vërtetonte atë. Të martën z. Halling u përpoq duke thënë
12 që z. Veseli ishte në zonën e përgjithshme në atë kohë të
13 përgjithshme, s'kishte asgjë specifike, por nuk është ky një
14 vërtetim i një rrëfimi të dorës së dytë që vjen nga W04939 që
15 z. Veseli ndodhej në disa vende specifike duke bërë këto krime
16 të cilat përbëjnë krimin e pretenduar, kjo kërkohet nga ligji.

17 ZPS-ja bazohet në prova të cilat janë në themel të krimit
18 të bërë, që nuk konfirmon që z. Veseli të ketë marrë pjesë në
19 kryerjen e këtij krimi. Dhe akuza që ai ka marrë pjesë vjen
20 nga një dëshmitar dhe nuk ka prova të tjera për të mbështetur
21 atë që ka thënë ai dëshmitar. Dhe ky është një dëshmitar i
22 cili nuk është dëgjuar, të cilit nuk i janë bërë pyetje.

23 Z. Halling as nuk u përpoq që të shfrytëzonte argumentin
24 e deklaratës së dëshmitarëve si burim i vetëm për këtë
25 pretendim të tij pasi e kuptoi se rrëfimi i W04839 është në

1 formën e kësaj deklarate, pra, ai përmendi deklaratat e tjera
2 duke thënë që është ky një pretendim i cili nuk bazohet
3 thjesht në dëshminë e paprovuar të 4839 por në prova të tjera.
4 Por cilat janë këto prova të tjera që tregojnë rolin që ka
5 luajtur z. Veseli? ZPS-ja nuk na ka treguar.

6 Ka disa prova lidhur me krimin në përgjithësi, por jo për
7 rolin e tij në këtë. Nuk ka rëndësi se unë mund të marr në
8 pyetje dëshmitarë lidhur me krimin në përgjithësi, dëshmitarë
9 të cilët nuk thonë asgjë për rolin e tij. Në fakt ata thonë që
10 ai nuk ka qenë aty. Dhe akuza e vetme për rolin e tij të
11 drejtpërdrejtë vjen vetëm nga një dëshmitar të cilin unë nuk
12 mund ta marr në pyetje dhe provat e tij lidhur me rolin e z.
13 Veseli nuk janë të bazuara. Është e qartë, të nderuar
14 Gjykatës. Nuk mund të arrihet fajësia mbi bazën e kësaj prove
15 të pavërtetuar dhe ky është në thelb të Strasburgut dhe të
16 rregullores së DHSK-së të cilën e ka konfirmuar po kështu edhe
17 apeli i Shalës.

18 Së fundmi, në fund z. Halling bëri gabim kur tha që
19 Mbrojtja ka patur mundësinë për të bërë pyetje lidhur me
20 paraburgimet në përgjithësi në Kleçkë. Dhe në dosjen e tyre
21 përfundimtare, ata përmendin një pjesë të apelit të Shalës
22 lidhur me shfrytëzimin e këtij "modeli të provave". Por ajo
23 nuk është zbatuar praktikisht në rastin e provave të
24 paprovuara kundër z. Veseli. Këtë argument ato në fakt e
25 varrosin në paragrafin 1405, 1409 të dosjes së tyre.

1 Po për çfarë modeli bëhet fjalë? Jurisprudenca kërkon që
2 ZPS-ja ta specifikojë një gjë të tillë për të treguar se si
3 lidhet kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë me një të akuzuar.
4 Sipas jurisprudencës së Panelit të Apelit modelet e
5 përgjithësuara të paraburgimeve nuk mund të shfrytëzohen për
6 të vërtetuar rolin e drejtpërdrejtë të një të akuzuari në një
7 krim specifik. Duhet të ekzistojë, duhet të jetë një model apo
8 fakte të ngjashme në formën e provave relevante për rolin
9 aktual të një të akuzuari, pra, provat të një modeli të njëjtë
10 apo të ngjashëm të sjelljes së z. Veseli për ta provuar një
11 gjë të tillë dhe kjo nuk ekziston.

12 Pra, nuk ngrihet çështja nëse një gjë e tillë ka ndodhur,
13 po pika kryesore është nëse ka pasur rol z. Veseli në këtë.
14 Dhe pika kritike këtu është që të kemi vërtetim të rolit të
15 pretenduar të tij të dorës së dytë për ta arritur këtë.

16 Të nderuar Gjykatës, sa i përket këtyre të dyve, ka arsye
17 të tjera se përse ZPS-ja nuk e ka vërtetuar argumentin e saj
18 lidhur me këto pretendime, pasi të gjitha këto janë rrëfime të
19 dorës së dytë të paqarta të papërputhshme, në fakt, është një
20 mish-mash dhe nuk ka nevojë, të nderuar Gjykatës, fare që ta
21 diskutojmë këtë. Pasi Prokuroria nuk ka patur mundësi për ta
22 diskutuar këtë rrëmuje sepse asnjë pjesë e saj nuk provon
23 provat e paprovuara të cilat janë në thelb të çdo pretendimi.
24 Në të gjitha këto raste bëhet fjalë për prova të përgjithshme
25 për të cilat edhe po të ishte në gjendje të bëje pyetje nuk do

1 të mund ta nxirrnin fundin.

2 Dhe kjo është arsyeja se përse shpenzova kaq kohë që në
3 fillim, të nderuar Gjykatës, pasi e gjithë kjo çështje, ky
4 aspekt i rregullit të vetëm vendimtar është qendror pasi nuk
5 vërteton rolin e drejtpërdrejtë. Megjithëkëtë është një
6 argument që gjendjet në të gjithë dosjen e tyre, përfshirë dhe
7 sa i përket çështjes së NKP-së dhe të përgjegjësisë eprorë.
8 Është kritike në zbatimin e shtetit ligjor dhe për këtë arsye
9 Gjykata e apelit ka dhënë hollësi të mëtejshme dhe prandaj po
10 e nënvijëzoj kaq shumë që në fillim këtë. Është kjo gjendja,
11 të nderuar Gjykatës, përmes secilës do të shihet i gjithë
12 argumenti që ngrihet kundër klientit tim kryesisht sa i përket
13 rolit të drejtpërdrejtë dhe më pas të shohim se çfarë mbetet
14 nga argumenti që ka të bëjë me NKP-në.

15 Të nderuar Gjykatës, ju duhet t'i shihni këto përpjekje
16 false të ZPS-së për ta vërtetuar këtë dhe duhet ta shihni këtë
17 me sy të qartë. ZPS-ja e di që duhet ta bëjë këtë për të
18 zbatuar ligjin dhe nuk ka mundësi për ta bërë këtë në rastin e
19 klientit tim. Ka me mijëra poshtëshënime, të nderuar Gjykatës,
20 në të cilat kërkohen hollësi të cilat nuk ekzistojnë. Secila
21 prej të cilave do të duhet të shihet me kujdes në bazë të
22 ligjit të zbatueshëm dhe jo të ligjit të rishkruar nga ana e
23 ZPS-së.

24 Të nderuar Gjykatës, ju duhet ta keni vënë re në
25 parashtrimet gojore të ZPS-së sa i përket z. Veseli se në fakt

1 bëhet fjalë për një numër të kufizuar pretendimesh të cilat
2 riciklohen gjatë gjithë kohës. Mirëpo, kur të hiqen të gjithë
3 elementët e tepërt apo fajësia përmes shoqërimit thjesht për
4 shkak të faktit që z. Veseli ka marrë pjesë në UÇK apo në
5 Shtabin e Përgjithshëm, në fakt, në thelb ngelin dy pretendime
6 të paprovuara të rolit që vjen përmes informacionit të dorës
7 së dytë të cilat i kam përmendur unë dhe për të cilat nuk mund
8 -- mbi të cilat nuk mund të mbështetesh. Bëhet fjalë në
9 përgjithësi për zona e Rahovecit në qershor 1998 pas luftimeve
10 të zhvilluara aty, por nuk ka hollësi të provuara, njohuri të
11 provuara të krimeve faktike. Në mënyrë të ngjashme fakti që
12 është parë në një minierë, tek një minierë në qershor të 1998-
13 s, mirëpo provat tregojnë se një gjë e tillë ndodhi të paktën
14 pesë ditë përpara rrëmbimeve të raportuara, të cilat nuk janë
15 as pjesë e aktakuzës. Ekziston një dokument i vetëm i cili
16 përmend Shef Lulin nga gushti i 1999, që është P709. Sipas
17 mendimit tonë, dokument i paautentifikuar vërtetësia e të
18 cilit nuk është vërtetuar dhe nuk provon asgjë. Edhe kur z.
19 Tieger përmendi atë, nuk tha se përse ishte kaq i rëndësishëm.
20 Na e tregoi, e përmendi dhe unë po prisja të shihja se çfarë
21 atëherë? Përse po shfrytëzohet një gjë e tillë, për çfarë
22 arsye po shfrytëzohet në këtë moment të caktuar? Më tej bëhej
23 fjalë për rolin vartës të Sabit Gecit ndaj klientit tim që
24 ishte eprori i pretenduar, që është pretendim pa asnjë thelb.
25 Që janë copëza thashethemesh të cilat nuk mund të merren

1 parasysh në mënyrë serioze. Nuk është kjo çështje gjuhësore se
2 çfarë tha ZPS-ja te hënën, por është një aspekt, bëhet fjalë
3 për një vërtetim përtej dyshimit të bazuar që ai ka qenë në
4 shërbimin e inteligjencës dhe nën komandë të z. Veseli.
5 Megjithëkëtë, këtu janë bazuar të nderuar Gjykatës. Dhe asgjë
6 tjetër. Do t'i diskutoj disa prej tyre në hollësi nesër nëse
7 ka nevojë.

8 Kjo ishte pika ime e parë sa i përket rolit të
9 drejtpërdrejtë. Tani do të kalojmë në pikën e dytë të
10 përgjithshme, që ZPS-ja duke shfrytëzuar këto thërrime të
11 vogla që kishte kundër z. Veseli, atëherë do të duhet të
12 ndërtonte një argument krejtësisht rrethanor dhe ligji kërkon
13 edhe një herë që të tregohet kujdes i madh nga Trupi Gjykses
14 në vlerësimin e këtij aspekti dhe në mënyrë të veçantë do t'ju
15 kërkoja, të nderuar Gjykatës, që ta bënit një gjë të tillë.
16 Pasi është një çështje apo një argument rrethanor i maskuar.

17 Këtu jemi pikërisht në periferi në kuptimin të fjalës
18 "prova". Kur përmendet emri i z. Veseli si provë apo ndonjë
19 gjë e shoqëruar me të, nuk tregohet asnjë sjellje penale, le
20 më ndonjë pjesëmarrje në ndonjë plan të tej madh kriminal apo
21 NKP apo njohuri për krime specifike të cilat mund t'i
22 kontrollonte.

23 Tregon thjesht, ai tregohet thjesht gjatë ushtrimit të
24 aktiviteteve ushtarake të zakonshme tipike, legjitime.
25 Megjithëkëtë, kjo etiketohet si kriminale nga ZPS-ja kur bëhet

1 deduksion për kriminalitetin, kur, në fakt, në bazë të këtij
2 argumenti e gjithë UÇK-ja do të duhej që të merrej në gjykim
3 pasi siç do të merreshin të gjithë guerilasit për çdo krim të
4 bërë në konfliktin në të cilin kanë marrë pjesë. Sjellja në
5 Kosovë e shtatë granatahedhësve në Kosovë në vitin 1997 si
6 plan për të shënjestruar kundërshtarët, dhe nuk po flitet këtu
7 për forcat serbe të cilat po ushtronin terror në Kosovë, në
8 këtë rast, të nderuar Gjykatës, bëhet fjalë për se çfarë po
9 kërkon të bëjë ZPS-ja këtu. Po peshkon në një det të madh. Po
10 kështu edhe në këtë rast të këtyre granatahedhësve nuk ka
11 nevojë t'ju kujtoj, të nderuar Gjykatës, se bëhet fjalë për dy
12 intervista të pakonfirmuara në media nga të bashkëakuzuarit të
13 cilat nuk mund të vërtetohen. Ata nuk kanë dhënë dëshmi. Dhe
14 kjo është origjina. Ky është ilustrimi i natyrës së
15 përgjithshme të kësaj natyre. Po për pesë granatahedhësit e
16 tjerë? Kush i solli aty? Ai solli shtatë nga 12. Kush i solli
17 të tjerat? A janë këto pjesë?

18 Siç tha Kryeprokurorja dje, ka qenë privilegj për të
19 takuar këta njerëz të cilët kanë jetuar në këtë periudhë
20 përfshirë "ata të cilët kanë luftuar për vendin e tyre kundër
21 vështirësive të mëdha".

22 Atëherë si mund të kundërshtojë atëherë klientin tim, i
23 cili ka siguruar armë për të zhvilluar këtë luftë? Këto janë
24 provat e qarta me të cilat mbështeten kundër klientit tim kur
25 pretendojnë që ai ka qenë pjesë e NPK-së, në të njëjtën kohë

1 kur kontributi për luftën çlirimtare të z. Veseli vlerësohet
2 dhe ky është problemi themeltar kundër klientit tim.

3 Kur Kryeprokurorja hapi çështjen të hënën këmbënguli që
4 asnjë shpallje fajësie, verdikt fajësie nuk kërkohet mbi bazën
5 e vetme të të qenit anëtar i Shtabit të Përgjithshëm apo UÇK-
6 së.

7 Por pastaj z. Lawson vazhdoi me këtë dhe tha:

8 "Në qoftë se komunikimet e Shtabit të Përgjithshëm
9 bashkëkohore të shumta ... pranohen për atë që ato qartësisht
10 janë, këto janë provat e drejtpërdrejta të qëllimit të
11 përbashkët kriminal."

12 Këto dy parashtrime nuk mund të jenë në përputhje me
13 njëra-tjetrën. Nga njëra anë ZPS-ja thotë që të qënurit
14 thjesht në Shtabin e Përgjithshëm apo UÇK nuk është e
15 mjaftueshme për të vërtetuar pjesëmarrjen kriminale, dhe
16 pastaj nga ana tjetër ata thonë që deklaratat në emër të
17 Shtabit të Përgjithshëm janë prova të drejtpërdrejta të
18 pjesëmarrjes kriminale.

19 Deklaratat që përdoren si mbështetje si provë e
20 drejtpërdrejtë janë ato që i atribuohen Shtabit të
21 Përgjithshëm dhe përdoren si mbështetje kundër gjithë Shtabit
22 të Përgjithshëm në tërësi. Pra, kjo është fajësia që
23 vërtetohet përmes mbajtjes së një pozicioni të caktuar. Nuk
24 është e individualizuar fare, megjithëse Prokurori thotë që
25 kjo nuk do të ndodhte. Në qoftë se të gjithë ata që ishin në

1 Shtabin e Përgjithshëm -- në qoftë se nuk është për të gjithë
2 ata që ishin në Shtabin e Përgjithshëm dhe në qoftë se nuk
3 është bërë për të shpjeguar përse disa persona mund të mos
4 jenë pjesë e kësaj NKP-je, atëherë pse deklaratat mund t'ju
5 atribuohen disave po jo disa të tjerëve, pa asnjë shpjegim se
6 pse.

7 Në vend të kësaj NKP-ja është -- pretendohet në mënyrë
8 shumë të gjerë që përfshinte edhe "ka marrjen dhe kontrollin e
9 pushtetit" dhe këtu po citoj, në Kosovë që do të thoshte
10 shtypja e dhunshme e kundërshtarëve "nga ana e udhëheqjes së
11 UÇK-së dhe Qeverisë së Përkohshme". Ajo që dua të them është
12 që kjo është fajësi kolektive në të gjithë spektrin e saj.
13 Asnjë sqarim nuk u bë lidhur me faktin se kush është në të dhe
14 kush është jashtë saj dhe arsyeja pse.

15 Qëndrimi i ZPS-së se UÇK-ja dhe strukturat e saj, Shtabi
16 i Përgjithshëm, zonat, drejtoritë, rregulloret që kanë dalë
17 prej saj dhe të gjitha deklaratat e tyre, sado rudimentare, të
18 thjeshta të kenë qenë ato, ato thonë që këto ishin të gjitha
19 mjete përmes të cilave një fushatë masive kriminale u krye për
20 të dominuar dhe kontrolluar Kosovën duke fshirë të gjithë ata
21 duke eliminuar të gjithë ata që ishin në rrugë, që u pengonin
22 rrugën atyre. Sipas ZPS-së kjo ka prekur të gjithë UÇK-në në
23 të gjitha nivelet e saj. Pra, kjo me fjalë të tjera, në thelb
24 do të thotë që në sytë e ZPS-së dhe sipas ZPS-së UÇK- si organ
25 dhe gjithë Shtabi i Përgjithshëm i saj dhe udhëheqja e saj

1 kanë vepruar në mënyrë kriminale duke kërkuar të zhvillonin
2 gjatë përpjekjeve për të zhvilluar strukturat e tyre që të
3 jenë në gjendje t'i rezistojnë forcave serbe.

4 Pra, e kuptoj që Prokuroria të mund të thotë që ata kanë
5 luftuar përkundër gjithë vështirësive për vendin e tyre dhe
6 natyrisht që nuk do të kërkoj, mos u shqetësoni, nuk do të
7 kërkoj që ata të shpallen fajtor për faktin se kanë qenë
8 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm apo të UÇK-së. Por ajo që
9 bën Kryeprokurorja, saktësisht për z. Veseli, është po kjo
10 sepse çdo veprim në punën e tij në UÇK dhe përpjekjet për ta
11 zhvilluar atë është bërë për të luftuar për kundër këtyre
12 vështirësive dhe tani pretendohet si kontribut në realizimin e
13 NKP-së.

14 Tani, ndërsa ZPS-ja qartësisht nuk do ta bëjnë dhe nuk e
15 bëjnë, nuk thonë asgjë lidhur me se si ushtritë konvencionale
16 të organizuara mirë, një ushtri e tillë, pra, të dominojë dhe
17 kontrollojë Kosovën në kohën ku dhuna e ushtruar ishte në
18 nivel tejet të lartë në shkallë industriale, po flas këtu për
19 forcat e shtetit serb, ata pranojnë se UÇK-ja po luftonte për
20 pavarësi nga Serbia. Por edhe këtë e përvetojnë duke thënë se
21 ajo që po bëhej, pra, përkatësisht heqja e dhunshme dhe
22 zhdukja e kundërshtarëve dhe kjo thonë është bërë me qëllim
23 për të arritur pavarësinë.

24 Znj. Lawson të hënën tha "logjika na dikton se pavarësia
25 do të kishte qenë një parakusht për anëtarët e NKP-së që të

1 marrin kontrollin". Pra, e gjithë lufta për pavarësi ka të
2 bëjë me heqjen qafe të kundërshtarëve dhe nuk përmendet fare
3 sesi është bërë përpjekja për të arritur pavarësinë. Pra, ZPS-
4 ja përdor termat e "shtypjes", po ata termat e shtypjes, atë
5 të kapjes, të uzurpimit, të kontrollit dhe dominimit për të
6 akuzuar udhëheqjen e UÇK-së për kontroll dhe dominim. Pra,
7 është një kthim mbrapsht në mënyrë perverse i pikërisht
8 sjelljes së regjimit të Milosheviqit në atë kohë duke kërkuar
9 që të kërkonte të zhbënte, anulonte autonominë dhe të
10 kontrollonte Kosovën me çdo kusht.

11 Ideja e paraqitur nga ZPS-ja se në një farë mënyre me
12 mendjen e UÇK-së gjatë kohës që ata po luftonin dhe pastaj
13 kishin idenë që të forconin pozitat e tyre, përpigeshin të
14 forconin pozitat e tyre në Kosovë nga marsi 1998 kundër
15 masakrës që po behej, se në mendjen e tyre gjatë kohës që po
16 bënë gjithë këtë kishin njëkohësisht një plan të përbashkët
17 për të shtypur vetë popullin e tyre apo të tjerët. Kjo është e
18 papranueshme dhe e paimagjinueshme. Ideja se z. Veseli u kthye
19 në Kosovë dhe lëvizi në Kosovë për të ndihmuar rritjen e UÇK-
20 së dhe që të ishte në gjendje të angazhonte luftime me forcat
21 serbe dhe që ai njëkohësisht kishte në të njëjtën kohë në
22 mendje një plan për të kthyer armët kundër popullit të vet
23 është absurde. Kjo është nuk mbështetet absolutisht në asnjë
24 provë.

25 Teoritë e ZPS-së janë kundër çdolloj logjike. Përse

1 mijëra njerëz të zakonshëm do të grumbulloheshin së bashku në
2 1998-n, nën shtypjen e Serbisë dhe të ndërtonin UÇK-në për një
3 qëllim të tillë kriminal? Ata në mënyrë të logjikshme e bënë
4 këtë gjë për të mbrojtur vendin e tyre dhe ky është qëndrimi i
5 komunitetit, i bashkësisë ndërkombëtare, në veçanti i Kombeve
6 të Bashkuara, i NATO-s se UÇK-ja luftoi me guxim kundër
7 mundësive tejet të pabarabarta për të mbrojtur Kosovën dhe,
8 pika tre, konstatimet e gjykatave të tjera penale
9 ndërkombëtare janë të të njëjtës mënyrë dhe në të njëjtin
10 efekt dhe, katër, mendimi këshilltar i Gjykatës së Drejtësisë
11 Ndërkombëtare për shembuj të shumtë të deklaratës së
12 pavarësisë në shekullin 18, 19 dhe 20, shpesh, përkundër
13 rezistencës së popujve të tjerë, të shteteve të tjera për
14 pavarësinë është deklaruar që nuk ishte kundër ligjit
15 ndërkombëtar, pra, përfshirë këtu edhe Kosovën, si dhe ligji,
16 e drejta ndërkombëtare për vetëvendosje që është zhvilluar në
17 gjysmën e dytë të shekullit 20. Dhe për këtë mund të shihni
18 paragrafin 79 të mendimit këshillues.

19 Tani, siç pretendohet gjerësisht si pjesë e kësaj NKP-je
20 se klienti im planifikoi, drejtoi dhe mbikëqyri ndërmarrjen
21 kriminale për të identifikuar dhe vrarë të gjithë
22 bashkëpunëtorët në Kosovë në 1998, 1999 duke drejtuar,
23 kontrolluar të gjitha njësitet e shërbimeve të zbulimit në çdo
24 zonë dhe brenda gjithë territorit të Kosovës dhe UÇK-në me
25 qëllimin kriminal në mendje dhe pretendohet, pa asnjë provë të

1 drejtpërdrejtë fare, për të mbështetur këtë pretendim, pra,
2 kjo gjë dhe megjithatë ZPS-ja ju kërkon juve, të nderuar
3 Gjykatës, që t'i dënoni ata duke u bazuar në fragmente provash
4 rrethanore që nuk janë kriminale.

5 Natyrisht sjellja jokriminale duhet të jetë relevante për
6 NKP, mund të jetë kriminale, mendoj, duhet të kenë prova që të
7 vërtetohet se ka synim kriminal dhe kontribut për veprimet
8 kriminale reale. Nuk mund të jetë thjesht zhvillimi i një
9 lufte në emër dhe me një organizatë me qëllim për t'u
10 përpjekur për t'u mbrojtur atë dhe popullin e tij. Veprimet
11 legjitime nuk mund të kthehen në ndërmarrje kriminale të
12 përbashkët.

13 Të nderuar Gjykatës, mendoj se kjo është koha e duhur për
14 të përfunduar për sot. Do të vijoj nesër për të mbaruar këtë
15 pjesë lidhur me NKP-në duke parë rrethanat dhe pse nuk ka
16 prova që mbështesin këto rrethana.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndërpritet
20 seanca deri nesër në 9.00 të mëngjesit. Faleminderit për
21 pjesëmarrjen tuaj. Shihemi nesër.

22 --- Seanca mbyllet në orën 16.44

23

24

25